



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 04
Janar 2014

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 4

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economicanalysis@bqk-kos.org

REDAKTOR Arben MUSTAFA

AUTORËT Zana GJOCAJ
Sokol HAVOLLI
Bejtush KIÇMARI
Krenare MALOKU

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl.: Capital Adequacy Ratio</i>)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (<i>angl.: European Bank for Reconstruction and Development</i>)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (<i>anglisht: European Central Bank</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit (<i>angl.: Net Interest Margin</i>)
NPL	Kreditë joperformuese (<i>angl.: Non-Performing Loans</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (<i>anglisht: Organization for Economic Cooperation and Development</i>)
OJSHEF	Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl.: Return on Average Assets</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl.: Risk Weighted Assets</i>)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (<i>angl.: Special Drawing Rights</i>)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.

Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2014), Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 4, Prishtinë: BQK.

Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Parathënie	9
2. Përmbledhje Ekzekutive	11
3. Ekonomia Botërore	15
3.1. Evropa Juglindore	20
4. Përmbledhje e zhvillimeve në ekonominë e Kosovës	24
4.1. Produkti i brendshëm bruto	24
4.2. Sektori Fiskal	25
4.3. Bilanci i pagesave	26
4.4. Tregu i punës	27
4.5. Çmimet	28
5. Sistemi Financiar i Kosovës	30
6. Sektori Bankar i Kosovës	33
6.1. Bilanci i gjendjes së sistemit bankar	33
6.1.1 Asetet	33
6.1.2 Kreditë	35
6.1.3 Detyrimet	40
6.1.5 Normat e interesit	43
6.2. Performanca e sektorit bankar	45
6.3. Rreziqet e Sistemit Bankar	49
6.3.1 Rreziku i likuiditetit	49
6.3.2 Rreziku kreditor	52
6.3.3 Rreziku i solvencës	55
6.3.4. Rreziku i tregut	59
6.4. Analiza stres-test	63
6.5. Infrastruktura financiare në Kosovë	67
6.5.1 Sistemi i pagesave dhe infrastruktura bankare	67
6.5.2. Versioni i ri i Regjistrimit të Kredive të Kosovës	72
7. Institucionet Tjera Financiare	75
7.1. Kompanitë e Sigurimit	75
7.2. Fondet pensionale	77
7.3. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë	78
9. Shtojca Statistikore	80

10. Referencat ----- 100

LISTA E FIGURAVE ----- 15

Figura 1. Inflacioni në vendet e eurozonës-----	15
Figura 2. Papunësia në vendet e zgjedhura të eurozonës -----	16
Figura 3. Trendi i rritjes së kredive -----	17
Figura 4. Trendi i rritjes së depozitave -----	17
Figura 5. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave -----	18
Figura 6. Kthimi në kapital-----	18
Figura 7. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit-----	19
Figura 8. Norma e kredive jopërfomuese në vende të zgjedhura të eurozonës-----	19
Figura 9. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës-----	20
Figura 10. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL -----	20
Figura 11. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL -----	21
Figura 12. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL -----	21
Figura 13. Rritja vjetore e kredive për ekonomi familjare dhe biznese në EJL -----	22
Figura 14. Norma e kredive jopërfomuese në EJL -----	23
Figura 15. Harta makroekonomike -----	24
Figura 16. Rritja reale e PBB-së -----	24
Figura 17. Komponentët kryesor të PBB-së -----	25
Figura 18. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar -----	26
Figura 19. IHD-të sipas sektorëve ekonomik -----	27
Figura 20. Papunësia sipas grupmoshave dhe gjinisë -----	27
Figura 21. Inflacioni dhe kontribuesit e tijë kryesor -----	28
Figura 22. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	28
Figura 23. Indeksi i çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	29
Figura 24. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve -----	30
Figura 25. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve -----	31
Figura 26. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm -----	31
Figura 27. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm -----	32
Figura 28. HHI për asetet, kreditë dhe depozitat -----	33
Figura 29. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	34
Figura 30. Struktura e letrave me vlerë -----	35
Figura 31. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve -----	35
Figura 32. Struktura e kredive-----	35
Figura 33. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	36
Figura 34. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik -----	36
Figura 35. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare -----	37

Figura 36. Faktorët që kanë ndikuar në standardet e palikutara për ndërmarrjet -----	37
Figura 37. Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditimin e ndërmarrjeve -----	37
Figura 38. Faktorët që kanë ndikuar në standardet e palikutara për ekonomitë familjare-----	37
Figura 39. Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditimin e ekonomive familjare-----	38
Figura 40. Kërkesat për kredi nga ndërmarrjet-----	38
Figura 41. Kërkesat për kredi nga ekonomitë familjare -----	38
Figura 42. Pritjet për zhvillimet në kreditim në tremujorin e ardhshëm -----	38
Figura 43. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	39
Figura 44. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit-----	39
Figura 45. Trendi i rritjes së depozitave-----	41
Figura 46. Struktura e depozitave sipas sektorëve-----	42
Figura 47. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit-----	42
Figura 48. Mesatarja vjetore e normave të interesit-----	43
Figura 49. Normat mesatare gjashtëmujore të interesit për kreditë e ndërmarrjeve -----	44
Figura 50. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve -----	45
Figura 51. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve-----	45
Figura 52. Struktura e të hyrave sipas kategorive-----	45
Figura 53. Norma vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive -----	46
Figura 54. Rritja e shpenzimeve sipas kategorive-----	46
Figura 55. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive -----	46
Figura 56. Shpenzimet për provizione dhe shkalla e rritjes së NPL-së -----	47
Figura 57. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive-----	47
Figura 58. Treguesit e profitabilitetit -----	47
Figura 59. Raporti shpenzime/të hyra -----	48
Figura 60. Treguesit e efikasitetit-----	48
Figura 61. Margjina neto e interesit -----	48
Figura 62. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar -----	50
Figura 63. Raporti asete likuide gjithëpërfshirëse/gjithsej asete -----	50
Figura 64. Rezervat e sistemit bankar-----	51
Figura 65. Hendeku i likuiditetit -----	51
Figura 66. Raporti NPL/gjithsej kreditë-----	52
Figura 67. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve-----	52
Figura 68. Raporti NPL ndaj gjithsej kredive sipas sektorëve -----	53
Figura 69. Struktura e kredive sipas klasifikimit-----	53
Figura 70. Struktura e kredive jopërformuese -----	54
Figura 71. NPL-të dhe provizionet-----	54
Figura 72. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	54
Figura 73. Kapitalizimi i sistemit bankar -----	55
Figura 74. Kapitali rregullativ dhe RWA-të -----	56
Figura 75. Kapitali shtesë mbi kapitalin e kërkuar rregullativ -----	56

Figura 76. Struktura e kapitalit të sistemit bankar -----	57
Figura 77. Struktura e kapitalit të klasës së parë -----	58
Figura 78. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut-----	58
Figura 79. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë-----	59
Figura 80. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj-----	60
Figura 81. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	60
Figura 82. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit -----	75
Figura 83. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit -----	75
Figura 84. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	76
Figura 85. Struktura e primeve të shkruara bruto të sigurimit jo-jetë -----	76
Figura 86. Struktura e dëmeve të paguara të sigurimit jo-jetë-----	77
Figura 87. Çmimi i aksionit të FKPK-së dhe indeksi DJI-----	77
Figura 88. HHI për asetet e IMF-ve -----	78
Figura 89. Asetet e IMF-ve sipas madhësisë-----	78
Figura 90. Kreditë e lëshuara nga IMF-të -----	79

LISTA E TABELAVE----- 15

Tabela 1. Indikatorët kryesorë makroekonomik -----	15
Tabela 2. Borxhi publik dhe bilanci buxhetor në shtete të zgjedhura të euozonës -----	16
Tabela 3. Rritja mesatare vjetore e kredive dhe depozitave për gjashtëmujorin e parë -----	22
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare-----	31
Tabela 5. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	34
Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar-----	41
Tabela 7. Tregusi të zgjedhur të e efikasitetit të sektorit bankar-----	49
Tabela 8. Indikatorët epërdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë --	62
Tabela 9. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit -----	66
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së ----	70
Tabela 10. Rrjeti i sektorit bankar -----	72

LISTA E KUTIVE----- 17

Kutia 1. Performanca e disa nga grupet e huaja bankare të cilat operojnë në Kosovë -----	17
Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar për Kosovën -----	36
Kutia 3. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë-----	61
Kutia 4. Anëtarësimi në SWIFT -----	68

1. Parathënie

Stabiliteti makroekonomik që ka karakterizuar ekonominë e Kosovës në vitet e fundit ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013. Situata më e favorshme në të hyrat nga jashtë, e shoqëruar me stabilitet fiskal e financiar, ka rezultuar në përshpejtim të normës së rritjes ekonomike në krahasim me vitin paraprak. Rol të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes ekonomike vlerësohet të ketë pasur ngushtimi i deficitit tregtar si dhe rritja e remitencave dhe investimeve të huaja direkte. Stabiliteti makroekonomik i ekonomisë së vendit i ka kontribuar ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar, i cili ka vazhduar të përfaqësojë një promotor të rëndësishëm të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend.

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin dhe, në të njëjtën kohë, ka vazhduar të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sektori bankar edhe gjatë kësaj periudhe ka treguar nivel të lartë të qëndrueshmërisë, që mbështetet në pozitën e kënaqshme të likuiditetit, cilësinë e mirë të portofolit kreditor, si dhe nivelin e lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit. Përkundër ambientit më të favorshëm makroekonomik dhe gjendjes së shëndoshë të bankave që operojnë në Kosovë, ngadalësimi i rritjes së kreditimit bankar ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe, duke zbehur paksa rolin e këtij sektori në financimin e aktivitetit ekonomik në Kosovë. Si do që të jetë, ky trend i kreditimit bankar në Kosovë është në linjë me trendët e kreditimit bankar edhe në vendet tjera të rajonit të cilat kanë karakteristika të ngjashme të sektorit bankar. Aktiviteti ndërmjetësues financiar i bankave në Kosovë po karakterizohet me rritje të vazhdueshme të efikasitetit, që po shprehet edhe përmes rënies së normave të interesit në kredi. Përkundër rënies, normat e interesit në kredi ende mund të konsiderohen si të larta, gjë që parashtron nevojën për rritje të mëtutjeshme të efikasitetit në sektorin bankar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar për sigurimin e stabilitetit financiar në vend, që paraqet edhe objektivin kryesor që del nga ligji mbi Bankën Qendrore. Në funksion të këtij objektivi është edhe publikimi i këtij raporti që ofron një pasqyrë të vlerësimit të stabilitetit financiar në Kosovë, me fokus në sektorin bankar, në kuptimin e aftësisë së këtij sektori për t'u ballafaquar me tronditjet e mundshme që mund t'i kanosen nga jashtë si dhe aftësinë e sektorit për të vazhduar ofrimin e shërbimeve financiare për ekonominë e vendit. Në funksion të sigurimit të stabilitetit financiar, Banka Qendrore gjatë vitit 2013 po ashtu është angazhuar në implementimin e rekomandimeve që kanë dalë nga Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar që ishte realizuar në vitin 2012 bashkërisht nga FMN dhe Banka Botërore. Aktivitet i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe harmonizimi i rregullativës sekondare me ligjin e ri mbi bankat dhe institucionet mikrofinanciare përmes së cilës është forcuar qeverisja korporative e këtyre institucioneve si dhe janë avancuar kapacitetet e bankave për menaxhimin e rreziqeve bankare. Avancim i rëndësishëm është shënuar edhe në fushën e infrastrukturës së sistemit të pagesave, ku në vitin 2013 Republika e Kosovës siguroi kodin e veçantë shtetëror SWIFT përmes së cilit do të ndikohet rritja e efikasitetit në realizimin e transfereve ndërkombëtare.

Bedri HAMZA
Guvernator

2. Përmbledhje Ekzekutive

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sektori bankar, si përbërësi kryesor i sistemit financiar të Kosovës, ka ruajtur nivelin e qëndrueshmërisë, përderisa aktiviteti ndërmjetësues financiar ka vazhduar të rritet por me ritëm të ngadalësuar. Përmirësimi i treguesve kryesor makroekonomik në Kosovë, krahasuar me vitin e kaluar, paraqet shenja inkurajuese për ambientin afarist në vend, por që nuk ka ndikuar në rritjen e gatishmërisë së sektorit bankar për një zgjerim më të shpejtë të kredihënies drejtë ekonomisë vendore.

Ekonomia globale edhe gjatë vitit 2013 u karakterizua me normë pozitive të rritjes, por që ishte më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Norma pozitive e rritjes së ekonomisë globale kryesisht u arrit si rezultat i rritjes së ekonomive të vendeve në zhvillim dhe ekonomisë së SHBA-ve, përderisa vendet e Eurozonës vlerësohet të kenë shënuar rënie ekonomike në vitin 2013. Performanca më e dobët e sektorit real në ekonomitë e Eurozonës është shoqëruar me vazhdim të rritjes së borxhit publik, gjë që ka rritur shqetësimet rreth qëndrueshmërisë së financave publike sidomos në disa nga vendet e Eurozonës. Këto zhvillime të pafavorshme ekonomike kanë bërë që norma e papunësisë në këto vende të vazhdojë të rritet, me implikime të mundshme edhe për ekonomitë e vendeve të rajonit tonë të cilat kanë shkallë të lartë të mbështetjes në remitenca. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë dhe në vendet e zhvilluara në përgjithësi ka bërë që viti 2013 të karakterizohet me rënie të presioneve inflacioniste, gjë që ka ngritur shqetësimet rreth mundësisë së hyrjes në një periudhë deflacioni sidomos për vendet e Eurozonës. Përkundër uljes së vazhdueshme të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane, sektorët bankar të këtyre vendeve kanë vazhduar të kenë rol të zbehtë në nxitjen e aktivitetit ekonomik, përderisa performanca e dobët e ekonomive ka vazhduar të reflektohet në përkeqësimin e cilësisë së kredive në këto vende. Si do që të jetë, viti 2014 pritet të karakterizohet me performancë më të mirë të ekonomisë globale, përfshirë Eurozonën, gjë që pritet të ndihmojë tejkalimin e sfidave me të cilat po ballafaqohen ekonomitë e zhvilluara.

Për vendet Evropës Juglindore, viti 2013 në përgjithësi vlerësohet të ketë qenë vit i rikuperimit ekonomik si rezultat i normave pozitive të rritjes ekonomike në të gjitha vendet e këtij rajoni. Rritja e aktivitetit ekonomik në këto vende është reflektuar në një rënie të lehtë të normës së papunësisë gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2013, përderisa është vërejtur rritje e presioneve inflacioniste. Përkundër përmirësimit të bilancit buxhetor, borxhi publik i vendeve të EJJL-së ka vazhduar të rritet, mirëpo vazhdon të mbetet në nivelin e Eurozonës. Ngjashëm me vendet e Eurozonës, sektorët bankar në vendet e EJJL-së kanë vazhduar shtrëngimin e theksuar të kredihënies, përderisa edhe depozitat janë karakterizuar me trend më të ngadalshëm të rritjes. Cilësia e portofolit kreditor ka vazhduar të përkeqësohet, ndërsa është shënuar përmirësim i lehtë në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Zhvillimet më të favorshme ekonomike të rajonit gjatë vitit 2013 ishin të pranishme edhe në ekonominë e Kosovës. Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë për vitin 2013 vlerësohet të ketë qenë rreth 3.1 përqind, që vazhdon të mbajë Kosovën si vendin me normën më të lartë të rritjes ekonomike në rajon. Krahasuar me vitin paraprak kur norma reale e rritjes ishte 2.5 përqind dhe ishte shënuar ngadalësim i rritjes ekonomike, viti 2013 është karakterizuar me përshpejtim të rritjes ekonomike gjë që shfaqë shenja të një rikuperimi ekonomik që pritet të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm. Si do që të jetë, adresimi i sfidave kryesore për ekonominë e Kosovës, siç është zvogëlimi i mëtejme i normës së papunësisë, kërkon norma edhe më të larta të rritjes ekonomike. Rritja e ekonomisë së Kosovës gjatë kësaj periudhe kryesisht pritet t'i atribuohet rritjes së konsumit, përderisa rënia e importeve dhe rritja e eksporteve pritet të

kontribuojë pozitivisht në normën reale të rritjes ekonomike. Në anën tjetër, efekti i investimeve në normën reale të rritjes mund të konsiderohet të ketë qenë neutral.

Ekonomia e Kosovës edhe gjatë kësaj periudhe vazhdoi të karakterizohet me deficit të lartë të llogarisë rrjedhëse që kryesisht shkaktohet nga deficit i lartë tregtar. Megjithatë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, importet shënuan vetëm një rritje të lehtë prej 0.6 përqind, ndërsa eksportet shënuan rritje vjetore prej 9.9 përqind. Situata më e favorshme për sa i përket të hyrave nga jashtë u reflektua edhe përmes rritjes së remitencave për 4.2 përqind gjatë gjashtëmujorit të parë 2013 si dhe rritjes së investimeve të huaja direkte për 66.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2013, inflacioni kishte një normë të moderuar prej 2.7 përqind e cila ishte më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, por që filloi të zvogëlohet gjatë gjysmës së dytë të vitit si rezultat i presioneve deflacioniste në vendet eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të aktivitetit tregtar. Ekonomia e Kosovës vazhdon të ketë pozicion të favorshëm për sa i përket stabilitetit të sektorit fiskal si në kontekst të bilancit buxhetor ashtu edhe në kontekst të nivelit të borxhit publik.

Përkundër ambientit më të favorshëm makroekonomik dhe nivelit të kënaqshëm të likuiditetit, kreditimi nga sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me ngadalësim të trendit të rritjes. Kështu, në qershor 2013 vlera e gjithsej kredive arriti në 1.83 miliardë euro duke shënuar një rritje vjetore prej 2.8 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 9.3 përqind në qershor 2012. Shtrëngimi i kredidhënies ishte i pranishëm si për kreditë e ndërmarrjeve ashtu edhe për kreditë e ekonomive familjare. Shtrëngimi i aktivitetit kredidhënës në përgjithësi vlerësohet të jetë pasojë e shtrëngimit të kriterëve për aprovimin e kërkesave për kredi nga ana e bankave, por sipas raportimeve të bankave në Anketën e Kreditimit Bankar konsiderohet se ka pasur edhe rënie të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Në shtrëngimin e kriterëve për kredidhënie mund të kenë ndikuar edhe strategjitë e grupeve të huaja bankare për të rritur nivelin e kapitalizimit përmes zvogëlimit të ekspozimeve të tyre kreditore.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë depozitat vendore si burim kryesor të financimit. Në qershor 2013, gjithsej depozitat arritën vlerën prej 2.2 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqind (7.7 përqind në qershor 2012). Përkundër ngadalësimit të trendit të rritjes, depozitat vazhduan të rriten me normë më të lartë se sa norma e rritjes së kredive, gjë që tregon se bankat vazhdojnë të kenë financim të qëndrueshëm dhe se shtrëngimi i kredidhënies nuk ka të bëjë me mungesë fondesh në banka. Burimi kryesor i depozitave në sektorin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare, depozitat e të cilave konsiderohen të jenë më stabile në raport me burimet tjera të financimit. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të ulët të ekspozimit ndaj sektorit të jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu edhe të depozitave, duke bërë që ndjeshmëria e sektorit ndaj zhvillimeve në tregjet e jashtme të jetë e ulët.

Aktiviteti ndërmjetësues financiar i bankave në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 u karakterizua me rënie të normave të interesit në kredi dhe rritje të lehtë të normave të interesit në depozita. Gjatë kësaj periudhe, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 12.8 përqind nga 13.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të kategorive të ndryshme të kredive bankare janë vërejtur edhe norma të ndryshme të interesit, ku për ndërmarrjet normat më të ulëta janë vërejtur te kreditë për qëllime investive në të cilat norma më e ulët mesatare ishte 10.3 përqind. Për sa i përket depozitave, norma mesatare e interesit gjatë gjashtëmujorit të parë 2013 ishte 3.5 përqind, krahasuar me 3.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rrjedhimisht, dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëlua në 9.3 pp nga 10.3 pp sa ishte paraprakisht.

Përkundër ngadalësimit të kredidhënies dhe ngushtimit të margjinës së normave të interesit, sektori bankar i Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 shënoi rritje të konsiderueshme të

profitit. Profiti i realizuar deri në qershor 2013 arriti vlerën prej 16.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 58.2 përqind. Rritja e profitit gjatë kësaj periudhe ishte rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të sektorit bankar për 5.7 përqind, përderisa të hyrat shënuan rënie vjetore prej 1.2 përqind. Duke pasur parasysh faktin se zvogëlimi i shpenzimeve ka ndodhur kryesisht si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizione, një përkeqësim më i theksuar i cilësisë së portfolios kreditorë, që do të nënkuptonte nevojën për ndarje të provizioneve të reja, do të reflektohej në rritje të gjithsej shpenzimeve dhe, si rrjedhojë, do të mund të zvogëlonte profitin e sektorit bankar. Andaj, bankat duhet të ndërmarrin masa për rritjen e efikasitetit të tyre duke bërë përshtatjet e nevojshme për zvogëlimin e shpenzimeve operacionale, sidomos në kohën kur të hyrat po karakterizohen me performancë negative.

Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të karakterizohet me menaxhim të mirë të rreziqeve bankare, gjë që ka rezultuar në një sektor bankar me pozicion të mirë likuiditetit, cilësi të mirë të portfolios kreditor dhe nivel të lartë të kapitalizimit. Rritja më e shpejtë e depozitave në krahasim me rritjen e kredisë ka bërë që raporti kredi depozita në qershor 2013 të jetë 83 përqind gjë që flet për gjendje të kënaqshme të likuiditetit në sektorin bankar. Poashtu, raporti ndërmjet mjeteve likuide dhe detyrimeve afatshkurtra, që me rregulloren përkatëse të Bankës Qendrore kërkohet të mbahet në një nivel minimal prej 25 përqind, në qershor 2013 qëndroi në 38.5 përqind. Bankat kanë vazhduar që edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 të mbajnë nivel më të lartë të rezervave në Bankën Qendrore se sa që është niveli minimal i kërkuar. Rezultatet e stres-testit për sektorin bankar, të bazuar në skenarë mjaft konzervativ për sa i përket disponueshmërisë së aseteve likuide dhe normës së mundshme të tërheqjes së depozitave paraqesin rezultate mjaft të favorshme për sa i përket aftësisë së sektorit bankar të Kosovës për të shërbyer tërheqje më të theksuara të depozitave.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë cilësi të mirë të portfolios kreditor me një pjesëmarrje të kredive joperformuese në gjithsej kreditë prej 7.8 përqind në qershor 2013, që paraqet nivelin më të ulët në kuadër të vendeve të rajonit. Megjithatë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vërehet një rritje e pjesëmarrjes së kredive joperformuese për 1.3 pp. Rritja e raportit ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive në radhë të parë i atribuohet ngadalësimit të rritjes së gjithsej kredive, përderisa vlera e kredive joperformuese ka vazhduar të rritet me trend të ngjashëm me vitin paraprak. Megjithatë, rritja e kredive jo-performuese mund të jetë edhe refleksion i zhvillimeve në aftësinë paguese të kredimarrësve, marrë parasysh se normat e rritjes ekonomike në vitet e fundit, përkundër se pozitive, ishin më të ulëta krahasuar me periudhën para krizës globale financiare. Sektorët të cilët u karakterizuan me cilësi më të dobët të kredive ishin sektori i prodhimtarisë dhe sektori i energjisë, ku pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e lëshuara për këta sektorë ishte 15.7 përkatësisht 11.5 përqind. Ndërsa, kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare u karakterizuan me cilësi më të mirë, me një pjesëmarrje të kredive joperformuese prej 2.5 përqind. Përkundër rritjes, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbje nga kreditë. Në qershor 2013, shkalla e mbulueshmërisë me provizione ishte 113.2 përqind, gjë që tregon se bankat kanë ndarë një nivel të kënaqshëm të rezervave për t'u ballafaquar me humbjet e mundshme nga kreditë. Në kuadër të strukturës së kredive të sektorit bankar është evidentuar rritje e vlerës së ekspozimeve të mëdha kreditorë, por gjithashtu është shtuar numri i ekspozimeve, që nënkupton që është bërë shpërndarja e koncentrimit të rrezikut kreditor në më shumë kredimarrës të mëdhenj.

Niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit në sektorin bankar të Kosovës vazhdoi të jetë i lartë. Në qershor 2013, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në 16.5 përqind, që tejkalon nivelin minimal prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vërehet se treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka rënë për 0.7 pp që kryesisht është rrjedhojë e hyrjes në fuqi të rregulloreve të reja bankare të cilat kanë ndryshuar

mënyrën e përlogaritjes së kapitalit rregullativ. Përveç nivelit të lartë të kapitalizimit, sektori bankar i Kosovës karakterizohet edhe me cilësi të mirë të kapitalit, ku kapitali i klasit të parë përfaqëson 81 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ. Niveli i kënaqshëm i kapitalizimit të sektorit bankar tregohet edhe nga rezultatet e stres-testit të cilat sugjerojnë se niveli aktual i kapitalizimit i mundëson bankat që të përballojnë edhe norma më të theksuara të rritjes së kredive joperformuese ose rreziqe të tjera bankare siç është rreziku i tregut. Bankat të cilat operojnë në Kosovë mund të konsiderohen se kanë shkallë të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të tregut si rezultat i faktit që pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave kanë normë fikse të interesit si dhe faktit që pjesa dërmuese e aseteve dhe detyrimeve janë në valutën euro.

Përderisa infrastruktura bankare gjatë kësaj periudhe u karakterizua me zvogëlim të numrit të nëndegëve dhe numrit të punësuarve, rritja e vazhdueshme e rrjetit të bankomatëve dhe paisjeve POS nga sektori bankar ndikoi në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare. Sistemi i pagesave gjatë vitit 2013 ka avancuar si në kuadër të bazës ligjore, ashtu edhe në aspektin e rritjes së efikasitetit. Në maj 2013, hyri në fuqi Ligji për Sistemin e Pagesave i cili ka mundësuar përforcimin e kompetencave të BQK-së për mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare, me qëllim të sigurimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Rritja e sigurisë në sistemin e pagesave ka ndikuar në rritjen e mëtejme të numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera përmes sistemit të vetëm ndërbankar të pagesave në Kosovë (SEKN). Në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës së sistemit të pagesave, vlen të theksohet fillimi i përfshirjes së sistemit të tregtimit, depozitimit dhe shlyerjes së letrave me vlerë (angl.CSD: Central Securities Depository), ku realizohet shlyerja e transaksioneve të letrave me vlerë. Në fund të vitit 2013, Kosova poashtu siguroi kodin e veçantë shtetëror SWIFT me të cilin do të identifikohen institucionet financiare që operojnë në Kosovë gjatë realizimit të transfereve ndërkombëtare. Kjo pritet të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe zvogëlimin e kostos së transfereve ndërkombëtare.

Për sa i përket institucioneve tjera financiare, asetet e sistemit pensional vazhduan të rriten, duke arritur vlerën prej 808.8 milionë euro në qershor 2013 (rritje vjetore prej 22.7 përqind). Pjesa më e madhe e aseteve të sistemit pensional vazhdon të menaxhohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), asetet e të cilit shënuan përmirësim të performancës e cila u shpreh në rritje të çmimit të aksionit. Me rritje të veprimtarisë u karakterizua edhe sektori i sigurimeve, asetet e të cilit arritën vlerën prej 130.1 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 8.3 përqind. Përkundër rritjes së aktivitetit, sektori i kompanive të sigurimit u karakterizua me humbje prej 1.4 milionë euro, që rezultoi nga rritja më e shpejtë e shpenzimeve krahasuar me rritjen e të hyrave. Për dallim nga komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës, sektori i institucioneve mikrofinanciare shënoi zvogëlim të aktivitetit. Vlera e kredive dhe lizingjeve të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare në qershor 2013 ishte 95.9 milionë që paraqet një rënie vjetore prej 6.5 përqind.

3. Ekonomia Botërore

Rritja ekonomike globale në vitin 2013 është parashikuar të jetë në nivelin prej 2.9 përqind, që është nivel më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Ky nivel i rritjes ekonomike është kryesisht rezultat i ngadalësimit të rritjes së kërkesës së brendshme në disa nga vendet e mëdha në zhvillim si dhe recesionit të zgjatur në eurozonë si rezultat i pasigurisë në sektorin fiskal. Rritja ekonomike në vendet në zhvillim parashihet të jetë 4.5 përqind në vitin 2013, ndërsa rënia ekonomike në eurozonë parashihet të jetë 0.4 përqind (FMN, WOE 2013 - tabela 1). Në anën tjetër, Eurostat-i ka vlerësuar se në TM2 2013 eurozona ka shënuar rritje prej 0.3 përqind krahasuar me TM1 2013, gjë që mund të ketë ngjallur shpresat për rritje edhe në pjesën tjetër të vitit. Sa i përket SHBA-ve, ekonomia e saj pritet të shënojë rritje prej 1.6 përqind por me ritëm më të ulët se sa në vitin paraprak.

Tabela 1. Indikatorët kryesorë makroekonomik


Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-së)	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013
SHBA	2.8	1.6	2.1	1.4	-2.7	-2.7
Eurozona	-0.6	-0.4	2.5	1.5	1.9	2.3
Vendet në zhvillim	4.9	4.5	6.1	6.2	1.4	0.8
Evropa Qendrore dhe Lindore	1.4	2.3	5.8	4.1	-4.3	-4.4

Burimi: FMN (2013)

Në eurozonë shkaktarët kryesor të recesionit pritet të jenë rënia e investimeve dhe konsumit privat që pritet të shënojë rënie vjetore prej 3.5 përkatësisht 0.7 përqind. Në mesin e vendeve të eurozonës, pothuajse të gjitha shtetet më të fuqishme të bllokut parashihet të shënojë rënie ekonomike me përjashtim të Gjermanisë dhe Francës të cilat pritet të ketë norma pozitive të rritjes prej 0.5 përkatësisht 0.2 përqind. Ndryshe nga eurozona, kontributin kryesor në rritjen e PBB-së në SHBA pritet ta kenë investimet dhe konsumi privat të cilat pritet të shënojë rritje prej 2.6 përkatësisht 2.0 përqind, ndërkohë që konsumi publik pritet të shënojë rënie prej 2.0 përqind.

Inflacioni në nivel global gjatë vitit 2013 pritet të zvogëlohet në 3.2 përqind nga 3.8 përqind sa ishte në vitin paraprak, dhe është parashikuar të qëndrojë rreth këtij niveli edhe në vitin 2014. Rënia e çmimit të naftës dhe, si rrjedhojë, rënia e çmimeve të ushqimit dhe energjisë pritet të jenë kontribuuesit kryesor për rënien e presioneve inflacioniste në vendet e zhvilluara, ndërsa në vendet në zhvillim inflacioni pritet të shënojë një ngritje të lehtë. Inflacioni në vendet e zhvilluara për vitin 2013 pritet të jetë 1.4 përqind (2.0 përqind në vitin 2012), ndërkohë që në vendet në zhvillim inflacioni pritet të jetë 6.2 përqind (6.1 përqind në vitin 2012). Sipas të dhënave aktuale, mesatarja e inflacionit në SHBA në gjysmën e parë të këtij viti ka rënë në 1.4

Figura 1. Inflacioni në vendet e zgjedhura të eurozonës, në përqindje



Burimi: Eurostat (2013)

përqind (2.1 përqind në vitin 2012), kurse në eurozonë ka rënë në 1.7 përqind (2.5 përqind në vitin 2012). Për shkak të recesionit, vërehet një rënie më e theksuar e shkallës së inflacionit në Portugali ndërsa në Greqi është shënuar deflacion prej 0.2 përqind (figura 1). Sa i përket çmimeve për kategori të veçanta, çmimet e naftës në nivel global shënuan rënie për rreth 4.0 përqind në gjysmën e parë të vitit 2013 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që është një indikacion i rënies së kërkesës globale për këtë produkt. Përveç çmimeve të naftës, rënie shënuan edhe çmimet e metaleve të cilat ishin për 5.5 përqind më të ulëta. Përkundër rënies së çmimeve të produkteve kryesore në tregjet globale, çmimet e produkteve ushqimore shënuan ngritje të lehtë prej 0.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Karakteristikë kryesore e krizës së fundit globale ishte rritja e vazhdueshme e borxhit publik në vendet e zhvilluara. Në këtë kontekst, performanca më e dobët e sektorit real ka ndikuar në rritjen e mëtejme të pasigurisë së pjesëmarrësve në treg lidhur me qëndrueshmërinë e financave publike. Në fund të vitit 2012, shkalla e borxhit publik në eurozonë arriti në 90.6 përqind të PBB-së krahasuar me shkallën prej 87.3 përqind të PBB-së të regjistruar në vitin 2011. Të dhënat për TM2 2013 tregojnë për një rritje të mëtejme të borxhit publik i cili arriti në 93.4 përqind të PBB-së. Pothuajse të gjitha shtetet e eurozonës e thelluan nivelin e borxhit publik në TM2 2013, veçanërisht shtetet të cilat cilësohen me nivel të lartë të borxhit publik (tabela 2). Thellimit të borxhit publik në eurozonë i kontribuoi edhe deficitit buxhetor i cili arriti në 2.3 përqind të PBB-së në TM2 2013. Përveç rritjes së vazhdueshme të deficitit buxhetor, edhe mungesa e rritjes ekonomike e bënë sfiduese ruajtjen e qëndrueshmërisë së borxheve në eurozonë, mirëpo parashikimet për rritje më të lartë në vitin 2014 në nivel global por edhe në eurozonë pritet të përmirësojnë qëndrueshmërinë dhe tejkalimin e krizës së borxheve publike, gjë që do të reflektohej në rritjen e shkallës së besueshmërisë në tregje dhe uljen e kostos së financimit.

Tabela 2. Borxhi publik dhe bilanci buxhetor në shtete të zgjedhura të eurozonës


Përshkrimi	Greqia		Italia		Portugalia		Irlanda		Belgjika	
	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013
Borxhi publik, % e PBB-së	149.2	169.1	125.6	133.3	118.1	131.3	110.2	125.7	102.7	105.0
Bilanci buxhetor, % e PBB-së	-7.7	-30.3	-2.2	-1.0	-7.7	-4.2	-8.2	-5.8	0.8	1.7

Burimi: Eurostat

Të dhënat aktuale për papunësinë tregojnë për zvogëlim të saj në shumicën e ekonomive të fuqishme botërore. Në SHBA norma e papunësisë është zvogëluar në 7.6 përqind në qershor të vitit 2013 (8.1 përqind në vitin 2012), ndërsa në Japoni është ulur në 3.9 përqind (4.3 përqind në vitin 2012). Në anën tjetër, shkalla e papunësisë në vendet e eurozonës ka vazhduar të rritet duke shënuar ngritje nga 11.4 përqind në vitin 2012 në 12.1 përqind në qershor të vitit 2013. Greqia, Spanja, dhe

Portugalia vazhdojnë të jenë vendet me shkallën më të lartë të papunësisë në eurozonë dhe në të njëjtën kohë përfaqësojnë vendet në të cilat papunësia është rritur më së shumti në gjysmën e

Figura 2. Papunësia në vendet e zgjedhura të eurozonës, në përqindje



parë të vitit 2013 krahasuar me vitin 2012. Austria, Gjermania dhe Franca janë vendet me shkallën më të ulët të papunësisë (figura 2).

Kutia 1. Performanca e grupeve të huaja bankare të cilat operojnë në Kosovë

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Në vitin 2012, Procredit Holding (PCH) ka shënuar performancë pozitive në shumicën e treguesve financiar. Vlera e asetëve në fund të vitit arriti në 5.77 miliardë euro që paraqet rritje vjetore për 5.0 përqind. Sa i përket aktivitetit biznesor, gjithsej kreditë e PCH-së arritën vlerën prej 4.19 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.0 përqind. Depozitat gjatë vitit 2012 arritën vlerën 3.62 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.1 përqind (Figura 3 dhe 4).

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave gjatë vitit 2012 ka shënuar rritje për rreth 1.2 pikë përqindje (figura 5). Kjo rritje e lehtë erdhi si rezultat i rritjes më të shpejtë të shpenzimeve operacionale, të cilat arritën në 376.4 milionë euro (rritje për 8.0 përqind)


kundrejt rritjes së të hyrave operacionale që arritën në 435.5 milionë euro (rritje për 7.3 përqind). Si rrjedhojë, edhe profiti neto gjatë vitit 2012 shënoi rënie prej 1.1 përqind duke zbritur në 46.3 milionë euro (krahasuar me 46.8 milionë euro në 2011). Ngjashëm me vitin 2011, norma e kthimit në kapital (ROE) mbeti në nivel relativisht të lartë (10.3 përqind). Niveli i ngjashëm i profitit me vitin paraprak u reflektua edhe në normën e kapitalizimit e cila ruajti një nivel të përafërt krahasuar me vitin paraprak. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*) në vitin 2012 qëndroi në 15.1 përqind (15.03 përqind në vitin 2011) që paraqet nivel të kënaqshëm të kapitalizimit të PCH (figura 6).

Shkalla e aftësisë kreditore (credit rating) e PCH mbetet e njëjtë me vitin paraprak përkatësisht BBB-, sipas vlerësimit nga agjensioni Fitch. Ndërsa, aftësia kreditore ndërkombëtare (international rating) gjithashtu ka mbetur e njëjtë me përjashtim të PCB-së në Kosovës që u përmirësua nga B- në B. Pjesa më e madhe e grupës përbëhet nga degët e saj në Evropën juglindore. Ndërsa, dega më e madhe e gjithsej grupës është ajo e Kosovës me asete prej 805.1 milionë euro apo rreth 14 përqind të gjithsej asetëve të PCH.

Në gjysmën e parë të vitit 2013 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, asetet e PCH shënuan rritje të lehtë prej 1.0 përqind duke arritur vlerën prej 5.81 miliardë euro. Rritja e gjithsej asetëve për PCH i atribuohet rritjes së kreditimit ndaj konsumatorëve.


Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave u rrit për 1.2 pikë përqindje. Rënie vërehet në profitin neto të gjithsej grupës së PCH. Në gjysmën e parë të vitit 2013 profiti neto zbriti në 21.9 milionë euro krahasuar me 27.6 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2012.

Figura 3. Trendi i rritjes së kredive



Burimi: Raportet vjetore të grupeve përkatëse (2013)

Figura 4. Trendi i rritjes së depozitave



Burimi: Raportet vjetore të grupeve përkatëse (2013)

¹Burimi i të dhënave për analizën e grupeve bankare janë raportet vjetore të grupeve përkatëse. Në analizë janë përfshirë vetëm grupet bankare në të cilat bëjnë pjesë tri bankat më të mëdha që operojnë në Kosovë.

Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)

Në fund të vitit 2012, asetet e Raiffeisen Bank International regjistruan vlerën prej 136.1 miliardë euro, duke shënuar një rënie prej 7.4 përqind. Vlera e kredive për sektorin jo-financiar arriti në 83.3 miliardë euro që paraqet rritje vjetore për 2.2 përqind, ndërsa depozitat e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve jo-financiare kishin vlerën prej 66.3 miliardë që paraqet rënie vjetore për 0.7 përqind (figura 5 dhe 6).

Në vitin 2012, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave shënoi rritje duke arritur në 63.5 përqind krahasuar me 57.0 përqind sa ishte në vitin 2011 (figura 7). Rritja e këtij raporti erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve të përgjithshme administrative, nga 3.1 miliardë në 3.3 miliardë, gjatë konsolidimit të pasqyrave financiare të RBI që përfshijnë edhe Polbank. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kishte edhe rritje të shpenzimeve tjera si ato teknologjisë informative. Përveç rritjes së shpenzimeve, edhe rënia e të hyrave


operacionale nga 5.5 miliardë në 5.1 miliardë ndikoi që të ketë rritje të raportit ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave.

Fitimi neto i konsoliduar i RBI për vitin 2012 ishte 725 milionë euro, që paraqet një rënie prej 25 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, treguesi i profitabilitetit ROE u zvogëlua në 7.0 përqind krahasuar me 9.7 përqind në vitin 2011. Përkundër rënies së profitit, niveli i kapitalizimit të RBI-së shënoi rritje duke arritur në 15.6 përqind krahasuar me 13.5 përqind sa ishte në vitin 2011.

RBI është e vetmja nga tri grupet bankare të tri bankave më të mëdha që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Në fund të vitit 2012, çmimi i aksioneve të RBI në bursën e Vjenës ishte 31.46 euro, duke shënuar rritje prej 56.8 përqind në 2012 kundrejt vitit paraprak². Sa i përket rangimit kreditor, RBI është vlerësuar nga tri kompanitë vlerësuese Moody's, S & P dhe Fitch. Moody's ka vlerësuar RBI-në me notë A2 për periudhë afatgjatë dhe P-1 në periudhë afatshkurtër, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rangim për një notë më të mirë. Ndërsa prospektet i ka konsideruar si stabile. Sa i përket S & P, vlerësimi ishte me notë A për periudhë afatgjatë dhe A-1 për periudhë afatshkurtër me prospekte përgjithësisht negative, që është vlerësim i njëjtë me vitin paraprak. Ndërsa Fitch e vlerëson me A në afatgjatë dhe F1 në afatshkurtër dhe me propsekte stabile që gjithashtu paraqet vlerësim të njëjtë me vitin 2011. Pjesmarrja e degës së Raiffeisen Bankës në Kosovë në gjithsej asetet e RBI grupës në fund të vitit 2012 ishte 0.45%.


Në qershor 2013, vlera e aseteve të RBI ishte 130.3 miliardë euro që paraqet rënie vjetore prej 4.3 përqind. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave shënoi rritje por më të moderuar. Në qershor 2013, niveli i këtij treguesi arriti në 60.2 përqind (2.1 pikë përqindje më i lartë se në qershor 2012). Sa i përket profitabilitetit, si rezultat i aktivitetit më të ulët, profiti ishte 277 milionë euro krahasuar me 701 milionë euro në qershor 2012. Sidoqoftë, kapitalizimi mbetet në nivel relativisht të lartë me 15.1 përqind.

Figura 5. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2013)

Figura 6. Kthimi në kapital (ROE), në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2013)

² Indekset ATX dhe EURO STOXX Banks, në të cilat RBI është e përfshirë, shënuan rënie prej 35 dhe 38 përqind respektivisht.

NLB Group (Slloveni)


Vlera e gjithsej asetëve në fund të vitit 2012 ishte 14.3 miliardë euro, që në krahasim me vitin paraprak paraqet rënie për 12.8 përqind. Rënia në vlerë të asetëve, përveç përkeqësimeve të kushteve të tregut, erdhi edhe si rezultat i zvogëlimit të aktivitetit të NLB Group në vende që i konsiderojnë jo-strategjike dhe mbajtjes së politikave konzervative për rrezikun e tregut. Me rënie u karakterizuan edhe tregues të tjerë për NLB Group. Kreditë ndaj sektorit jo-financiar të NLB Group shënuan vlerën prej 9.6 miliardë euro, që në krahasim me vitin paraprak paraqet rënie për 11.1 përqind. Sjellje e ngjashme u vërejt edhe te depozitat që arritën vlerën e 9.1 miliardë euro që paraqet rënie vjetore për 10.4 përqind (figura 3 dhe 4).

Sidoqoftë, NLB Group rriti efikasitetin duke përmirësuar raportin ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave operative. Në krahasim me vitin paraprak ku raportin ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave ishte 59.7 përqind, në vitin 2012 ky raport u zvogëlua në 54.6 përqind (Figura 3).

Treguesit e profitabilitetit u karakterizuan me rënie gjë që i atribuohet edhe rritjes së provizioneve për humbjen e kredive. Sidoqoftë, edhe pse me rezultate negative në profitabilitet, rritja e efikasitetit në shpenzime por edhe rritja e të hyrave nga jo-interesi ndikoi që një pjesë e humbjeve të kompenzohet. Kthimi në kapital (ROE) ishte negativ në -25.0 përqind, që paraqet performancë më të dobët se në vitin paraprak (Figura 4). Rrjedhimisht, niveli i kapitalizimit (CAR) ishte më i ulët se në vitin paraprak duke shënuar një normë prej 10.6 përqind krahasuar me 11.1 përqind në vitin paraprak (figura 7).

Si rezultat i rënies të profitabilitetit, aftësia kreditore e NLB-së nga Moody's dhe Fitch u ul nga BA1 në B2 përkatësisht nga BBB në BBB-. Pjesëmarrja e degës së NLB Prishtina në Kosovë në gjithsej asetet e NLB grupës në fund të vitit 2012 ishte 2.94%. Gjysma e parë e vitit 2013 për NLB Group u karakterizua me përshpejtim të trendit të rënies së asetëve të përgjithshme që arritën në 13.8 miliardë nga 16.3 miliardë sa ishin në qershor 2012. Sidoqoftë, si rezultat i rënies të theksuar të të hyrave, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave u rrit në 81.2 përqind në qershor 2013 (45.0 përqind në qershor 2012). Vlen të theksohet se shpenzimet në vazhdimësi kanë shënuar rënie por rënia e të hyrave ishte më e theksuar. Në kuadër të NLB Group, profitabiliteti neto i konsoliduar vazhdoi të jetë negativ në krahasim gjysmën e parë të vitit paraprak. Rrjedhimisht, Kthimi në kapital ishte negativ me një normë prej -16.8 përqind, dhe niveli i kapitalizimit (CAR) vazhdoi rënie duke arritur në 10.1 përqind krahasuar me 12.1 përqind në qershor 2012.


Figura 7. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit CAR



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2013)

Kriza buxhetore përveçse ka rritur pasigurinë e bankave për të lëshuar kredi ka ndikuar edhe në përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor. Sa i përket eurozonës, përkundër faktit se është zvogëluar norma bazë e rifinancimit e Bankës Qendrore Evropiane me qëllim që të lehtësohet qasja në financa për sistemin bankar evropian, niveli i kreditimit shënoi rënie për rreth 1 përqind ndërkohë që niveli i kredive jo-përformuese shënoi rritje prej mesatarisht 2.0 pikë përqindje (figura

Figura 8. Norma e kredive jopërformuese në vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: FMN (2013)

8). Në anën tjetër, në shumicën e vendeve të eurozonës, bankat raportuan përmirësim në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (figura 9).

Parashikimet për rritje të eksportit prej 6.8 përqind në vitin 2013 (4.9 përqind në vitin 2012) si dhe niveli i njëjtë i rritjes së importit me vitin paraprak (5.1 përqind) pritet të ndikojë në përmirësimin e llogarisë rrjedhëse në nivel global gjatë vitit 2013. SHBA-të pritet të kenë rritje më të ulët të eksportit të mallrave (3.1 përqind) krahasuar me vitin paraprak (4.2 përqind). Njëkohësisht edhe importi pritet të shënojë rritje më të lartë në vitin 2013 (2.5 përqind) krahasuar me

vitin paraprak (2.1 përqind). Përkundër këtij përkeqësimi të bilancit tregtar, SHBA-të pritet të kenë nivel pothuajse të njëjtë të deficitit të llogarisë rrjedhëse me vitin e kaluar prej 2.9 përqind të PBB-së. Për dallim nga SHBA-të, eurozona pritet ta rrisë shkallën e suficitit të llogarisë rrjedhëse nga 1.8 përqind në vitin 2012 në 2.3 përqind të PBB-së në vitin 2013 kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave për 2.2 përqind (1.6 përqind në vitin 2012), ndërkohë që edhe importi i mallrave pritet të shënojë rritje prej 1.0 përqind në vitin 2013 krahasuar me rënien prej 2.3 përqind të shënuar në vitin paraprak.

Sa i përket kursit të këmbimit, Euro është vlerësuar ndaj shumicës së valutave kryesore botërore gjatë gjysmës së parë të vitit 2013. Vlerësimin më të theksuar Euro e regjistroi kundrejt Funtës Britanike me 3.49 përqind, pastaj ndaj Frankës Zvicerane me 2.08 përqind, si dhe Dollarit Amerikan me 1.29 përqind. Lëvizjet e valutës Euro kundrejt valutave tjera të mëdha është rezultat i zhvillimeve ekonomike por edhe i perceptimeve të tregut për perspektivën ekonomike dhe fiskale të vendeve të eurozonës. Në këtë kontekst, vlerësimi i Euros ishte kryesisht për shkak të rritjes pozitive në tremujorin e dytë të vitit 2013 dhe parashikimeve për rritje pozitive në vitin 2014.

3.1. Evropa Juglindore

Viti 2013 pritet të jetë vit i rikuperimit të aktivitetit ekonomik për të gjitha vendet e Evropës Juglindore (EJL) pasi që norma mesatare e rritjes së PBB-së pritet të arrijë në 1.8 përqind përderisa në vitin paraprak EJL-ja u përball me stagnim ekonomik. Kosova pritet të shënojë nivelin më të lartë të rritjes ekonomike krahasuar me vendet tjera (3.1 përqind), pasuar nga Maqedonia dhe Serbia (2.2 përkatësisht 2.0 përqind), Shqipëria (1.7 përqind) dhe Mali i Zi (1.5 përqind), ndërsa Bosnja dhe Hercegovina pritet të ketë nivelin më të ulët të rritjes (0.5 përqind) (figura 10). Edhe të dhënat aktuale nga Komisioni Evropian


sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në EJL në gjysmën e parë të vitit 2013 ishte pozitiv.

Figura 9. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës, në përqindje



Burimi: FMN (2013)

Figura 10. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJT




Burimi: FMN (2013) dhe vlerësimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2013

Rritja e aktivitetit ekonomik në vendet e rajonit ka ndikuar në përmirësimin e lehtë të gjendjes në tregun e punës. Vlerësimet e fundit tregojnë për një shkallë mesatare të papunësisë në EJJ prej 26.8 përqind, që është për 0.3 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Shkalla më e lartë e papunësisë vazhdon të jetë në Bosnje e Hercegovinë (44.4 përqind), Kosovë (30.9 përqind), Maqedoni (28.8 përqind), dhe Serbi (24.1 përqind), ndërsa shkallën më të ulët të papunësisë vazhdojnë ta kenë Shqipëria (12.8 përqind) dhe Mali i Zi (13.1 përqind).

Për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2013 pritet që të shtohen edhe presionet inflacioniste. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, mesatarja e inflacionit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2013 ishte 3.8 përqind krahasuar me mesataren prej 2.5 përqind që ishte shënuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Serbia, Maqedonia, dhe Mali i Zi raportuan normat më të larta të inflacionit (10.5, 3.6, përkatësisht 3.2 përqind), Kosova dhe Shqipëria raportuan nivel të inflacionit prej 2.7 përkatësisht 2.4 përqind, ndërsaq Bosnja dhe Hercegovina raportoi nivelin më të ulët të inflacionit prej 0.8 përqind (figura 11).


Figura 11. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJJ



Burimi: Komisioni Evropian (2013)

Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse për vendet e EJJ-së gjatë vitit 2013 pritet të ulët në 9.1 përqind të PBB-së, që është një përmirësim prej 0.9 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar. Mali i Zi, Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina vazhdojnë të raportojnë normat më të larta të deficitit të llogarisë rrjedhëse, ndërsa Maqedonia, Kosova, dhe Serbia me normat më të ulëta të deficitit. Përveç Maqedonisë e cila pritet të shënojë rritje të shkallës së deficitit të llogarisë rrjedhëse krahasuar me vitin 2012, në vendet tjera deficiti i llogarisë rrjedhëse pritet të zvogëlohet (figura 12). Sipas parashikimeve të FMN-së për vitin 2013, në pothuajse të gjitha vendet e EJJ-së parashihet rritje e eksporteve prej mesatarisht 6.7 përqind krahasuar me rënie prej 6.6 përqind të shënuar në vitin paraprak. Në anën tjetër, importet parashihet të shënojë rritje por me normë më të ulët se sa eksportet (5.5 përqind). Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit është përmirësuar edhe si pasojë e rritjes së transfereve rrjedhëse në shumicën e këtyre vendeve, ndërkohë që edhe bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, ka shënuar përmirësim të lehtë duke u rritur nga 5.3 përqind e PBB-së në vitin 2012 në 5.6 përqind në gjysmën e parë të vitit 2013.

Figura 12. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJJ, në përqindje të PBB-së



Burimi: FMN (2013) dhe vlerësimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2013

Si rezultat i masave të kursimit të ndërmarra nga qeveritë e vendeve të rajonit, pritet të shënohet përmirësim në bilancin e tyre buxhetor. Deficiti buxhetor pritet të zvogëlohet nga mesatarisht 3.9 përqind e PBB-së sa ishte në vitin e kaluar, në mesatarisht 3.5 përqind në vitin 2013. Shkallën më të lartë të deficitit buxhetor pritet ta shënojë Serbia (5.5 përqind të PBB-së),

pasuar nga Maqedonia dhe Mali i Zi (3.6 përqind të PBB-së secila), ndërsa vendet tjera pritet të kenë nivele më të ulëta të deficitit buxhetor. Përkundër zvogëlimit të deficitit buxhetor, në vitin 2013 pritet që borxhi publik në EJL të shënojë ngritje të lehtë nga mesatarisht 43.5 përqind e PBB-së në vitin 2012 në mesatarisht 44.0 përqind të PBB-së në vitin 2013. Serbia dhe Shqipëria vazhdojnë të kenë shkallën më të lartë të borxhit publik prej 64.7 përkatësisht 61.8 përqind të PBB-së, përderisa Kosova vazhdon të ketë shkallën më të ulët të borxhit publik në rajon me vetëm rreth 9.0 përqind të PBB-së.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 kursi i këmbimit të valutës Euro kundrejt valutave të vendeve të EJL-së shënoi vlerësim të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndaj Lekut shqiptar, Euro u vlerësua me 0.5 përqind (140.2 ALL/EUR), ndaj Dinarit serb u vlerësua me 1.0 përqind (111.9 RSD/EUR), si dhe ndaj Denarit maqedonas u vlerësua me 0.2 përqind (61.60 MKD/EUR).

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në sektorët bankar të vendeve të EJL-së vërehet se ka shënuar rritje dukshëm më të ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë e sektorit bankar shënuan rritje mesatarisht prej vetëm 2.4 përqind në gjysmën e parë të vitit 2013, krahasuar me rritjen prej 7.1 përqind të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Depozitat shënuan rritje mesatarisht prej 5.8 përqind krahasuar me rritjen prej 7.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni Evropian, rritja më e lartë e normës së kreditimit është regjistruar në Mal të Zi (5.4 përqind) dhe Maqedoni (4.2 përqind), pasuar nga Bosnje e Hercegovina (3.4 përqind), Kosova (2.8 përqind), dhe Shqipëria (1.2 përqind), ndërsa Serbia shënoi rënie të kreditimit prej 2.4 përqind. Sa i përket depozitave, Mali i Zi ka shënuar normën më të lartë të rritjes, pasuar nga Serbia dhe Shqipëria, ndërsa vendet tjera kanë shënuar norma më të ulëta (tabela 3).

Rritja e aktivitetit kreditues është përqendruar kryesisht tek kreditë për ekonomitë familjare, që në gjysmën e parë të vitit 2013 kanë shënuar rritje prej mesatarisht 4.2 përqind, ndërsa kreditë për biznese kanë shënuar rritje mesatare për vetëm 1.2 përqind.

Tabela 3. Rritja mesatare vjetore e kredive dhe depozitave në gjashtëmuorin e parë, në përqindje


Përshkrimi	Shqipëria		BIH		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013	Qer 2012	Qer 2013
Kreditë	10.2	1.2	5.1	3.4	8.2	4.2	-5.2	5.4	15.2	-2.4	9.3	2.8
Depozitat	10.6	5.4	2.8	4.1	8.9	4.0	0.4	10.3	15.0	6.9	7.7	4.4

Burimi: Komisioni Evropian (2013)

Sa i përket shteteve, përveç Serbisë e cila ka shënuar rënie të aktivitetit kreditues për bizneset dhe stagnim të aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare, të gjitha shtetet tjera shënuan norma pozitive për të dy sektorët (figura 13).

Përveç normave më të ulëta të rritjes së kredive dhe depozitave, sistemet bankare në EJL u karakterizuan edhe me përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor gjatë kësaj periudhe. Në pjesën e parë të vitit 2013, Shqipëria raportoi normën më të lartë të kredive jo-performuese prej 24.4


Figura 13. Rritja vjetore e kredive për ekonomi familjare dhe biznese në EJL, në përqindje



Burimi: Komisioni Evropian (2013)

përqind (21.7 përqind në 2012), pasuar nga Serbia me 19.9 përqind (18.6 përqind në 2012), pastaj Mali i Zi me 18.8 përqind (17.6 në 2012). Edhe në Bosnje e Hercegovinë u shënuar përkëqsim i normës së kredive jo-performuese nga 12.7 përqind në vitin 2012 në 14.3 përqind. Shkallën më të ulët të kredive jo-performuese vazhdon ta ketë Kosova, me vetëm 7.8 përqind të gjithsej kredive në qershor 2013 (6.6 përqind në vitin 2012) (figura 14). Sikurse në eurozonë, edhe në EJJ, përkundër rritjes së kredive jo-performuese bankat raportuan përmirësim në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit nga mesatarisht 16.7 përqind sa ishte në dhjetor 2012, në mesatarisht 17.0 përqind në qershor të vitit 2013. Serbia dhe Maqedonia kanë shënuar normat më të lartë të nivelit të kapitalizimit (19.9 përkatësisht 17.3 përqind), ndërsa Shqipëria nivelin më të ulët të kapitalizimit (rreth 15 përqind). Gjatë periudhës në fjalë, edhe raporti ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe mjetet të peshuara me rrezik kanë shënuar përmirësim nga mesatarisht 13.4 përqind në dhjetor 2012 në 13.8 përqind në qershor 2013.

Figura 14. Norma e kredive jo-performuese në EJJ



Burimi: Komisioni European (2013)

4. Përmbledhje e zhvillimeve në ekonominë e Kosovës

Zhvillimet në treguesit kryesor makroekonomik sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në vend u karakterizua me normë pozitive të rritjes, duke bërë që Kosova të jetë ndër vendet me rritjen më të lartë në rajon. Norma e rritjes ekonomike për vitin 2013 pritet të jetë rreth 3.1 përqind që është për 0.6 pikë përqindje më e lartë se sa norma e rritjes ekonomike të shënuar në vitin paraprak.

Burimet kryesore të financimit për aktivitetin ekonomik në vend gjatë vitit 2013 janë duke treguar performancë më të mirë, duke ndikuar kështu pozitivisht në rritjen ekonomike (figura 15). Në këtë kontekst,

vlen të theksohet rritja më e lartë e eksporteve se sa importeve e cila ka bërë që të përmirësohet deficitin tregtarë dhe rrjedhimisht deficitin i llogarisë rrjedhëse të zvogëlohet gjatë vitit 2013. Rritja e eksporteve mund t'i atribuohet zhvillimeve më pozitive në ekonominë e vendeve të eurozonës dhe të Evropës Juglindore si dhe stabilitetit të çmimeve të metaleve, ndërsa rënia e çmimeve të derivateve dhe indikacionet për rritje të prodhimit të brendshëm ndikuan që importi të ketë rënie. Rritja ekonomike në vendet ku është e koncentruar diaspora kosovare ka bërë që remitencat të karakterizohen me rritje. Me rritje të theksuar janë karakterizuar edhe investimet e huaja direkte, të cilat janë gjeneruar kryesisht nga procesi i privatizimit dhe fitimi i ri-investuar i kompanive.

Aktiviteti i sektorit privat vazhdoi të përkrahet nga kreditë e sistemit bankar të cilat, me gjithë ngadalësimin, vazhduan të shënojnë normë pozitive të rritjes. Shpenzimet e qeveritare poashtu shënuan rritje, por me normë më të ulët se sa në vitin e kaluar, kryesisht për shkak të normës më të ulët të ekzekutimit të buxhetit se sa në vitin paraprak.

Ekonomia e Kosovës gjatë këtij viti vazhdoi të ketë normë të moderuar të inflacionit. Inflacioni në Kosovë është treguar mjaft i luhatshëm në vitet e fundit, duke u ndikuar në masë të madhe nga zhvillimet e çmimeve në tregjet e jashtme. Kjo është rezultat i shkallës së lartë të varësisë së ekonomisë së vendit në mallrat e importuara nga jashtë.

4.1. Produkti i brendshëm bruto

Treguesit kryesor makroekonomik sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2013 ka shënuar përmirësim të lehtë. Rrjedhimisht, sipas projeksioneve të BQK-së, pritet që rritja reale e PBB-së do të jetë 3.1 përqind apo 0.6 pikë përqindje më e lartë se sa vitin e kaluar (figura 16). Kontributin kryesor në rritjen e PBB-së pritet ta ketë rritja e konsumit, pasuar nga eksportet neto, ndërsa investimet pritet të kenë ndikim neutral në rritjen e PBB-së reale. Vlera nominale e PBB-së për vitin 2013 është parashikuar të jetë rreth 5.3 miliardë euro.

Konsumi është komponenti me pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të PBB-së, pjesëmarrje e cila në vitin 2013 pritet të jetë 103.6 përqind. Projeksionet për vitin 2013 sugjerojnë se konsumi

Figure 15. Harta Makroekonomike






Figura 16. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



pritet të ketë rritje nominale prej 4.6 përqind. Konsumi privat edhe ai publik pritet të kenë normën e njëjtë të rritjes prej 4.6 përqind. Megjithatë, konsumi privat pritet të jetë bartës i rritjes së gjithsej konsumit pasi që ka pjesëmarrjen më të lartë (85 përqind të gjithsej konsumit). Rritja e konsumit privat i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese, ndërsa rritja e konsumit publik i atribuohet rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë.

Eksportet neto, të cilat kanë një pjesëmarrje negative prej rreth -30.6 përqind në PBB, pritet të shënojnë rënie nominale prej 5.8 përqind. Me fjalë të tjera, deficitin prej 1.73 miliardë euro në vitin 2012 pritet të ngushtohet në 1.63 miliardë euro në vitin 2013. Ky ngushtim i deficitit kontribuon pozitivisht në normën e rritjes ekonomike në vend. Projektionet aktuale sugjerojnë për një rritje të eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 3.6 përqind, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të shënojë rënie prej 2.6 përqind.

Figura 17. Komponentët Kryesore të PBB-së, në miliardë euro



Investimet, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 24.3 përqind në PBB, përkundër ndikimit neutral në PBB-në reale pritet të shënojnë rritje nominale prej 3.9 përqind gjatë vitit 2013 ndërkohë që në vitin paraprak patën shënuar rënie nominale prej 10.7 përqind. Rritja e investimeve pritet të jetë rezultat i rritjes së investimeve private prej 6.8 përqind, përderisa investimet publike pritet të shënojnë një rënie të lehtë prej 0.3 përqind. Rritja e investimeve private, të cilat përbëjnë rreth 60 përqind të gjithsej investimeve, ndër të tjera pritet të jetë rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte (IHD) dhe kredive investuese.

Të dhënat në dispozicion për strukturën ekonomike sipas aktivitetit janë vetëm për periudhën 2006-2011, mirëpo duke marrë parasysh strukturën ekonomike të vendit, pritet që ndryshimet për vitin 2012 dhe 2013 të jenë marginale. Bazuar në ndryshimet e strukturës së importeve por edhe treguesve të tjerë siç janë regjistrimi i bizneseve të reja, IHD-ve, kredive nga bankat për sektorë të caktuar, etj. mund të sugjerohet se industria përpunuese dhe prodhuese, bujqësia, ndërtimtaria, dhe patundshmëritë mund të shënojnë rritje, ndërsa sektori i tregtisë pritet të karakterizohet me rënie. Këto zhvillime për vitin 2013 përkrahen edhe nga anketa e Odës Ekonomike të Kosovës lidhur me perceptimin e ndërmarrjeve për klimën biznesore në Kosovë. Sipas kësaj ankete, tregtia me shumicë dhe pakicë ka raportuar performancë më të dobët në krahasim me pritjet, ndërsa sektori i prodhimit dhe ai i shërbimeve kanë raportuar performancë më të mirë.

4.2. Sektori Fiskal

Vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore deri në fund të qershorit 2013 arriti në 612.2 milionë euro që paraqet një rritje prej 0.9 përqind. Në anën tjetër, të hyrat buxhetore shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind duke arritur vlerën prej 606.8 milionë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës në gjysmën e parë të vitit 2013 regjistroi deficit primar prej 5.4 milionë euro. Ekzekutimi i buxhetit, deri në qershor 2013, arriti në rreth 38 përqind e planit për vitin 2013 (39 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak), ndërkohë që realizimi i të hyrave buxhetore ishte pothuajse i njëjtë krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2012 (43 përqind e planit vjetor).

Investimet publike të cilat në vitet e fundit kanë dhënë kontribut mjaft të rëndësishëm në rritjen ekonomike kur merren parasysh projektet e investimeve kapitale, në gjysmën e parë të vitit 2013

shënuan rënie prej 13.4 përqind dhe u realizuan vetëm në masën e 30 përqind të planit për vitin 2013 (40 përqind në gjysmën e parë të vitit 2012). Përkundër kësaj rënie, shpenzimet kapitale vazhdojnë të paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 31.8 përqind të gjithsej shpenzimeve apo 194.8 milionë euro. Po ashtu, deri në muajin qershor, shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie vjetore prej 0.9 përqind, duke shënuar vlerën prej 88.5 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje si dhe shpenzimet qeveritare për subvencione dhe transfere kanë shënuar rritje prej 2.9 përkatësisht 23.5 përqind dhe kanë arritur në 173.9 përkatësisht 157.4 milionë euro, duke i kontribuar pozitivisht rritjes së konsumit të përgjithshëm.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore deri në qershor 2013, të hyrat e mbledhura në kufi kanë shënuar rritje prej 2.2 përqind dhe kanë arritur nivelin prej 362.0 milionë euro. Ndërsa, të hyrat e mbledhura brenda vendit kanë shënuar rritje prej 9.4 përqind dhe kanë arritur nivelin prej 147.8 milionë euro në qershor 2013. Rritja e të hyrave vendore është kryesisht rezultat i ngritjes së efikasitetit të ATK-së në mbledhjen e të hyrave dhe lehtësimit të procedurave për deklarimin dhe pagesën e obligimeve tatimore por edhe i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend. Në kuadër të ngritjes së efikasitetit të ATK-së, mund të theksohet projekti i fiskalizimit të bizneseve i cili ka vazhduar edhe në vitin 2013.


4.3. Bilanci i pagesave

Bilanci i Pagesave në Kosovë vazhdon të karakterizohet me deficit të llogarisë rrjedhëse dhe me bilanc pozitiv në llogarinë kapitale dhe financiare. Deficiti i llogarisë rrjedhëse (i prirë kryesisht nga deficiti në bilancin tregtar), përkundër përmirësimeve gjatë vitit 2012 dhe gjysmës së parë të vitit 2013, vazhdon të mbetet në nivel relativisht të lartë. Financimi i këtij deficiti nga llogaria kapitale dhe financiare vazhdon të jetë i qëndrueshëm, kryesisht për shkak të rritjes së IHD-ve dhe kredive tregtare.

Tregtia e mallrave, si komponenti kryesor i llogarisë rrjedhëse, në vazhdimësi është duke u karakterizuar me shkallë të lartë të deficitit (figura 18). Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013, deficiti tregtar shënoj rënie prej 0.6 përqind dhe arriti vlerën prej 984.5 milionë euro. Importet shënuan vlerën prej 1.13 miliardë euro (rritje vjetore prej 0.6 përqind), ndërsa eksportet arritën në 148.8 milionë euro (rritje vjetore prej 9.9 përqind). Rritja më e ngadalësuar e importeve kryesisht mund t'i

atribuohet rënies së çmimeve të derivateve të naftës si dhe mundësisë që një pjesë e importeve të jetë zëvendësuar me prodhime vendore. Ndërsa, rritja e eksporteve i atribuohet rritjes së eksportit të produkteve ushqimore dhe produkteve nga plastika dhe druri. Rritja më e lartë e eksporteve se sa importeve ka bërë që niveli i mbulueshmërisë së importeve me eksporte të përmirësohet nga 12.0 përqind, sa ishte në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, në 13.1 përqind në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013.

Figura 18. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2013)

Kategori tjetër me peshë mjaft të madhe në llogarinë rrjedhëse është llogaria e transfereve rrjedhëse, e cila dominohet nga remitencat. Kjo kategori vazhdimisht është karakterizuar me bilanc pozitiv dhe ka kontribuar dukshëm në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse si dhe në rritjen e konsumit. Deri në qershor të vitit 2013, remitencat arritën vlerën prej 272.4 milion euro që është për 4.2 përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë e vitit paraprak (figura 19). Bazuar në trendin aktual të remitencave por edhe pritjeve për performancë më të mirë ekonomike në vendet në të cilat është e koncentruar diaspora kosovare pritet që remitencat deri në fund të vitit të arrijnë nivelin e mbi 632 milionë euro apo rreth 4.5 përqind më shumë se sa në vitin e kaluar.

Llogaria kapitale dhe financiare e bilancit të pagesave vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv, që rrjedhë kryesisht nga Investimet e Huaja Direkte (IHD). IHD-të e pranuar në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 arritën vlerën prej 143.4 milionë euro, që paraqet një rritje prej 66.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Siç edhe është paraqitur në figurën 19, përkundër dominimit të patundshmërive në IHD, vërehet një rënie e lehtë në strukturë bashkë me sektorin e ndërtimitarisë, ndërsa janë rritur IHD-të në transport dhe telekomunikacion dhe shërbime financiare. IHD-të në gjysmën e parë të vitit 2013 kanë qenë kryesisht në formë të kapitalit aksionar me 62.5 përqind, pasuar nga kreditë ndërmjet ndërmarrjeve me 19.1 përqind dhe fitimi i ri-investuar i kompanive me 18.4 përqind. Të gjithë këta komponentë të IHD-ve kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ku prinë kapitali aksionar me 79.3 përqind rritje, pasuar nga fitimi i ri-investuar me 55.0 përqind dhe kreditë ndërmjet ndërmarrjeve me 40.2 përqind rritje. Deri në fund të vitit 2013, IHD-të pritet të shënojnë rritje prej rreth 12 përqind dhe të arrijnë nivelin prej rreth 258 milionë euro.

4.4. Tregu i punës

Një ndër sfidat kryesore në Kosovë mbetet norma e lartë e papunësisë e cila konsiderohet si barra kryesore e ekonomisë vendore. Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore të publikuar nga ASK-ja, shkalla e papunësisë në Kosovë, në vitin 2012 ishte 30.9 përqind. Papunësia dominon tek moshat e reja dhe është më e lartë tek gjinia femërore (figura 20). Pjesa më e madhe e të papunëve klasifikohen si të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj) gjë që ka rezultuar që edhe numri i individëve që janë të dekurajuar të kërkojnë punë të jetë relativisht i lartë (14.8 përqind e popullsisë në moshë pune). Sa i përket të punësuarve sipas

Figura 19. IHD sipas sektorëve kryesor ekonomik






Figura 20. Papunësia sipas grupmoshave dhe gjinisë




sektorëve, sektori i prodhimitarisë punëson numrin më të madh të punonjësve në vend me mbi 14 përqind, përcjell nga aktiviteti tregtar dhe shërbimet riparuese me 13.4 përqind si dhe arsimit me 12.0 përqind. Edhe ndërtimtaria paraqitet me pjesëmarrje relativisht të lartë prej 9.5 përqind të gjithësej të punësuarve.

4.5. Çmimet

Inflacioni në Kosovë, i matur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), në gjashtëmuorin e parë të vitit 2013 ishte 2.7 përqind apo 1.1 pikë përqindje më i lartë se sa në periudhën e njëjtë e vitit paraprak, ndërkohë që në gjysmën e dytë të vitit 2013 vërehet trend i rënies së inflacionit si rezultat i presioneve deflacioniste në vendet e eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare. Komponentët kryesorë të CPI-së që ndikuan në ngritjen e inflacionit në gjashtëmuorin e parë ishin produktet ushqimore, pijet dhe duhani si dhe me efekt më të lehtë energjia elektrike (Figura 21).



Çmimet e produkteve ushqimore kanë determinuar lëvizjen e çmimeve edhe në vitet e kaluara, dhe ky ndikim i çmimeve të ushqimit në çmimet e përgjithshme është i kuptueshëm pasi që lëvizja e çmimeve të ushqimit ka qenë më e theksuar. Për më tepër, shporta e konsumatorit kosovar dominohet nga kategoria e produkteve ushqimore me 37.8 përqind të gjithësej shportës dhe kjo e bënë që ndikimi i kësaj kategorie në gjithësej lëvizjen e çmimeve të jetë më i lartë se sa në vendet tjera. Rrjedhimisht, inflacionit bazë, i cili përjashton kategorinë e ushqimit dhe në këtë mënyrë përjashton efektin e luhatjeve sezonale të çmimeve si rezultat i ofertës, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me stabilitetin e çmimeve në Kosovë. Siç shihet në figurën 22 lëvizja e inflacionit bazë ka qenë më stabile dhe është zhvilluar në kuadër të një hapësire më të ngushtë se sa inflacioni i përgjithshëm.




Si pasojë e mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe, niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend është i ndikuar nga lëvizja e çmimeve të mallrave të importuara. Kjo reflektohet edhe nëpërmjet indeksit të çmimeve të importit (angl: Import Price Index: IPI). Mesatarja vjetore e IPI-së deri në qershor 2013 është rritur për 1.1 përqind, dhe siç është paraqitur në figurën 23, edhe CPI-ja ka treguar sjellje të ngjashme më IPI-në. Ndërsa, çmimet e prodhimit (angl. Producer Price Index: PPI), deri në qershor 2013 kanë shënuar rritje vjetore prej 4.9 përqind. Kjo rritje ishte e nxitur nga rritja e peshës së mineraleve metalike që aktualisht përbëjnë 14.9 përqind të gjithësej indeksit të prodhuesit në vend (5 përqind në 2012) si dhe rritjes

së çmimit të tyre për 17.9 përqind. Rritja e peshës së kësaj kategorie ka ardhur si rezultat i rritjes së përgjithshme të prodhimit të mineraleve metalike.

Stabiliteti i çmimeve u reflektua edhe në normën reale efektive të këmbimit (NREK) të Euros në Kosovë kundrejt valutave të partnerëve tregtar. NREK gjithsej deri në qershor 2013 u vlerësua për vetëm 0.3 përqind që është i nxitur nga rritja e çmimeve në Kosovë më shumë se sa në vendet partnere tregtare. Ky stabilitet i NREK-ut vërehet si ndaj

vendeve anëtare të BE-së ashtu edhe ndaj vendeve të CEFTA-së. Koncretisht, NREK-u u vlerësua për 0.8 përqind ndaj vendeve të BE-së ndërsa u zhvlerësua për 0.7 përqind ndaj vendeve të CEFTA-së, gjë që nënkupton se produktet kosovare mund të kenë shtuar konkurrueshmërinë ndaj vendeve të CEFTA-s dhe zvogëluar ndaj vendeve të BE-së.

Figura 23. Indeksi i çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2013)

5. Sistemi Financiar i Kosovës


Aktiviteti i sistemit financiar në Kosovë vazhdoi të zgjerohet, duke mirëmbajtur nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë në të gjitha segmentet përbërëse të tij. Deri në qershor 2013, vlera e përgjithshme e aseteve të sistemit financiar arriti në 3.8 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.1 përqind (8.0 përqind në qershor 2012). Për dallim nga viti paraprak, asetet e sistemit financiar kanë filluar rikuperimin e ritmit të rritjes, dhe kontributin kryesor në këtë rritje e kishin asetet e fondeve pensionale.

Performanca e mirë e fondeve pensionale, sidomos në gjysmën e dytë të vitit 2012, që ishte kryesisht rezultat i rikuperimit të tregjeve financiare dhe tregjeve të kapitalit, ka ndikuar në rritjen e përgjithshme të aseteve të këtij segmenti prej 22.7 përqind në qershor 2013 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me rritje të aseteve, përdërisa treguesit e qëndrueshmërisë vazhduan të tregojnë një gjendje të kënaqshme të shëndetit të këtij sektori. Në qershor 2013, asetet e sektorit bankar arritën vlerën prej 2.8 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind (6.0 përqind në qershor 2012). Ritmi i ngadalësuar i rritjes që karakterizoi asetet e sektorit bankar që nga viti 2009 vazhdoi edhe në vitin 2013, kur rritja vjetore e shënuar ishte më e ngadalshme krahasuar me vitin paraprak. Me trend më të ngadalësuar të rritjes u karakterizua edhe industria e sigurimeve, asetet e së cilës shënuan një rritje vjetore prej 8.2 përqind në qershor 2013 krahasuar me rritjen prej 16.2 përqind në qershor 2012. Sikurse në vitin paraprak, si pasojë e tkurrjes së aktivitetit të tyre, asetet e institucioneve mikrofinanciare dhe asetet e ndihmësve financiar vazhduan të shënojnë rënie.

Sektori bankar vijon të mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në vend, asetet e së cilit përfaqësuan 72.6 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në qershor 2013 (74.7 përqind në qershor 2012). Rritja e përshpejtuar e aseteve të fondeve pensionale, segmentit të dytë për nga madhësia në sistemin financiar, ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në 21.1 përqind të gjithsej aseteve të sektorit financiar në qershor 2013 (18.5 përqind në qershor 2012 dhe 16.8 përqind në qershor 2011). Sa i përket segmenteve tjera, pjesëmarrja e aseteve të kompanive të sigurimit mbeti e pandryshuar nga viti paraprak në 3.4 përqind, përdërisa pjesëmarrja e aseteve të institucioneve mikrofinanciare vijoi të zvogëlohet duke zbritur në 2.9 përqind të gjithsej aseteve të sektorit financiar (3.4 përqind në qershor 2012) (figura 24).

Struktura e sistemit financiar të Kosovës mbeti e ngjashme me periudhat e kaluara sa i përket numrit të institucioneve financiare të cilat operojnë në tregun financiar në vend. Në qershor 2013, në Kosovë operuan gjithsej 82 institucione financiare, numrin më të madh të të cilave e përbëjnë ndihmësit financiarë dhe institucionet mikrofinanciare që së bashku janë 58 institucione, por të cilat menaxhojnë pjesën më të vogël të aseteve të sektorit financiar. Përdërisa pas licencimit të degës së Turkiye İş Bankası numri i bankave komerciale që operojnë në Kosovë është rritur në nëntë (9) në fund të vitit 2012, numri i kompanive në industrisë e sigurimeve ka mbetur i pandryshuar nga viti i kaluar në trembëdhjetë (13) dhe numri i fondeve pensionale në dy (2), (tabela 4).

Figura 24. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2013)

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	Qershor 2010	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013
Bankat komerciale	8	8	8	9
Kompanitë e sigurimeve	11	11	13	13
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	29	32	39	40
Institucionet mikrofinanciare	17	17	19	18

Burimi: BQK (2013)

Një pjesë e konsiderueshme e aseteve të sistemit financiar të Kosovës (përfshirë BQK-në) vazhdojnë të investohen jashtë vendit, përderisa shfrytëzimi i financimit nga jashtë vazhdon të jetë në nivel relativisht të ulët. Vlera e Aseteve të Jashtme Neto (AJN)³ në qershor 2013 arriti në rreth 2.35 miliardë euro, një rritje vjetore prej 13.0 përqind (4.7 përqind rritje vjetore në qershor 2012). Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej AJN-të vazhdojnë ta kenë asetet e BQK-së (53.2 përqind), pasuar nga bankat komerciale (16.2 përqind) dhe institucionet tjera financiare (30.6 përqind)


(figura 25). Institucionet mikrofinanciare, detyrimet e të cilave (kryesisht në formë të linjave kreditore) janë më të mëdha ndaj sektorit të jashtëm krahasuar me kërkesat e këtij sektori ndaj sektorit të jashtëm, kanë vazhduar të shënojnë bilanc negativ të AJN-ve. Me përjashtim të AJN-ve të institucioneve mikrofinanciare, të gjitha segmentet tjera të sistemit financiar kanë shënuar bilanc pozitiv të AJN-ve në këtë periudhë. Në qershor 2013, kërkesat ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 2.79 miliardë euro, një rritje vjetore prej 14.2 përqind (1.0 përqind në qershor 2012). Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm rritjen më të lartë e kanë shënuar investimet në letra me vlerë, kategori kjo që ka një pjesëmarrje prej 23.1 përqind në gjithsej kërkesat ndaj sektorit të jashtëm (figura 26). Investimet në letra me vlerë arritën vlerën 646.2 milionë euro në qershor 2013 (239.1 milionë euro në qershor 2012). Kjo rritje e investimeve në letra me vlerë kryesisht i atribuohet rritjes së investimeve të BQK-së në këtë instrument gjatë kësaj periudhe. Krahas rritjes së investimeve në letra me vlerë, sistemi financiar i Kosovës ka zvogëluar investimet në depozitat në tregjet e jashtme. Në qershor 2013, vlera e depozitave në tregjet e jashtme ishte për 19.8 përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Megjithatë, depozitat vazhdojnë të përfaqësojnë instrumentin në të

Figura 25. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 26. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

³ Në këtë kontekst, sistemi financiar përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë.


cilin janë të investuara pjesa më e madhe e aseteve të sektorit financiar të Kosovës në tregjet e jashtme. Me një pjesëmarrje prej 27.9 përqind në gjithsej kërkesat ndaj sektorit të jashtëm, investimet e sistemit financiar të Kosovës në aksione dhe ekuitete tjera rritën vlerën e tyre në 777.9 milionë në qershor 2013 (598.7 milionë në qershor 2012).⁴

Shikuar sipas sektorëve të veçantë, të dhënat tregojnë se BQK ka zhvendosur një pjesë të investimeve nga depozitat drejtë letrave me vlerë, ndërsa bankat komerciale kanë zvogëluar investimet e tyre në sektorin e jashtëm si në depozita ashtu edhe në letra me vlerë, përderisa fondet pensionale kanë vazhduar të investojnë në aksione dhe ekuitete tjera.

Në qershor 2013, gjithsej detyrimet e sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 440.4 milionë euro (rritje vjetore prej 21.0 përqind). Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm kryesisht përbëhen nga kreditë që institucionet financiare që operojnë në Kosovë kanë pranuar nga institucionet financiare që operojnë jashtë vendit (29.7 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm), depozitat e jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë (17.6 përqind) dhe kuota e FMN-së (37.2 përqind) (figura 27). Rritja e detyrimeve të sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm ishte kryesisht rezultat i rritjes së kuotës së FMN-së në qershor 2013 në 163.7 milionë euro (79.6 milionë euro në qershor 2012). Përderisa depozitat e jorezidentëve në sektorin bankar në vend shënuan një rritje vjetore prej 0.2 përqind, kreditë që institucionet financiare në vend kanë marrë nga sektori i jashtëm u zvogëluar për 3.0 përqind. Shikuar sipas sektorëve, detyrimet e BQK-së ndaj sektorit të jashtëm kryesisht përbëhen nga kuota e FMN-së, ndërkaq detyrimet e bankave komerciale dhe institucioneve mikrofinanciare përbëhen nga linjat kreditore të marra nga jashtë dhe depozitat e jorezidentëve në bankat komerciale.

Në qershor 2013, kërkesat ndaj sektorit të brendshëm arritën vlerën prej 1.11 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 25.8 përqind në qershor 2012. Kërkesat ndaj sektorit të brendshëm përbëhen kryesisht nga kërkesat ndaj qeverisë qendrore dhe kërkesat ndaj sektorit real. Kërkesat ndaj qeverisë qendrore (kryesisht kërkesa të sektorit bankar) arritën vlerën prej 110.9 milionë euro në qershor 2013 (29.9 milionë euro në qershor 2012). Në të njëjtën kohë, detyrimet ndaj qeverisë qendrore që kryesisht përbëhen nga depozitat e qeverisë në bankën qendrore arritën vlerën prej 909.5 milionë euro, një rritje vjetore prej 9.4 përqind (rënie vjetore prej 8.2 përqind në qershor 2012).

Figura 27. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

⁴Vlen të theksohet se kategoria "paraja e gatshme" në kuadër të kërkesave të sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm paraqet mjetet që ndodhen në sistemin financiar në vend, por për çështje të klasifikimit të monedhës së euros si aset i huaj janë kategorizuar në kuadër të kërkesave ndaj sektorit të jashtëm. Në qershor 2013, paraja e gatshme arrinte vlerën prej 141.7 milionë euro.

6. Sektori Bankar i Kosovës

Sektorit bankar në Kosovë iu shtua një bankë e re në fund të vitit 2012, duke ngritur kështu numrin e bankave komerciale në nëntë (9). Sipas pronësisë, struktura e sektorit bankar mbeti e ngjashme me periudhat paraprake, ku dominojnë bankat me pronësi të huaj. Nga gjithsej nëntë banka që operojnë në tregun bankar, shtatë kanë pronësi të huaj dhe përbëjnë 89.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ndërkaq dy kanë pronësi vendore dhe menaxhojnë pjesën e mbetur të aseteve prej 11.0 përqind.

Figura 28. HHI për asetet, kreditë dhe depozitat



Burimi: BQK (2013)

Rritja më e shpejtë e aseteve të bankave të vogla krahasuar me bankat e mëdha ka ndikuar në rënien e shkallës së koncentrimit të tregut bankar. Në qershor 2013, pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha ka zbritur në 67.9 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, krahasuar me pjesëmarrjen prej 72.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e shkallës së koncentrimit në tregun bankar shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), trendi rënës i të cilit tregon për një rënie të koncentrimit për asetet, kreditë dhe depozitat e sektorit bankar (figura 28). Sipas IHH-së për gjithsej asetet, tregu bankar u karakterizua me një shkallë koncentrimi prej 1,911 pikë në qershor 2013 që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, tregon për një rënie të shkallës së koncentrimit për 131 pikë të IHH-së. Shkalla e koncentrimit të tregut bankar vërehet se ka shënuar rënie edhe bazuar në IHH për gjithsej depozitat dhe kreditë e sektorit bankar.

Ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm mbetet i ulët si në kuadër të aseteve, ashtu edhe të detyrimeve. Në qershor 2013, 19.1 përqind e gjithsej aseteve të sektorit bankar dhe 5.4 përqind e gjithsej detyrimeve të sektorit bankar ishin investuar në sektorin e jashtëm. Varësia e sektorit bankar të Kosovës ndaj burimeve të jashtme të financimit mbetet e kufizuar, përderisa depozitat e jorezidentëve vazhdojnë të kenë pjesëmarrje më të lartë në gjithsej detyrimet ndaj sektorit të jashtëm (51.2 përqind në qershor 2013) krahasuar linjat kreditore të marra nga jashtë (45.6 përqind në qershor 2013). Pjesëmarrja e linjave kreditore që bankat kanë marrë nga jashtë në gjithsej detyrimet e sektorit bankar në qershor 2013 ishte vetëm 2.5 përqind. Mbështetja e ulët e sektorit bankar të Kosovës në financimin nga jashtë ka kufizuar rrezikun nga tkurrja e kreditimit nga bankat amë me të cilin po ballafaqohen shumë vende aktualisht kryesisht si pasojë e presioneve aktuale të bankave evropiane për zvogëlimin e kreditimit ndërkufitar (angl: deleveraging).

6.1. Bilanci i gjendjes së sistemit bankar

6.1.1 Asetet


Vlera e aseteve të sektorit bankar të Kosovës shënoi rritje, megjithëse me ritëm të ngadalësuar krahasuar me periudhat e kaluara. Gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën prej 2.79 miliard euro në qershor 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind (6.1 përqind në qershor 2012 dhe 12.7 përqind në qershor 2011). Rritja e aseteve të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe kishte kontribut të kufizuar në financimin e ekonomisë, duke qenë se rritjen më të

madhe në kuadër të aseteve e ka shënuar kategoria e bilancit në BQK. Në ecurinë e aseteve, vihet re një zgjerim i portfolios bankare në investime në letra me vlerë, përdërisa kontributi i aktivitetit kreditues në rritjen e gjithsej aseteve është në rënie që nga viti 2011.

Kategoria e bilancit me BQK shënoi rritje vjetore prej 31.0 përqind në qershor 2013, krahasuar me rritjen vjetore prej 14.2 përqind në qershor 2012, duke arritur vlerën prej 254.1 milion euro (figura 29). Vlera e gjithsej investimeve të sektorit bankar në letra me vlerë arriti në 246.3 milionë euro në qershor 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 14.3 përqind (4.8 përqind në qershor 2012), gjë që tregon për një orientim më të madh të investimeve të sektorit bankar drejtë investimeve në letra me vlerë. Nga gjithsej investimet në letra me vlerë deri në qershor 2013, vlera e investimeve në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës arriti në 99.3 milion euro (29.8 milion euro në qershor 2012) përdërisa vlera e letrave me vlerë të investuara në ekonominë e jashtme u zvogëluar në 147.0 milion euro (185.7 milion euro në qershor 2012).

Në anën tjetër, kreditimi i ekonomisë vendore që përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit bankar të Kosovës ka shënuar rritje por ka vazhduar me ngadalësimin e trendit të rritjes. Në qershor 2013, gjithsej kreditë shënuan vlerën prej 1.8 miliardë euro, që paraqet rritjen më të ulët vjetore të shënuar që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar të Kosovës prej 2.8 përqind (9.3 përqind në qershor 2012 dhe 15.7 përqind në qershor 2011).

Figura 29. Struktura e aseteve të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Tabela 5. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2010		Qershor 2011		Qershor 2012		Qershor 2013	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	268.1	12.1	265.3	10.6	298.4	11.3	355.4	12.8
Bilanci me bankat komerciale	351.6	15.8	319.5	12.8	265.3	10.0	261.4	9.4
Letrat me vlerë	114.0	5.1	205.6	8.2	215.6	8.1	246.3	8.8
Kreditë bruto	1404.6	63.3	1624.9	65.0	1776.3	67.0	1,825.7	65.5
Asetet fikse	42.6	1.9	45.0	1.8	49.9	1.9	57.6	2.1
Asetet tjera	37.8	1.7	40.7	1.6	46.9	1.8	40.5	1.5
Gjithsej	2,218.8	100.0	2,501.0	100.0	2,652.3	100.0	2,787.0	100.0

Burimi: BQK (2013)

Ecuria që karakterizoi zërat kryesor të aseteve deri në qershor 2013 ndikoi edhe në strukturën përgjithshme të aseteve të sektorit bankar. Kreditë vijuan të dominojnë strukturën e gjithsej aseteve me një pjesëmarrje prej 65.5 përqind në qershor 2013 (67.0 përqind në qershor 2012), megjithëse ritmi i ngadalshëm i rritjes që karakterizoi kreditë gjatë kësaj periudhe ndikoi në zvogëlimin e pjesëmarrjes së tyre në gjithsej asetet. Me zvogëlim të pjesëmarrjes në kuadër të aseteve të sektorit bankar u karakterizuan edhe bilanci me bankat komerciale dhe paraja e gatshme, që kishin një pjesëmarrje prej 3.6 përkatësisht 9.4 përqind në qershor 2013 (3.9 përkatësisht 10.0 përqind në qershor 2012). Në anën tjetër, rritja e përsheptuar e kategorisë së


bilancit me BQK-në, që paraqet rezervat që bankat komerciale kanë në BQK, ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në 9.1 përqind (7.3 përqind në qershor 2012). Në të njëjtën kohë, investimet në letra me vlerë rritën pjesëmarrjen në 8.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, krahasuar me 8.1 përqind në qershor 2012 (tabela 5).

Nga gjithsej portfolio e investimeve në letra me vlerë të sektorit bankar të Kosovës, pjesëmarrja e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës është rritur në 40.3 përqind në qershor 2013 (13.8 përqind në qershor 2012), që tregon për një interesim të lartë të bankave të Kosovës për investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës (figura 30). Struktura e mjeteve të investuara në tregjet e jashtme mbeti e pandryshuar nga vitet e kaluara, ku pjesa dërmuese e tyre është investuar në fletëobligacione qeveritare, përderisa pjesëmarrja e investimeve në letra me vlerë të korporatave financiare në gjithsej portofolin e investimeve me letra në vlerë jashtë vendit ka mbetur shumë e ulët. Zgjerimi i portfolios së investimeve në letra me vlerë gjatë kësaj periudhe, në veçanti përqëndrimi i investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës si dhe rritja e rezervave të bankave komerciale në BQK kundrejt rritjes së aktivitetit kreditor reflekton një qasje më konzervative të bankave komerciale duke favorizuar investimet që bartin rrezik më të ulët.

6.1.2 Kreditë

Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga sektori bankar i Kosovës arriti në 1.83 miliardë euro në qershor 2013, që paraqet një normë vjetore të rritjes prej 2.8 përqind krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 9.3 përqind në qershor 2012. Norma e rritjes së kredive në qershor 2013 paraqet normën më të ulët të rritjes që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar të Kosovës. Ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë nga bankat komerciale u reflektua si tek kreditë për ekonomitë familjare, ashtu edhe te kreditë për ndërmarrjet. Kreditë për ekonomitë familjare shënuan një rritje vjetore prej 4.4 përqind në


Figura 30. Struktura e letrave me vlerë, në



Burimi: BQK (2013)


qershor 2013 (13.8 përqind në qershor 2012), që tregon për një interesim të lartë të bankave të Kosovës për investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës (figura 30). Struktura e mjeteve të investuara në tregjet e jashtme mbeti e pandryshuar nga vitet e kaluara, ku pjesa dërmuese e tyre është investuar në fletëobligacione qeveritare,

Figura 31. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 32. Struktura e kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

qershor 2013, krahasuar me rritjen vjetore prej 11.7 përqind në vitin paraprak. Ngjashëm, kreditë për ndërmarrjet u karakterizuan me ngadalësim të rritjes në 3.1 përqind, nga 6.9 përqind në qershor 2012 (figura 31). Kjo tregon se ngadalësimi i aktivitetit kredidhënës tani më nuk është i lidhur posaçërisht me kreditë për ndërmarrjet, por bëhet fjalë për një shtrëngim të përgjithshëm të kreditimit bankar në vend.

Vëllimi i aktivitetit kreditues vijoi të ngadalësohet në një periudhë kur sektori bankar u karakterizua me nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe gjendje të shëndoshë sa i përket shkallës së kapitalizimit dhe cilësisë së portofolit kreditor. Gjithashtu, zhvillimet makroekonomike në vend gjatë vitit 2013 tregojnë për një rritje më të qëndrueshme ekonomike krahasuar me vitin paraprak dhe pritjet për vitin 2014 tregojnë për përmirësim të mëtejme të rritjes ekonomike, gjë që mund të konsiderohet se zvogëlon rrezikun potencial për sektorin bankar që mund të rrjedhë nga zhvillimet makroekonomike në vend.

Shtrëngimi kreditor nga sektori bankar mund t'i atribuohet disa faktorëve që vlerësohen të kenë rrjedhur si nga kahu i ofertës ashtu edhe nga kahu i kërkesës për kredi. Në Anketën e Kreditimit Bankar që BQK realizon me bankat komerciale në Kosovë, bankat kanë raportuar shtrëngim të standardeve kreditore për aprovimin e aplikacioneve për kredi, dhe në të njëjtën kohë kanë raportuar edhe rënie të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet (kutia 2).


Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar për Kosovën

Duke filluar nga viti 2011, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka filluar të zhvillojë Anketën e Kreditimit Bankar me qëllim që të plotësojë burimet e informacionit për vlerësimin e aktivitetit kreditor të bankave që operojnë në Kosovë.

Anketa realizohet në baza tremujore dhe kryesisht mbështetet në metodologjinë e zhvilluar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Anketa synon të pasqyrojë ndryshimet në standardet kreditore, rregullat dhe kushtet për kreditë e reja si dhe kërkesën për kredi. Gjetjet nga kjo anketë paraqesin përgjigjet e bankave, të cilat janë peshuar duke marrë për bazë pjesëmarrjen e secilës bankë në tregun kreditor në Kosovë.⁵


Sipas rezultateve të kësaj ankete, në përgjithësi, në tremujorin e dytë të vitit 2013 krahasuar me tremujorin paraprak si dhe tremujorin e dytë të vitit 2012, bankat kanë shtrënguar 'deri në një masë' standardet kreditore të aplikuara për aprovimin e kredive apo linjave kreditore për ndërmarrjet. Shtrëngimi i standardeve kreditore për ndërmarrjet kryesisht i atribuohet shtrëngimit të standardeve të

Figura 33. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 34. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

⁵ Shpjegimi më i detajuar i metodologjisë së Anketës për Kreditimin Bankar mund të gjendet në Raportin e Stabilitetit Financiar, numër 2, Dhjetor 2011.

kreditimit për ndërmarrjet e mëdha, ndërkohë që standardet kreditore të aplikuara për kreditë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) janë lehtësuar 'deri në një masë'. Anketa e tremujorit të dytë 2013 përfaqëson tremujorin e dytë radhazi në të cilin bankat raportojnë shtrëngim të përgjithshëm të standardeve kreditore për ndërmarrjet, veçanërisht për ndërmarrjet e mëdha (figura 35), megjithëse anketa e tremujorit të parë tregonte për një shtrëngim edhe më të madh të standardeve të kreditimit për këtë sektor.


Faktorët kryesorë që shpjegojnë politikën më të shtrënguar të kreditimit për ndërmarrjet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013, sikurse edhe në tremujorin e dytë 2012, ishin pritjet e bankave në lidhje me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik dhe problemet specifike të sektorit ku zhvillon aktivitetin industria apo

Figura 35. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2013)


Figura 36. Faktorët që kanë ndikuar në standardet e aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK (2013)


ndërmarrja e caktuar. Ndërsa, faktorët si niveli aktual dhe i pritshëm i likuiditetit të bankës dhe konkurrenca nga bankat tjera i kontribuuan lehtësimit të standardeve të kreditimit (figura 36). Politika shtrënguese e bankave për kreditimin e ndërmarrjeve është realizuar kryesisht përmes zvogëlimit të madhësisë së kredisë, rritjes së kërkesave për kolateral dhe shkurtimit të afatit të maturimit për kreditë e reja (figura 37).

Figura 37. Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditimin e ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2013)

Figura 38. Faktorët që kanë ndikuar në standardet e aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK (2013)

Standardet e kreditimit për kreditë e ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013. Sipas qëllimit të përdorimit, ngjashëm me tremujorin e parë të vitit 2013, standardet e aplikuara për kreditë kons umuese gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013 janë lehtësuar deri në një masë. Në anën tjetër, për dallim nga rezultatet e pyetësorit të tremujorit të parë, në të cilin bankat deklaruan lehtësim deri në një masë të standardeve për kreditë për blerje të shtëpive, rezultatet në pyetësorin e tremujorit të dytë tregojnë për shtrëngim deri në një masë të standardeve të kreditimit për këtë kategori. Shtrëngimi i standardeve kreditore për ekonomitë familjare kryesisht i atribuohet pritjeve të bankave komerciale për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, përderisa kreditë e lëshuara nga bankat tjera dhe performanca e mirë e portofolios së kredive konsumuese ndikuan në lehtësimin deri në një masë të standardeve kreditore për blerje të shtëpive dhe kredive tjera konsumuese (figura 38). Lehtësimi i standardeve të kreditimit për ekonomitë familjare kryesisht u realizua përmes zvogëlimit të normave të interesit për kreditë mesatare, zgjatjes së afatit të maturimit dhe zvogëlimit të ngarkesave tjera nga norma e interesit. Në anën tjetër, bankat shfrytëzuan rritjen e normave të interesit për kreditë me rrezikshmëri


më të lartë dhe rritjen e kërkesave për kolateral për të shtrënguar kriteret e kreditimit për këtë kategori (figura 39).

Figura 39. Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditimin e ekonomive familjare



Burimi: BQK (2013)

Figura 40. Kërkesat për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK (2013)

Rezultatet e anketës për tremujorin e dytë të vitit 2013 tregojnë se, në përgjithësi, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet është rritur lehtësisht, krahasuar me rënien e raportuar në dy tremujorët paraprak. Kërkesa për kredi ka qenë më e lartë nga NVM-të, përderisa kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha u zvogëlua. Tremujori i dytë i vitit 2013 paraqet tremujorin e tretë radhazi kur bankat raportuan kërkesë më të ulët për kredi nga ndërmarrjet e mëdha (figura 40). Sikurse në tremujorët paraprak, rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, sipas bankave pjesëmarrëse në anketë, vazhdoi të nxitet kryesisht nga kërkesa e ulët për financimin e investimeve fikse, ristrukturimi i borxhit dhe konkurrenca sa i përket kredive nga bankat e tjera. Faktorët që vlerësohen të kenë ndikuar në rritjen e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet ishin inventarët dhe kapitali punues.


Sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, bankat potencuan rritje deri në një masë të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive dhe kërkesës për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera në tremujorin e dytë të vitit 2013. Ndryshe nga tremujori i dytë i vitit 2013 kur bankat deklaruan rritje të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive, në tre tremujorët paraprak kërkesa për këto kredi nga ekonomitë familjare ishte zvogëluar. Kërkesa më e lartë për kredi për blerje të shtëpive kryesisht i atribuohet zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme dhe efekteve sezonale, ndërsa rritja e kërkesës për kredi konsumuese gjatë kësaj periudhe i atribuohet kryesisht shpenzimeve më të larta të ekonomive familjare për mallra me qëndrueshmëri më të gjatë (figura 41).

Figura 41. Kërkesat për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2013)

Figura 42. Pritjet për zhvillimet në kreditim në tremujorin e ardhshëm



Burimi: BQK (2013)

Lidhur me pritjet e bankave për tre muajt e ardhshëm, standardet e kredisë priten të shtrëngohen deri në një masë për ndërmarrjet. Shtrëngimi i standardeve kreditore priten të jetë më i theksuar për ndërmarrjet e mëdha, përderisa edhe NVM-të dhe kreditë afatgjata priten të ballafaqohen me shtrëngim të standardeve kreditore në tremujorin e tretë të vitit. Sa i përket ekonomive familjare, standardet e aplikuara kreditore priten të lehtësohen deri në një masë, veçanërisht për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera. Në tremujorin e tretë të vitit 2013, në përgjithësi, bankat presin një rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Me rritje më të lartë të kërkesës priten të karakterizohen NVM-të dhe kreditë afatshkurtra, përderisa ndërmarrjet e

mëdha dhe kreditë afatgjata priten të kenë zvogëlim të kërkesës për kredi në tremujorin e ardhshëm. Bankat presin rritje të kërkesës për kredi gjatë kësaj periudhe edhe për kreditë për blerje të shtëpive si dhe për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera (figura 42).


Përkundër faktit se treguesit makroekonomik në vitin 2013 në përgjithësi janë më të favorshëm krahasuar me vitin paraprak, njëra ndër arsyt e raportuara nga bankat për shtrëngimin kreditor janë edhe pritjet rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend. Ngadalësimi i kredidhënies mund të jetë ndikuar edhe nga strategjitë e bankave të huaja të cilat dominojnë strukturën e sektorit bankar të Kosovës. Kërkesat për rritje të shkallës së kapitalizimit me të cilat janë ballafaquar bankat amë të bankave të huaja që operojnë në Kosovë mund t'i kenë shtyrë bankat e huaja në Kosovë që të ndërmarrin masa për tkurrjen e ekspozimeve të tyre kreditore.

Struktura e kredive mbeti e pandryshuar nga viti i kaluar, me kreditë për ndërmarrjet që vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive të sektorit bankar me një pjesëmarrje prej 67.7 përqind në qershor 2013, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare përfaqësojnë 30.8 përqind të gjithsej kredive (figura 32).

Struktura e kredive për ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik vazhdon të jetë e ngjashme me periudhat e kaluara. Pjesa më e madhe e kredive vazhdoi të përfaqësohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat në qershor 2013 kishin një pjesëmarrje prej 53.2 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (53.1 përqind në qershor 2012). Kreditë për sektorin e industrisë, sektor ky që përfshinë minierat, prodhimtarinë, energjetikën dhe ndërtimtarinë përfaqësuan 23.8 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet në qershor 2013 (24.8 përqind në qershor 2012). Pjesëmarrjen më të ulët vazhdojnë ta kenë kreditë për bujqësinë, megjithëse në qershor 2013 rritën pjesëmarrjen në 3.9 përqind nga 3.6 përqind në qershor 2012 (figura 33).


Përderisa kreditimi i pothuajse të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi ngadalësim të rritjes, kreditë për sektorin e bujqësisë dhe shërbimet tjera (shërbime tjera tregtare, shërbime hoteliere dhe restorante dhe shërbime tjera) u karakterizuan me përsheptim të ritmit të rritjes. Në qershor 2013, kreditë për sektorin e bujqësisë arritën vlerën prej 48.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.9 përqind (7.5 përqind në vitin paraprak) (figura 34). Rritja e kreditimit të sektorit të bujqësisë sidomos në dy vitet e fundit mund të jetë pjesërisht rezultat i rritjes së mbështetjes së qeverisë së Kosovës për këtë sektor përmes subvencioneve, gjë që vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e aktivitetit në bujqësi dhe njëkohësisht kërkesës për kredi bujqësore. Gjithashtu, rritja e mbështetjes së qeverisë për sektorin e bujqësisë mund të ketë ndikuar në zvogëlimin e rrezikut të perceptuar të bankave për

Figura 43. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 44. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

kreditimin e këtij sektori. Në qershor 2013, kreditë për shërbimet tjera përshpejtuan trendin e rritjes në 7.2 përqind nga 4.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të kredive për sektorin e industrisë, kreditë për prodhimtari dhe kreditë për ndërtimtari u karakterizuan me rënie prej 5.1 përkatësisht 1.2 përqind në qershor 2013 (rritje prej 2.4 përkatësisht 4.7 përqind në qershor 2012). Gjatë kësaj periudhe, kreditë për tregti u karakterizuan me ritëm të ngadalësuar të rritjes vjetore prej 3.7 përqind krahasuar me 7.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja më e ngadalshme e kreditimit për ndërmarrjet tregtare kryesisht i atribuohet shtrëngimit të përgjithshëm të kreditimit nga bankat, por ndikim mund të ketë pasur edhe ngadalësimi i aktivitetit të ndërmarrjeve tregtare gjatë kësaj periudhe. Ngadalësimi i rritjes së importit si dhe rezultatet e Anketës për Klimën e Biznesit në Kosovë të përpiluar nga Oda Ekonomike e Kosovës mund të merren si indikacione për një aktivitet më të dobët të sektorit tregtar gjatë kësaj periudhe.

Sipas afatit të maturimit, struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë me afat më të gjatë maturimi ('mbi dy vite'), të cilat në qershor 2013 përbënin 68.0 përqind të gjithsej kredive (69.5 përqind në qershor 2012). Gjithashtu, kreditë me maturitet 'deri në një vit' kishin një pjesëmarrje të konsiderueshme prej 24.2 përqind në qershor 2013 (23.2 përqind në qershor 2012). Kreditë me maturitet 'mbi një vit deri në dy vite' rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej kreditë në 7.8 përqind në qershor 2013 nga 7.3 përqind në qershor 2012 (figura 43). Zhvendosja e lehtë e kredive me afat më të gjatë maturimi drejtë kredive me afat më të shkurtër maturimi në vitin 2013 evidentohet edhe te rritja vjetore që karakterizoi kreditë sipas afatit të maturimit. . Hezitimi i bankave për zgjerimin e kreditimit deri në qershor 2013 u reflektua sidomos tek kreditë me afat më të gjatë maturimi. Në qershor 2013, kreditë me maturitet 'mbi dy vite' shënuan një rritje vjetore prej 0.5 përqind, krahasuar me rritjen prej 10.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë me afat maturimi 'deri në një vit' u rritën për 7.2 përqind (8.1 përqind në qershor 2012). Me përshpejtim të ritmit të rritjes gjatë kësaj periudhe u karakterizuan kreditë me maturitet 'mbi një vit deri në dy vite' që shënuan rritje vjetore prej 10.9 përqind, krahasuar me rritjen prej 0.5 përqind në qershor 2012 (figura 44). Këto zhvillime janë në përputhje me rezultatet e anketës për kreditimin bankar, në të cilën bankat deklaruan shtrëngim deri në një masë të standardeve kreditore për kreditë afatgjata dhe lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për kreditë afatshkurtëra në katër kuartalët e fundit.

6.1.3 Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar të Kosovës vazhdoi të dominohet nga depozitat vendore, që paraqesin edhe burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në Kosovë. Mbështetja e lartë në depozitat vendore si burim financimi, kundrejt mbështetjes në fonde të jashtme me kosto më të lartë të financimit, ka bërë që bankat të përfitojnë nga një burim më i qëndrueshëm i financimit dhe të evitojnë ekspozimin ndaj ekonomisë së jashtme në kohë të vështirësive financiare që po kalojnë ekonomitë e vendeve të zhvilluara.

Në qershor 2013, depozitat përfaqësuan 79.0 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar krahasuar me 79.5 përqind në qershor 2012, gjë reflekton ngadalësimin e trendit të rritjes së depozitave gjatë kësaj periudhe (tabela 6). Një burim tjetër i rëndësishëm i financimit për bankat komerciale në vend janë edhe mjetet vetanake, që në qershor 2013 kishin një pjesëmarrje prej 9.8 përqind në gjithsej detyrimet. Në qershor 2013, mjetet vetanake të bankave ishin për 6.7 përqind më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjë që kryesisht i atribuohet rritjes së kapitalit aksionar por edhe profitit të realizuar nga bankat. Bilanci nga bankat tjera, si burim i jashtëm i financimit për bankat komerciale në Kosovë, shënoi vlerën prej 20.2 milionë euro që paraqet rënie krahasuar me vlerën prej 21.3 milionë euro në qershor 2012.

Ndërkaq, borxhi i ndërvarur (angl. subordinated debt) shënoi vlerën prej 36.3 milionë euro në qershor 2013, një rritje prej 17.1 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rritja e borxhit të ndërvarur gjatë kësaj periudhe mund t'i atribuohet kryesisht nevojës për rritje të kapitalit në disa nga bankat komerciale për plotësimin e kërkesave rregullative konform rregullores në fuqi të BQK-së.⁶ Bankat komerciale zvogëluan shfrytëzimin e huave tjera gjatë kësaj periudhe, që kryesisht janë linja kreditore nga institucione ndërkombëtare. Këto huazime nga bankat në qershor 2013 kishin vlerën prej 14.8 milion euro, që paraqet rënie krahasuar me vlerën prej 26.8 milion në periudhën e njëjtë të vitit 2012.

Tabela 6. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2010		Qershor 2011		Qershor 2012		Qershor 2013	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	39.7	1.8	74.3	3.0	21.3	0.8	20.2	0.7
Depozitat	1,751.5	78.9	1,957.8	78.3	2,108.5	79.5	2,201.3	79.0
Huatë tjera	25.3	1.1	12.3	0.5	26.8	1.0	14.8	0.5
Detyrimet tjera	153.5	6.9	183.2	7.3	208.9	7.9	241.3	8.7
Borxhi i ndërvarur	24.4	1.1	33.5	1.3	31.0	1.2	36.3	1.3
Mjetet vetanake	224.3	10.1	239.9	9.6	255.8	9.6	272.9	9.8
Gjithsej detyrimet	2,218.8	100.0	2,501.0	100.0	2,652.3	100.0	2,787.0	100.0

Burimi: BQK(2013)


Gjithsej detyrimet e sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën 151.1 milionë euro në qershor 2013 (146.1 milionë euro në qershor 2012) dhe përbëhen kryesisht nga depozitat e jorezidentëve në bankat komerciale që operojnë në Kosovë (51.2 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar ndaj sektorit të jashtëm) dhe kreditë (45.6 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm).

6.1.4 Depozitat

Gjithsej depozitat në sistemin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 2.2 miliardë euro në qershor 2013. Depozitat u karakterizuan me një rritje më të ngadalshme vjetore prej 4.4 përqind në qershor 2013, krahasuar me 7.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 45). Ngadalësimi i rritjes së depozitave gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të depozitave të ndërmarrjeve private dhe ndërmarrjeve publike, si dhe ritmit të ngadalësuar të rritjes së depozitave të ekonomive familjare.

Depozitat e ekonomive familjare në sektorin bankar arritën vlerën prej 1.6 miliardë euro në qershor 2013, një rritje vjetore prej 8.3 përqind (12.2 përqind në qershor 2012; 19.0 përqind në qershor 2011). Trendi më i ngadalshëm i rritjes së depozitave të ekonomive familjare gjatë kësaj

Figura 45. Trendi i rritjes së depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

⁶Sipas rregullores së re për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, në fuqi që nga fundi i vitit 2012, BQK shtrëngoi kërkesat për përllogaritjen e kapitalit rregullativ nga bankat komerciale.

periudhe nuk u reflektua edhe në pjesëmarrjen e këtyre depozitave në gjithsej depozitat e sektorit bankar. Depozitat e ekonomive familjare kishin një pjesëmarrje prej 74.8 përqind në qershor të vitit 2013, një rritje krahasuar me pjesëmarrjen prej 72.1 përqind në qershor 2012 (figura 46).


Në qershor 2013, depozitat e ndërmarrjeve kishin një vlerë prej 449.4 milionë euro, një rënie vjetore prej 7.5 përqind. Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve, depozitat e ndërmarrjeve private u karakterizuan me rënie vjetore prej 7.4 përqind, përderisa depozitat e ndërmarrjeve publike u zvogëluan për 8.2 përqind. Depozitat e ndërmarrjeve private dhe publike në sektorin bankar zvogëluan edhe pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat nga 19.7 përkatësisht 3.3 përqind të gjithsej depozitave në qershor 2012, në 17.5 përkatësisht 2.9

përqind në qershor 2013. Zvogëlimi i depozitave të ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe mund t'i atribuohet deri në një masë shfrytëzimit të mjeteve vetanake si kapital punues nga ana e ndërmarrjeve, në vend të financimit nga jashtë, si pasojë e qasjes së vështirësuar të ndërmarrjeve në financimin bankar. Për dallim nga viti paraprak, edhe depozitat e korporatave tjera financiare u karakterizuan me rënie vjetore prej 32.9 përqind (12.3 përqind rritje në qershor 2012), gjë që ndikoi edhe në zvogëlimin e pjesëmarrjes së tyre në gjithsej depozitat e sektorit bankar në 3.5 përqind (5.5 përqind në qershor 2012). Rënia e depozitave të korporatave tjera financiare në këtë periudhë mund të jetë kryesisht rezultat i performancës negative që kishin këto korporata në periudhat e fundit si dhe tërheqjes së një pjese të depozitave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nga sektori bankar.

Megjithatë, dominimi i strukturës së gjithsej depozitave nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat shënuan rritje gjatë kësaj periudhe, ka neutralizuar deri diku efektin negativ të rënies së depozitave të ndërmarrjeve dhe korporatave tjera financiare. Rritja e depozitave të ekonomive familjare gjatë kësaj periudhe mund t'i atribuohet pjesërisht rritjes së burimeve të financimit të ekonomive familjare gjatë kësaj periudhe (për shembull. remitencat, kompenzimi i punëtorëve nga jashtë, etj.), si dhe rritjes së lehtë të normës së interesit në depozita nga bankat komerciale. Sa i përket depozitave të jorezidentëve, duke arritur vlerën prej 76.3 milionë në qershor 2013, këto depozita shënuan një rritje vjetore prej 0.6 përqind, që paraqet një përmirësim krahasuar me rënie vjetore prej 23.9 përqind të shënuar në qershor 2012.


Sipas afatit të maturimit, struktura e depozitave vazhdoi të dominohet nga depozitat e afatizuara që përfaqësuan rreth 49.4 përqind të gjithsej depozitave në qershor 2013, pasuar nga depozitat e tansferueshme që kishin një pjesëmarrje prej 33.9 përqind dhe depozitat në formë të

Figura 46. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 47. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

kursimeve të cilat përfaqësuan rreth 16.8 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat me afat më të shkurtër maturimi vazhdojnë të dominojnë strukturën e depozitave të afatizuara. Në qershor 2013, depozitat me afat maturimi 'deri në një vit' përfaqësuan 65.9 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara, pasuar nga depozitat me afat maturimi 'mbi dy vite' që përfaqësuan 18.7 përqind dhe depozitat me maturitet 'mbi një vit deri në dy vite' që përfaqësuan 15.4 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara (figura 47). Dominimi i strukturës së gjithsej depozitave të sektorit bankar nga depozitat me maturitet më të shkurtër paraqet një kufizim për aktivitetin e bankave, kur kemi parasysh që pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kredive e kanë kreditë me maturitet afatgjatë. Shfrytëzimi i burimeve afatshkurtra të financimit për përmbushjen e kërkesave afatgjata për fonde nga klientët ndikon në rritjen e ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit. Në qershor 2013, depozitat me maturitet 'deri në një vit' dhe depozitat me maturitet prej 'mbi dy vite' rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat e afatizuara kundrejt zvogëlimit të pjesëmarrjes së depozitave me afat maturimi 'mbi një vit deri në dy vite', që kryesisht mund të ketë qenë pasojë e riafatizimit të një pjese të depozitave të ekonomive familjare me këtë afat maturimi në depozita me afat maturimi mbi gjashtë muaj deri në një vit.


6.1.5 Normat e interesit

Normat e interesit në kredi u karakterizua me një tendencë rënëse, përderisa normat e interesit për depozita u karakterizuan me rritje të lehtë. Norma mesatare e interesit në kredi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 u zvogëlua në 12.8 përqind, krahasuar me 13.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2012. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozita u rrit në 3.5 përqind krahasuar me 3.4 përqind sa ishte në qershor 2012. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëlua në 9.3pp në qershor 2013, nga 10.3pp në qershor 2012 (figura 48).

Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve qëndroi në 2.2 përqind në qershor 2013, që tregon për një rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur qëndronte në 2.8 përqind. Me zvogëlim u karakterizua edhe norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, që në qershor 2013 ishte 2.8 përqind (3.1 përqind në qershor 2012). Sipas afatit të maturimit, normat më të larta të interesit u regjistruan për depozitat e ndërmarrjeve me afat maturimi '1 deri në 2 vite' për shumatat më të mëdha se

250 mijë euro, norma mesatare e të cilave ishte 5 përqind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013. Përderisa norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve private kishte shënuar rënie për pothuajse të gjitha kategoritë e depozitave, depozitat me maturitet 'mbi dy vite' për shumatat deri në 250 mijë euro dhe depozitat 'deri në një muaj' për depozitat mbi 250 mijë euro u karakterizuan me rritje të normës mesatare të interesit. Depozitat me maturitet 'mbi dy vite' (nën 250 mijë euro) dhe depozitat me maturitet 'deri në një muaj' (mbi 250 mijë euro) kishin normë mesatare të interesit prej 4.9 përkatësisht 2.6 përqind (4.8 përkatësisht 1.9 përqind në qershor 2012). Edhe normat mesatare të interesit për depozitat e ekonomive familjare kishin shënuar rënie në pothuajse të gjitha kategoritë sipas afatit të maturimit. Në kuadër të depozitave të ekonomive familjare, po ashtu norma më e ulët mesatare e interesit u evidentua në

Figura 48. Mesatarja gjashtëmujore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

depozitat me afat maturimi 'deri në një muaj' (2.1 përqind), ndërsa norma më e lartë e interesit u evidentua tek depozitat me afat maturimi 'mbi dy vite' (5.0 përqind).


Sipas qëllimit të shfrytëzimit të kredisë, kreditë për qëllime investive u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit në krahasim me kreditë tjera të biznesit. Norma më e ulët e interesit për kreditë investive të ndërmarrjeve ishte për kreditë me afat maturimi 'mbi pesë vite' (10.3 përqind), ndërsa norma më e lartë mesatare e interesit ishte për kreditë me afat maturimi 'deri në 1 vit' (13.5 përqind). Në kuadër të kredive tjera të biznesit, kreditë me afat maturimi 'deri në një vit' shënuan

normën më të lartë mesatare prej 15.6 përqind, si dhe kreditë me afat maturimi 'mbi pesë vite' kishin normat më të ulëta mesatare prej 11.1 përqind. Vlen të theksohet se norma mesatare e interesit në kredi u karakterizua me rënie në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013 krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin paraprak si për kreditë investive ashtu edhe për kreditë tjera biznesore (figura 49). Me rënie të normës mesatare të interesit në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013 u karakterizuan edhe mbitërheqjet (10.5 përqind në qershor 2013 krahasuar me 11.2 përqind në qershor 2012).

Sektori i bujqësisë vijon të karakterizohet me normën më të lartë të interesit. Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013, kreditë për sektorin e bujqësisë kishin një normë mesatare të interesit prej 18.4 përqind (20.3 përqind në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012). Kreditë për sektorin e shërbimeve, që njëherësh dominojnë strukturën e gjithsej kredive për ndërmarrjet, ishin kategoria e dytë me normën më të lartë mesatare të interesit prej 12.8 përqind (13.6 përqind në qershor 2012). Normë të përafërt të interesit në këtë periudhë kishte edhe sektori i industrisë prej 12.5 përqind (12.7 përqind në qershor). Në qershor 2013, norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese dhe hipotekare ishte 11.6 përkatësisht 10.3 përqind (12.6 përkatësisht 10.7 përqind në qershor 2012).

Në kuadër të kredive të ekonomive familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese në qershor 2013 ishte 12.3 përqind, një rënie krahasuar me normën mesatare prej 13.5 përqind në qershor 2012. Sa i përket kredive për patundshmëri, norma mesatare e interesit në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013 ishte më e lartë (11.3 përqind në qershor 2013), krahasuar me mesataren e shënuar në vitin paraprak (10.6 përqind). Sipas afatit të maturimit, kreditë për patundshmëri me afat më të gjatë maturimi vijuan të karakterizohen me norma më të ulëta të interesit. Në qershor 2013, kreditë me afat maturimi 'mbi dhjetë vite' shënuan normën më të ulët mesatare të interesit prej 9.8 përqind (10.4 përqind në qershor 2012), ndërsa kreditë me afat maturimi 'deri në pesë vite' u karakterizuan me normën më të lartë mesatare prej 13.0 përqind (9.9 përqind në qershor 2012). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, evidentohet një rritje e normës mesatare të interesit për kreditë me maturitet 'deri në pesë vite', përderisa normat mesatare të interesit për kreditë me maturitet 'mbi dhjetë vite' shënuan rënie.

Figura 49. Normat mesatare gjashtëmuajore të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




6.2. Performanca e sektorit bankar

Performanca e sektorit bankar shënoi përmirësim. Fitimi neto i sektorit në qershor 2013 është rritur për 48.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën 15.2 milionë euro (figura 50). Megjithëse të hyrat e sektorit kanë shënuar rënie vjetore prej 1.2 përqind, shpenzimet kanë pësuar rënie më të theksuar prej 4.7 përqind duke ndikuar kështu në rritjen e fitimit të sektorit bankar (figura 51).

Struktura e të hyrave të sektorit bankar mbetet e ngjashme me vitin paraprak (figura 52). Të hyrat nga interesi, që përfshijnë të hyrat nga interesi në kredi, letrat me vlerë, dhe plasmanet me bankat tjera, vazhdojnë të jenë kategoria dominuese e të hyrave me pjesëmarrje 80.8 përqind. Në qershor 2013, të hyrat nga interesi zbritën në 99.1 milionë euro nga 101.1 në qershor 2012, duke shënuar rënie vjetore prej 2 përqind. Kontribut kryesor në rënie kishin të hyrat nga investimet në letra me vlerë, të pasuar nga të hyrat nga kreditë dhe plasmanët në bankat tjera.


Të hyrat nga interesi në letra me vlerë për periudhën janar-qershor 2013 u përgjysmuan krahasuar me gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012, përkundër rritjes prej 24 përqind të mesatares gjashtëmujore të vëllimit të letrave me vlerë (investimet në letrat me vlerë të brendshme pothuajse janë katërfishuar, ndërsa ato të jashtme janë zvogëluar për 4.7 përqind). Kthimi më i ulët nga investimet në letra me vlerë kryesisht reflekton rënien e normave të kthimit në të dy kategoritë e investimeve. Normat e kthimit për bonot e thesarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë shënuar rënie të theksuar. Mesatarja e thjeshtë e normës vjetore të kthimit në periudhën janar-qershor 2013 për bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Kosovës zbriti në 0.95 përqind nga 3.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur edhe filloi emetimi i këtyre instrumenteve. Kthimi nga investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja, të cilat vazhdojnë të dominojnë portfolion e investimeve me pjesëmarrje prej 60 përqind (86 përqind në qershor 2012), u zvogëluar kryesisht si rezultat i

Figura 50. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Figura 51. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2013)

Figura 52. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


normave të ulëta të kthimit që kanë karakterizuar tregjet evropiane dhe globale në vitin 2013, si pasojë e politikave lehtësuese monetare të Bankës Qendrore Evropiane dhe Rezervës Federale Amerikane si dhe pritjeve më optimiste për zhvillimet në sektorin real.

Kategoria kryesore e të hyrave të interesit, të hyrat nga interesi në kredi, gjithashtu shënoi rënie. Në qershor 2013, të hyrat nga interesi në kredi zbritën në 96.3 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 0.7 përqind. Kjo rënie kreditor i cili në qershor 2013 shënoi rritje vjetore prej vetëm 2.8 përqind krahasuar me 9.3 përqind në qershor 2012. Faktor tjetër që ndikoi në rënien e të hyrave nga interesi në kredi është zvogëlimi i mesatares së normës efektive të interesit në kredi, e cila në qershor 2013 shënoi rënie vjetore prej 0.87 pikëpërqindje. Të hyrat nga plasmanët e bankave në bankat tjera u zvogëluan për 37 përqind, kryesisht për shkak të rënies së normave të kthimit dhe zvogëlimit të mesatares së vëllimit të plasmanëve.

Në anën tjetër, të hyrat nga jo-interesi shënuan rritje. Në qershor 2013, vlera e të hyrave nga jo-interesi arriti në 23.6 milionë, rritje vjetore kjo prej 2.2 përqind. Kjo kategori e të hyrave dominohet nga tarifat dhe komisionet të cilat në qershor 2013 shënuan rritje vjetore prej 1.8 përqind. Përkundër që trendi rritës shënoi ngadalësim (figura 53), pjesëmarrja e kësaj kategorie në gjithsej të hyrat e bankës vazhdoi të rritet. Rritja mund të ketë qenë rezultat i rritjes së çmimeve për shërbime të caktuara bankare, si dhe zgjerimit të përdorimit të shërbimeve bankare. Rritja e të hyrave nga tarifat dhe komisionet mund të jetë rezultat i një strategjie të bankave për ‘zëvendësimin’ e rënies së të hyrave nga ngushtimi i marxhinës së interesit dhe normës më të ulët të kthimit nga investimet. Një performancë e mirë e të hyrave nga jo-interesi mund të krijoj hapësirë për bankat që të konkurrojnë më tepër përmes ngushtimit të mëtejshëm të marxhinave të interesit.

Shpenzimet e sektorit bankar në qershor 2013 zbritën në 106.4 milionë euro nga 111.6 në qershor 2012. Përderisa shpenzimet e interesit shënuan ngadalësim të rritjes vjetore në 4.8


Figura 53. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2013)


përkon me ngadalësimin e zgjerimit të aktivitetit

Figura 54. Rritja e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 55. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

përqind nga 11 përqind në vitin paraprak, dy kategoritë tjera shënuan rënie vjetore duke ndikuar kështu në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve (figura 54). Rritja vjetore e shpenzimeve të interesit i atribuohet kryesisht rritjes së shpenzimeve të interesit në depozita, që ishte pasojë e rritjes së lehtë të normës së interesit në depozita si dhe rritjes së vëllimit të depozitave.

Ndërsa, shpenzimet e jo-interesit shënuan rënie të theksuar, duke dhënë kontributin kryesor në rënien e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar. Provizionet për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, që janë kategoria dominuese e shpenzimeve të kësaj kategorie, u zvogëluan për 24 përqind (figura 55). Shuma më e ulët e provizioneve të ndara gjatë kësaj periudhe reflekton faktin se shkalla e përkeqësimit të portfolios së kredive në gjashtëmuorin e parë të vitit 2013 ishte më e ulët se ajo në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 (figura 56). Vlera e gjithsej provizioneve për kredi, megjithatë, mbetet në nivel të kënaqshëm ku shkalla e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në qershor 2013 ishte 113.15 përqind.


Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të cilat dominojnë strukturën e shpenzimeve të sektorit bankar (figura 57), shënuan rënie prej 1.4 përqind. Kontribut në rënie kishin shpenzimet e kategorizuara si shpenzime tjera të jo-interesit, ndërsa shpenzimet e personelit, të cilat në qershor 2013 përbënin 43 përqind të gjithsej shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, shënuan rritje. Në qershor 2013, shpenzimet e personelit u rritën për 1.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, përkundër faktit që numri i punëtorëve në sektorin bankar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2013 ishte për 91 punëtorë më i ulët.

Figure 56. Shpenzimet për provizione dhe shkalla e rritjes së NPL-së




Burimi: BQK (2013)

Figura 57. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 58. Treguesit e profitabilitetit




* Profiti i përvitësuar për vitin 2013
Burimi: BQK (2013)

Treguesit e profitabilitetit⁷ të sektorit bankar shënuan përmirësim. Kthimi në Mesataren e Aseteve (angl. Return on Average Assets: ROAA) për vitin 2013, bazuar në përvitësimin e profitit të realizuar deri më qershor 2013, arriti në 1.1 përqind nga 0.7 përqind në vitin 2012 (figura 58). Kthimi në Mesataren e Kapitalit (angl. Return on Average Equity: ROAE) gjithashtu shënoi përmirësim nga 7.1 përqind në vitin 2012 në 10.9 përqind në 2013.

Rënia më e theksuar e shpenzimeve krahasuar me të hyrat ndikoi në përmirësimin e indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme të sektorit (figura 59). Në qershor 2013, ky indikator zbriti për 3.2 pikë përqindje, nga 89.9 përqind në qershor 2012 në 86.7 përqind në qershor 2013. Sidoqoftë, treguesi i shpenzimeve operacionale ndaj të hyrave totale mbetet në nivel të përafërt (figura 60), që sugjeron se rritja e efikasitetit të bankës në këtë periudhë nuk vjen si rezultat i efikasitetit të shtuar në menaxhimin e shpenzimeve operuese, mirëpo si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të provizioneve për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë. Andaj, marrë parasysh trendin në rritje të kredive joperformuese dhe nevojën shtesë për ndarje të provizioneve që mund të paraqitet si pasojë, përmirësimi i raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit dhe rrjedhimisht profitit mund të mos jetë i qëndrueshëm në rast se bankat nuk rrisin efikasitetin e operacionel dhe atë të menaxhimit të aseteve, sidomos kur mirret parasysh trendi i ngadalësimit të hyrave dhe aktivitetit kreditor.

Margjina neto e interesit, që matë efikasitetin e investimeve të bankës dhe aftësinë e gjenerimit të hyrave nga investimet, ka shënuar rënie (figura 61). Të hyrat neto nga interesi janë zvogëluar përkundër rritjes së mesatares gjashtëmujore të aseteve që gjenerojnë interes, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e margjinës neto të interesit në 2.9 përqind nga 3.2 përqind sa ishte në qershor 2012.


Figura 59. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Burimi: BQK (2013)


Figura 60. Treguesit e efikasitetit



Burimi: BQK (2013)

Andaj, marrë parasysh trendin në rritje të kredive joperformuese dhe nevojën shtesë për ndarje të provizioneve që mund të paraqitet si pasojë, përmirësimi i raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit dhe rrjedhimisht profitit

Figure 61. Margjina neto e interesit



Burimi: BQK (2013)

⁷Indikatorët e profitabilitetit për vitin 2013 janë llogaritur duke bërë përvitësimin e thjeshtë të profitit që sektori bankar ka realizuar deri më qershor 2013.

Raporti i të hyrave totale ndaj gjithsej asetëve gjithashtu shënoi rënie në 4.4 përqind nga 4.7 përqind në 2013, që nënkupton rënie të efikasitetit të sektorit në gjenerimin e të hyrave nga asetet në dispozicion.

Në qershor 2013, numri i të punësuarve në sektorin bankar zbriti në 3,638 punëtor nga 3,713 në qershor 2012. Zvogëlimi i numrit të punëtorëve si dhe rritja e vlerës së asetëve ndikuan në rritjen e mesatares së vlerës së asetëve të menaxhuara nga një punëtor. Numri i kredive aktive për punëtor shënoi rritje, përkundër zvogëlimit të lehtë të numrit të kredive. Raporti i profitit të gjeneruar për punëtor gjithashtu shënoi rritje, ku në qershor 2013 profiti i gjeneruar për punëtor ishte 61 përqind më i lartë se vitin paraprak (tabela 7). Rrjedhimisht, zvogëlimi i numrit të punëtorëve në sektorin bankar ka ndikuar në përmirësimin e indikatorëve të produktivitetit të sektorit, ku shfrytëzimi i kapaciteteve të punëtorëve për të menaxhuar me vëllim më të madh të asetëve është rritur.

Tabela 7. Tregues të zgjedhur të efikasitetit të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2010	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013
Asete/nr i punëtorëve (në mijëra euro)	623.0	684.5	714.3	766.0
Profiti/nr i punëtorëve (në mijëra euro)	4.8	4.1	2.8	4.5
Numri i kredive/nr i punëtorëve	75.8	92.3	113.4	115.3

Burimi: BQK (2013)

6.3. Rreziqet e Sistemit Bankar

6.3.1 Rreziku i likuiditetit


Shkalla e likuiditetit në sektorin bankar të Kosovës vazhdoi të qëndrojë në nivel të lartë gjatë vitit 2013. Megjithëse me ritëm më të ngadalshëm, depozitat vazhduan rritjen dhe mbesin burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Treguesit kyç të likuiditetit u karakterizuan me rritje, duke qëndruar në nivel mjaft më të lartë se niveli minimal i kërkuar me rregulloren perkatëse. Hendeku i likuiditetit është ngushtuar lehtë për pothuajse të gjitha kategoritë e maturimit, duke sugjeruar rënie të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit si rezultat i mospërputhjes së afatit të maturimit mes asetëve dhe detyrimeve.

Ekspozimi i ulët ndaj rrezikut të likuiditetit të sektorit bankar të Kosovës i atribuohet kryesisht modelit tradicional të sektorit bankar, ku struktura e burimeve të financimit dominohet nga depozitat e mbledhura brenda vendit të cilat karakterizohen me kosto më të ulët dhe qëndrueshmëri më të lartë se burimet tjera të financimit siç janë financimi i jashtëm dhe financimi me shumicë (angl. wholesale funding). Depozitat e sektorit bankar përbëjnë mesatarisht 80 përqind të detyrimeve të sektorit, dhe shumica e tyre (74% në qershor 2013) janë depozita të ekonomive familjare të cilat karakterizohen me shkallë të ulët të koncentrimit. Shkalla e koncentrimit të gjithsej depozitave është në përgjithësi e ulët, ku pjesëmarrja e shumë të njëzet depozitorëve më të mëdhenj të secilës bankë në gjithsej depozitat e sistemit është 15 përqind. Për më tepër, gjysma e gjithsej depozitave janë depozita të afatizuara dhe atë kryesisht me afat maturimi mbi 6 muaj (gjegjësisht 6 muaj deri në 1 vit), ku afatizimi i depozitave mund të konsiderohet si reflektim i besimit të lartë të depozitorëve në sistem dhe nivelin e qëndrueshmërisë së depozitave të cilat janë vazhdimisht në rritje. Huazimet afatshkurtëra kanë pjesëmarrje të vogël në strukturën e detyrimeve, gjë që e bënë sistemin të ketë ekspozim të ulët ndaj qasjes në burime afatshkurtëra dhe lëvizjes më të shpeshtë të çmimeve me të cilat karakterizohen tregjet e jashtme të financimit afatshkurtër. Detyrimet ndaj bankave amë gjithashtu kanë pjesëmarrje shumë të ulët, gjë që e bënë sektorin të jetë i mbrojtur nga rreziku i

mundshëm i tkurrjes së huazimit nga bankat amë për shkak të presioneve aktuale të bankave evropiane për uljen e borxheve dhe kreditimit ndërkuftar (angl: deleveraging), përfshirë edhe ndaj vartësve dhe degëve të tyre bankare.

Raporti kredi/depozita, si një indikator i rëndësishëm i likuiditetit të sektorit qëndroi në 83 përqind në qershor 2013, që sugjeron një nivel të kënaqshëm të likuiditetit. Sidoqoftë, zhvillimet në aktivitetin e kreditimit dhe depozitave në sektorin bankar karakterizohen me sezonalitet që reflektohet edhe në trendin e raportit ndërmjet kredive dhe depozitave (figura 62). Ky indikator arrin nivelin maksimal në mes të vitit dhe ka tendencë rënëse në pjesën tjetër të vitit, që kryesisht lidhet me faktin se kreditë e reja shënojnë nivelin më të lartë në tremujorin e dytë, ndërsa depozitat rritjen më të shpejtë e shënojnë në gjysmën e dytë të vitit.


Figura 62. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Sektorin bankar i Kosovës konsiderohet të ketë pozitë të favorshme të likuiditetit gjithashtu për faktin se raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve të sektorit, si dhe krahas detyrimeve afatshkurtra qëndron në nivel të lartë. Në qershor 2013, asetet likuide 'themelore' (angl: core liquid assets) përbënin 27.9 përqind të gjithsej aseteve (28.3% në qershor 2012), ndërsa raporti i mjeteve likuide 'gjithpërfshirëse' (angl: broad liquid assets) ndaj gjithsej aseteve qëndroi në 29.3 përqind krahasuar me 28.9 përqind në vitin paraprak (figura 63). Krahas rritjes vjetore të gjithsej aseteve, bankat janë përkujdesur që në strukturën e tyre të mbajnë asete të mjaftueshme likuide, dhe atë kryesisht përmes rritjes së aseteve me shkallë më të lartë likuiditeti siç janë para e gatshme dhe bilanci me BQK-në. Llogaritë rrjedhëse dhe plasmanët me bankat tjera, që gjithashtu bëjnë pjesë në mjetet themelore likuide, kanë shënuar rënie të pjesëmarrjes, por rritja më e lartë e parasë së gatshme dhe rezervave ka ndikuar që asetet likuide themelore të rriten në përgjithësi dhe të ruajnë raportin e tyre krahas gjithsej aseteve. Bankat gjithashtu kanë rritur investimet e tyre në letra me vlerë, dhe atë kryesisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Rritja e pjesëmarrjes së parasë së gatshme dhe letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës në kuadër të strukturës së aseteve konsiderohet si zhvillim pozitiv për likuiditetin dhe stabilitetin e sektorit bankar. Rritja e këtyre kategorive të aseteve, megjithatë, mund të reflektojë hezitimin e bankave për rritjen e kreditimit drejt ekonomisë vendore si dhe në investimin në tregjet e jashtme.

Figura 63. Raporti asete likuide 'gjithpërfshirëse'/ gjithsej asete



Burimi: BQK (2013)

Në dhjetor 2012, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës aprovoi rregullore të re për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, sipas së cilës bankat duhet të sigurohen që të mbajnë raportin e mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në nivel minimal prej 25 përqind. Sistemi bankar i Kosovës tejkalon dukshëm kërkesën rregullative, ku në qershor 2013 raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ishte 38.5 përqind. Andaj, vlerësuar përmes këtij


indikatori, mund të cilësohet që sektori bankar i Kosovës ka aftësi të mjaftueshme për shlyerjen adekuate të detyrimeve afatshkurtra si dhe për ballafaqimin me rreziqe potenciale të likuiditetit.

Rezervat e likuiditetit të sistemit bankar gjithashtu vazhdojnë të qëndrojnë në nivel mjaft më të lartë se kërkesat rregullative (figura 64)⁸. Në qershor 2013, vlera e gjithsej rezervave ishte 304.2 milionë euro, që është 64 përqind më shumë se rezerva e detyrueshme prej 186.0 milionë euro. Në aspektin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, mbajtja e nivelit të lartë të rezervave mund të konsiderohet si pozitive ngase zvogëlon ekspozimin e sektorit ndaj zhvillimeve të mundshme me rrezik për likuiditetin, sidomos për faktin që ekonomia e Kosovës është e euroizuar dhe Banka Qendrore e Kosovës ka mekanizma të kufizuar për injektim të likuiditetit në treg. Sidoqoftë, mbajtja e rezervave mbi nivelin e obliguar paraqet kosto oportune për bankat si dhe mund të ketë implikime në koston e shërbimeve bankare, andaj dhe menaxhimi i mirë i mjeteve likuide për të minimizuar koston oportune dhe njëkohësisht për të mos rrezikuar likuiditetin është i rëndësishëm.

Modeli i biznesit të sektorit bankar kryesisht bazohet në menaxhimin e transformimit të maturitetit të mjeteve, ku burimet afatshkurtra të financimit shfrytëzohen për përmbushjen e kërkesave afatgjata për fonde nga klientët. Aktiviteti i tillë ngërthen në vete rrezik strukturor të likuiditetit, dhe analiza e hendekut të likuiditetit (diferenca ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të bankës në bazë të intervaleve të maturitetit) është metodë e rëndësishme në vlerësimin e këtij rreziku. Diferenca apo mospërputhja më


e madhe e maturitetit në mes të asetëve dhe detyrimeve paraqet rrezik më të madh, dhe menaxhimi i likuiditetit pritet të mbështetet mbi parimin e minimizimit të hendekut të likuiditetit. Figura 65 paraqet hendekun e likuiditetit në sektorin bankar të Kosovës, ku hendeku negativ nënkupton që asetet për intervalin e caktuar të maturitetit tejkalojnë detyrimet dhe anasjelltas. Në figurë mund të shihet se në vitin 2013, hendeku është ngushtuar për pothuajse të gjitha intervalet e maturitetit krahasuar me vitin paraprak. Intervali i maturitetit prej '1-7 ditë' karakterizohet për mospërputhjen më të theksuar, ku vlera e detyrimeve tejkalon vlerën e asetëve për 449.1 milionë euro. Hendeku për intervalin '8-30 ditë' është rritur mirëpo në drejtim të kundërt, duke kaluar në hendek pozitiv pjesërisht për shkak të investimeve të bankave në vend në letra me vlerë. Në përgjithësi, hendeku kumulativ për mjetet dhe detyrimet me maturitet deri në 90 ditë është negativ dhe reflekton faktin që kreditë, si kategoria dominuese e asetëve, kanë kryesisht maturitet më të gjatë se tre muaj, ndërsa depozitat, si

Figura 64. Rezervat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 65. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

⁸ Rezervat për vitin 2013 paraqiten me gjendjen e muajit qershor, ndërsa në vitet tjera paraqiten gjendja e fundit të vitit.


kategoria dominuese në anën e detyrimeve, kanë maturitet të shkurtër. Diferenca kumulative për këtë periudhë (deri në 90 ditë) është ngushtuar në -466.5 milionë euro krahasuar me -533.3 milionë euro në qershor 2012, dhe ngushtimi i mëtutjeshëm i hendekut kërkon kryesisht përpjekje në zgjatjen e maturitetit të depozitave të sektorit që njëkohësisht do të ngushtonte hendekun pozitiv në intervalet më të gjata të maturitetit dhe do të ulte ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit strukturor që e karakterizon sektorin. Gjithashtu, kjo do të lehtësonte rritjen e kreditimit me afat më të gjatë të maturimit.

Vlerësuar nga indikatorët e mësipërm të likuiditetit, pozita e likuiditetit të sektorit bankar mund të konsiderohet mjaft e favorshme. Qëndrueshmëria që ka karakterizuar depozitat deri më tani, si dhe rritja e vazhdueshme e tyre sugjerojnë për besimin e lartë ndaj sektorit përkundër krizës globale financiare. Në periudhat në vazhdim, avancimi i mëtejshëm i rregullave në fushën e mbrojtës së depozitorëve⁹ si dhe zhvillimet e pritshme në drejtim të hapjes dhe funksionalizmit të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës pritet që të kenë efekt pozitiv në uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve potenciale dhe përforcimin e mëtejshëm të pozitës së likuiditetit. Për më tepër, pritet për pjesën e dytë të vitit 2013 janë që kreditimi të mbajë ritmin e deritanishëm të rritjes, duke sugjeruar që nuk do të ketë ndonjë presion mbi nivelin e likuiditetit.

6.3.2 Rreziku kreditor


Rreziku kreditor mbetet rreziku dominues në kuadër të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sistemi bankar i Kosovës. Ekspozimi ndaj këtij rreziku gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 është rritur. Raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive në qershor 2013 arriti në 7.8 përqind krahasuar me 6.5 në vitin paraprak (figura 66). Rritja e pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej portofolin kreditor gjatë viteve 2012 dhe 2013, mund t'i atribuohet kryesisht 'efektit të bazës' të shkaktuar nga shtrëngimi i kredidhënies nga bankat komerciale ngase vlera e kredive joperformuese, përkundër rritjes, nuk shënoi ndonjë përshpejtim të theksuar të trendit të rritjes (figura 67). Megjithatë, rritja e nivelit të NPL-ve mund të jetë reflektim edhe i zhvillimeve në aftësinë paguese të kredimarrësve duke pasur paraqysh se normat e rritjes ekonomike në vitet e fundit, përkundër që ishin pozitive, ishin më të ulëta krahasuar me periudhën e para-krizës globale financiare.

Figura 66. Raporti NPL/gjithsej kredite, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Figura 67. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve




Burimi: BQK (2013)

⁹Rritja graduale e vlerës së depozitave të siguruar, që sipas burimeve të Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë, deri më 2018 synohet të ngritet në nivelin 5,000 euro nga 2,000 euro në vitin 2012 dhe 2013.

Pothuajse të gjithë sektorët shënuan rënie të cilësisë së portofolit kreditor që u manifestua me rritje të vlerës së NPL-ve. Sidoqoftë, kontributin më të madh në rritje e kishte sektori i ndërmarrjeve, i cili gjithashtu karakterizohet me normën më të lartë të NPL-ve krahasuar me sektorin e ekonomive familjare (figura 68). Në qershor 2013, sektori me cilësinë më të dobët të kredive ishte ai i prodhimit, ku 15.7 përqind e gjithësej kredive të lëshuara për këtë sektor ishin joperformuese. Sektori i energjisë radhitet i dyti për nga cilësia e dobët e kredive, me normë të NPL-ve prej 11.5 përqind. Shërbimet dhe turizmi u karakterizuan me normë të NPL-ve prej 10.3 përqind, ndërsa norma e NPL-ve për ekonominë familjare në qershor 2013 ishte ndër më të ulëtat me 2.5 përqind.


Figura 68. Raporti NPL ndaj gjithësej kredive sipas sektorëve



Burimi: BQK (2013)

Rritja e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor vërehet edhe në analizën e strukturës së kredive sipas klasifikimit¹⁰, e cila është karakterizuar me migrim të kredive nga kategoritë me cilësi më të mirë drejtë kategorive me cilësi më të dobët (figura 69). Në qershor 2013, pjesëmarrja e kredive që bëjnë pjesë në kategorinë 'standarde' shënoi rënie, duke qëndruar në 86.8 përqind të gjithësej kredive të sektorit bankar krahasuar me 88.5 përqind në vitin paraprak. Pjesëmarrja e kredive të klasifikuara si 'vrotjuese' si dhe atyre 'nënstandarde' në gjithësej kreditë e sektorit bankar regjistroi një ngritje të lehtë prej 0.2pp krahasuar me vitin paraprak duke arritur në 2.2 përqind dhe 3.2 përqind, respektivisht. Kategoria e kredive të klasifikuara si 'të dyshimta' ka shënuar rritje prej 0.4pp, ndërsa rritjen më të theksuar e ka shënuar kategoria e kredive të cilësuar si 'të humbura' të cilat rritën pjesëmarrjen në gjithësej kreditë për 0.9pp.

Figura 69. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2013)

Rrjedhimisht, shikuar nga perspektiva e kategorive të kredive të klasifikuara sipas rrezikut¹¹, rritja e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor gjatë kësaj periudhe vjen kryesisht nga rritja në kategorinë e kredive joperformuese, të cilat shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 23.3 përqind, krahasuar me dy kategoritë tjera të rrezikut si kreditë e klasifikuara të cilat u rritën për 18.6 përqind dhe kreditë me vonesa me 17.8 përqind. Në kuadër të strukturës së kredive joperformuese, kreditë e klasifikuara si 'të humbura' vazhdojnë të dominojnë strukturën me pjesëmarrje prej 67.4 përqind (67.0 përqind në qershor 2012). Pjesa e mbetur prej 32.6 përqind përfshinë kreditë e kategorizuara si të dyshimta (figura 70).

¹⁰Bazuar në rregulloren e BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, kreditë në sektorin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrotjuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura.


¹¹Sipas rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, klasifikimet kreditore të mësipërme grupohen në tri kategori të ekspozimit të rrezikut kreditor: *Kreditë me vonesa*, të cilat përfshijnë kategoritë vrotjuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura; *Kreditë e klasifikuara* që përfshijnë kategoritë nën standarde, të dyshimta dhe të humbura, dhe *Kreditë joperformuese* që përfshijnë kreditë e dyshimta dhe të humbura.

Mbulueshmëria e NPL-ve me provizione ka shënuar rënie të lehtë, si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor në një rën të anë, dhe shpenzimeve më të ulëta të bankave për provizione. Megjithatë, niveli aktual i provizioneve vazhdon të mbulojë me mbi 100 përqind vlerën e përgjithshme të NPL-ve dhe, si i tillë, nuk paraqet kërcënim për stabilitetin financiar. Në qershor 2013, shkalla e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë ishte 113.2 përqind, krahasuar me 117.3 përqind në vitin paraprak (figura 71).

Përmirësimi i profitabilitetit të bankave në vitin 2013 është indikacion për aftësinë e bankave që të vazhdojnë të ndajnë provizione për mbulimin e rritjes së mundshme të NPL-ve në periudhën vijuese të vitit 2013. Për më tepër, marrë parasysh pritjet për zhvillime pozitive në sektorin real në gjysmën e dytë të vitit 2013 dhe në vitin 2014, si dhe kujdesin e shtuar që bankat kanë raportuar të kenë aplikuar në përzgjedhjen e aplikacioneve për kredi në dy vitet e fundit, mund të pritjet që të ketë rënie të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor, i cili në krahasim me vendet e rajonit megjithatë mbetet në nivelin më të ulët.


Koncentrimi i rrezikut kreditor ka vazhduar të rritet. Në qershor 2013, shkalla e koncentrimit të rrezikut kreditor, që paraqet ekspozimet e mëdha të të gjitha bankave në raport me kapitalin e klasit të parë, ka arritur në 91 përqind krahasuar me 72 përqind në qershor 2012 (figura 72)¹². Vlera e ekspozimeve të mëdha¹³ në qershor 2013 arriti në 218.88 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 17.6 përqind. Kjo rritje është ndikuar pjesërisht nga ndryshimet në rregulloren e BQK-së për Mjaftueshmërinë e Kapitalit, si rezultat i së cilës është ndryshuar mënyra e klasifikimit të kapitalit të klasit të parë duke u bërë më konzervative.

Figura 70. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

Figura 71. NPL dhe provizionet



Burimi: BQK (2013)

Figura 72. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2013)

¹²Rregullorja në fuqi e BQK-së për ekspozime të mëdha kufizon vlerën e gjithsej ekspozimeve të mëdha në 300 përqind të kapitalit të klasit të parë.

¹³Sipas rregullores së BQK-së për ekspozime të mëdha, ekspozim i madh cilësohet çdo ekspozim direkt dhe indirekt kreditor ndaj një huamarrësi të vetëm ose një grupi të huamarrësve të ndërlidhur që tejkalojnë 10% të kapitalit të klasit të parë.


Rrjedhimisht, zvogëlimi i vlerës së kapitalit të klasit të parë ka ndikuar në zvogëlimin e pragut ku një ekspozim fillon të klasifikohet si ekspozim i madh. Megjithatë, norma e rritjes vjetore të ekspozimeve të mëdha ka shënuar rënie krahasuar me tri vitet paraprake ku mesatarja e rritjes së ekspozimeve të mëdha ishte 31.1 përqind. Duhet të theksohet që krahas rritjes së vlerës së ekspozimeve gjithashtu është shtuar numri i ekspozimeve, që nënkupton që është bërë shpërndarja e koncentrimit të rrezikut kreditor në më shumë kredimarrës të mëdhenj. Në qershor 2013, numri i ekspozimeve të mëdha arriti në 59 (54 në qershor 2012), duke ndikuar që vlera mesatare e një ekspozimi të madh të jetë 3.6 milionë euro (3.4 milionë euro në qershor 2012). Rritja e koncentrimit të rrezikut kreditor konsiderohet si rritje e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor për shkak se rritet ndjeshmëria e sektorit ndaj cilësisë së ekspozimeve të caktuara të cilat kanë peshë të madhe në gjithsej portofolin e kredive. Andaj, bankat duhet të tregohen të kujdesshme në aspektin e shkallës së koncentrimit të rrezikut kreditor në mënyrë që të mos rrisin dukshëm ndjeshmërinë ndaj ekspozimeve të caktuara, dështimi i mundshëm i të cilave mund të ketë efekt të konsiderueshëm në stabilitetin e tyre dhe të sektorit në tërësi. Ndryshimet në rregulloren e BQK-së për Ekspozime të Mëdha¹⁴ mundësojnë qasje më të kujdesshme në aspekt të menaxhimit të koncentrimit kreditor, duke kufizuar bankat që në asnjë kohë të mos mbajnë ekspozim total ndaj një huamarrësi të vetëm ose një grupi të huamarrësve të ndërlidhur që tejkalojnë 15 përqind të kapitalit të klasit të I, krahasuar me nivelin e mëparshëm prej 20 përqind.

6.3.3 Rreziku i solvencës

6.3.3.1 Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit

Sektori bankar i Kosovës karakterizohet me shkallë të lartë të kapitalizimit që në vazhdimësi ka tejkuluar kërkesat minimale rregullative¹⁵. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR), që është ndër treguesit më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së sektorit bankar, në qershor 2013 zbriti në 16.5 përqind krahasuar me 17.2 përqind në vitin paraprak (figura 73). Megjithatë, CAR qëndroi mbi nivelin minimal rregullativ prej 12 përqind, që sugjeron nivel të kënaqshëm të stabilitetit. Në qershor

Figura 73. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2013)

2013, raporti ndërmjet Kapitalit të klasit të parë dhe Mjeteve të Peshuara me Rrezik (angl. Risk Weighted Assets: RWA) poashtu shënoi rënie, duke zbritur në 13.4 përqind nga 14.4 përqind në vitin paraprak, por që megjithatë tejkalon dukshëm minimumin rregullativ prej 8 përqind. Dallimi i vogël ndërmjet dy treguesve të mësipërm të kapitalizimit është indikacion për cilësinë e mirë të kapitalit, i cili kryesisht përfshinë kapital të klasit të parë, e që është tregues shtesë për stabilitetin e sektorit bankar. Ndryshimi në dy treguesit e kapitalizimit është kryesisht rezultat i ndryshimit në nivelin e përgjithshëm të kapitalit rregullativ, ngase RWA-të qëndruan në nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak (figura 74). Në qershor 2013, kapitali rregullativ shënoi rënie prej 4.1 përqind duke zbritur në vlerën 291.4 milionë euro, ndërsa RWA-të shënuan rënie vjetore prej 0.2 përqind duke zbritur në 1,761.7 milionë euro.


¹⁴Rregullorja e BQK-së për Ekspozime të Mëdha është ndryshuar së fundmi në prill të vitit 2013 dhe ka hyrë në fuqi më 10 maj 2013.

¹⁵Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ në raport me RWA dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA.

Ndryshimet në nivelin e kapitalit rregullativ në masë të madhe shpjegohen me ndryshimet e rregullores mbi adekuatshmërinë e kapitalit të bankave që filloi së zbatuari në dhjetor të vitit 2012.¹⁶ Në bazë të kësaj rregullore ka ndryshuar mënyra e përlogaritjes së kapitalit të klasit të parë, të cilit krahas mjeteve të paprekshme dhe emrit të mirë, i zbriten edhe tri pozicione shtesë. Pozicioni i parë ndërlidhet me 'Investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucione kreditore', pozicioni i dytë ndërlidhet me 'Pasurinë e tatimit të shtyrë' dhe pozicioni i tretë përfshinë 'Huazimet e personave të ndërlidhur me bankën'. Zbritja e këtyre tri pozicioneve nga kapitali i klasit të parë është bërë me qëllim të vlerësimit sa më të saktë të nivelit të kapitalit bazë, i cili paraqet shtyllën kryesore për mbulimin e humbjeve potenciale të sektorit. Si pasojë e këtyre zbritjeve, kapitali i përgjithshëm rregullativ është zvogëluar për 31.1 milionë euro. Rregullorja e re gjithashtu përfshinë ndryshime në metodologjinë e përlogaritjes së RWA-ve, sipas së cilës ndryshojnë faktorët e rrezikut për disa kategori të asetëve mirëpo pa ndonjë efekt të madh në vlerën e RWA-ve për këtë periudhë. Sidoqoftë, ndryshimi në vlerën e RWA-ve do të vërehet në gjysmën e dytë të vitit 2013, kur bankat do të obligohen të fillojnë së zbatuari rregullën për ndarjen e rezervës së kapitalit për rrezikun operacional. Kjo nënkupton që pozicioni i 'rrezikut operacional' do t'i shtohet RWA-ve, gjë që mund të ketë efekt në uljen e normave të kapitalizimit. Megjithatë, kjo nuk paraqet rrezik për stabilitetin e sektorit, meqë niveli aktual i kapitalit rregullativ është mjaft mbi nivelin minimal të kërkuar dhe rrjedhimisht siguron norma të kënaqshme të kapitalizimit edhe në rast të përfshirjes së rrezikut operacional.¹⁷


Në qershor 2013, gjithsej kapitali rregullativ i sektorit bankar ishte 291.4 milionë euro, vlerë kjo e cila tejkalon për 80 milionë euro kapitalin e kërkuar rregullativ (figura 75). Shkalla e lartë e kapitalizimit konfirmohet edhe nga rezultatet e analizës stres-test të cilat sugjerojnë se sektori është në gjendje të përballojë nivele mjaft të larta të tronditjeve në cilësinë e portofolios të kredisë dhe nevojat eventuale për rikaptilazim do të mbeteshin në nivel mjaft të ulët.

Figura 74. Kapitali rregullativ dhe RWA-të



Burimi: BQK (2013)

Figura 75. Kapitali shtesë mbi kapitalin e kërkuar rregullativ, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

¹⁶Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2012, miratoi rregulloren e re për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, e cila hyri në fuqi me 3 dhjetor 2012. Kjo rregullore u modifikua në maj të vitit 2013, ku ndër të tjera iu dha afat bankave deri më 1 korrik 2013 për fillimin e zbatimit të ndarjes së rezervës së kapitalit për rrezikun operacional.

¹⁷Në qershor 2013, CAR i gjithë sektorit pas përfshirjes së rrezikut operacional në RWA do të ishte 15%, marrë për bazë nivelin aktual të kapitalit. Ndërsa analizuar në nivel të bankave, CAR për dy banka do të binte lehtë ndër nivelin minimal prej 12%, që sugjeron për nevojë për kapital shtesë në nivel të bankave për periudhat në vijim.

6.3.3.2 Kapitali rregullativ


Kapitali rregullativ i sektorit bankar të Kosovës përbëhet kryesisht prej kapitalit të klasit të parë, i cili në qershor 2013 shënoi vlerën 236.1 milionë euro dhe përbënte 81 përqind të gjithëj kapitalit rregullativ (figura 76). Pjesa tjetër përfshinë kapitalin e ashtuquajtur plotësues apo kapitali i klasit të dytë, që në qershor 2013 arriti vlerën 55.3 milionë euro. Nga figura 74 e paraqitur më lartë mund të vërehet se gjatë viteve të fundit, norma e rritjes së kapitalit rregullativ të sektorit bankar ka shënuar trend rënës. Kjo për shkak të trendit rënës të rritjes së kapitalit të klasit të parë, i cili në qershor 2013 regjistroi rënie vjetore prej 6.9 përqind, ngase kapitali i klasit të dytë ka pasur kryesisht trend rritës, ku në qershor 2013 shënoi rritje vjetore prej 10.1 përqind. Rrjedhimisht edhe pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithëj kapitalin rregullativ është zvogëluar në katër vitet e fundit. Në vitet paraprake, rënia e normës së rritjes së kapitalit rregullativ ishte kryesisht rezultat i ngadalësimit të rritjes së profitit të sektorit, që njëherësh paraqet burimin kryesor të financimit të rritjes së kapitalit. Ndërsa gjatë vitit 2013, rënia e nivelit të gjithëj kapitalit rregullativ ishte kryesisht rezultat i pagesës së dividendës që ndikoi në zvogëlimin e fitimit të pashpërndarë, si dhe ndryshimeve rregullative që obliguan zbritjen e portfolios së huazimeve të personave të ndërlidhur me bankën nga kapitali i klasit të parë. Ndërsa, për dallim nga vitet paraprake, gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 profiti ka shënuar rritje duke dhënë kontribut të shtuar në rritjen e kapitalit.

Në vitet e fundit, bankat kanë filluar që të aplikojnë metoda alternative të rritjes së kapitalit rregullativ, ku mund të veçohet rritja e përdorimit të borxhit të ndërruar (angl. subordinated debt) i cili kategorizohet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë. Ndërsa, aplikimi i instrumenteve financiare më të sofistikuar për rritjen e kapitalit plotësues, siç janë instrumentet hibride, nuk praktikohet në sektorin bankar të Kosovës. Në një anë ky fakt sugjeron për shkallën e ulët të zhvillimit të sektorit financiar ndërsa, në anën tjetër, mos aplikimi i këtyre instrumenteve hibride mund të konsiderohet pozitiv në aspektin e ekspozimit ndaj rrezikut të solvencës, sepse këto instrumente financiare bartin nivel më të lartë të rrezikut me implikime të mundshme për qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

Përmirësimi i performancës së sektorit në vitin 2013 sugjeron që bankat do të kenë mundësi që krahas burimeve alternative të financimit të kapitalit, të shfrytëzojnë profitin gjithashtu për shtimin e kapitalit në periudhat në vijim, për nevoja të mbulimit me kapital të rrezikut të shtuar kreditor, mbulimit të rrezikut operacional si dhe rritjes së mëtutjeshme të aktivitetit.

Struktura e kapitalit të klasit të parë ka ndryshuar në krahasim me vitet paraprake, mirëpo duhet theksuar se ndryshimi nuk ka ndodhur si rrjedhojë e ndryshimit në menaxhimin e kapitalit nga ana e bankave, por kryesisht si pasojë e ndryshimit të rregullores mbi mjaftueshmërinë e kapitalit ecila aplikon qasje më konzervative në përlllogaritjen e kapitalit të klasit të parë siç u elaborua më lartë. Kapitali aksionar mbetet kategoria kryesore në strukturën e kapitalit të klasit të parë me pjesëmarrje prej 92.5 përqind (figura 77). Kategoria e dytë për nga madhësia është fitimi i pashpërndarë, i cili së bashku me fitimin për vitin aktual dhe fondet rezervë përfaqësoi 22.7 përqind të gjithëj kapitalit të klasit të parë. Mjetet jo materiale (angl.

Figura 76. Struktura e kapitalit të sistemit bankar



Burimi: BQK (2013)

intangible assets) dhe vlera e emrit të mirë (angl. goodwill) kishin pjesëmarrje prej 2 përqind, ndërsa kategoritë e reja të përfshira në përlogaritjen e kapitalit të klasit të parë përbënin 13.2 përqind.


Struktura e kapitalit të klasit të dytë dominohet nga borxhi i ndërvarur, i cili ka shënuar trend rritës në vitet e fundit duke kontribuar kështu në rritjen e gjithsej kapitalit të klasit të dytë. Pjesëmarrja e borxhit të ndërvarur në kapitalin e klasit të dytë arriti në 66 përqind në qershor 2013, ndërsa pjesa tjetër prej 33 përqind përfshinte provizionet e përgjithshme për kreditë.¹⁸

6.3.3.3 Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Asetet e peshuara ndaj rrezikut mbetën në nivel të përafërt me vitin paraprak. Në qershor të vitit 2013, gjithsej vlera e aseteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) zbriti në 1.76 miliardë euro, që paraqet rënie vjetore prej 0.2 përqind.


Struktura e RWA-ve ka pësuar ndryshim gjatë kësaj periudhe si rezultat i ndryshimit të rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit. Për dallim nga vitet paraprake ku pesha më e lartë e rrezikut ishte 100%, në vitin 2013 është shtuar kategoria e aseteve me peshë rreziku prej 150% (figura 78). Në këtë kategori hyjnë kërkesat direkte me maturitet prej 'një viti apo më pak', të cilat kanë kërkojnë aprovim paraprak nga BQK por që kanë klasifikim kreditor me rrezik të lartë mospagese (nën B- sipas vlerësimeve të Fitch). Në qershor 2013, këto asete përbënin 1.8 përqind të gjithsej aseteve të peshuara ndaj rrezikut. Pjesa tjetër e strukturës së RWA-ve nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar, ku vlen të ceket se asetet me peshë të rrezikut prej 100% vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë dhe mbesin në nivelin e njëjtë prej 78.7 përqind të gjithsej RWA-ve. Kjo kategori përbëhet nga kreditë¹⁹ si dhe zërat jashtëbilancorë që së bashku arritën në 1.38 miliardë euro në qershor 2013. Pjesëmarrja e aseteve me peshë të rrezikut prej 75% në gjithsej RWA-të u zvogëlua në 10.3 përqind nga 15.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo kategori përbëhet nga kreditë e garantuara me hipotekën e parë në pasuri të patundshme dhe që kanë vonesë kthimi prej më pak se 30 ditë si dhe kreditë për ndërtuesit për të financuar ndërtimin e pasurive të patundshme, ku prona e financiar ka qenë e shitur apo e lëshuar me qira, të cilat së bashku arritën në 287.7 milionë euro.

Figura 77. Struktura e kapitalit të klasës së parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 78. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2013)

¹⁸Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25% të mjeteve të peshuara ndaj rrezikut.

¹⁹Për klasifikimin e detajuar të RWA-ve mund të referoheni në rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

6.3.4. Rreziku i tregut

Sektori bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut që nënkupton rrezikun e ndryshimit të vlerë së tregut të instrumenteve financiare si rrjedhojë e ndryshimeve në faktorët e tregut siç janë norma e interesit dhe lëvizjet e kursit të këmbimit valutor. Pozicionet e hapura neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë janë në nivel mjaft të ulët, që nënkupton se ndjeshmëria e sektorit ndaj ndryshimeve të mundshme në kurset e këmbimit është e ulët. Ekspozimi indirekt prej ndryshimeve në kurse valutore, si rezultat i kreditimit në valutë të huaj kur huamarrësi pranon të ardhurat në valutë tjetër nga ajo e kthimit të kredisë, është mjaft i ulët gjithashtu për faktin që kreditë janë kryesisht në valutën euro. Sa i përket ekspozimit ndaj ndryshimeve në normat e interesit, sektori bankar është relativisht i mbrojtur për faktin që kreditë dhe depozitat, si zërat kryesorë në bilancin e gjendjes së sektorit, kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit në afat të shkurtër. Sidoqoftë, ndryshimi i normave të interesit mund të ketë ndikim në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe depozitave dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit, por që ky rrezik është i ulët marrë parasysh pjesëmarrjen relativisht të ulët të diferencës mes aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit në raport me gjithsej asetet e sektorit, si dhe për faktin se lëvizjet e normave të interesit janë mjaft të ngadalshme dhe në afat të shkurtër nuk mund të paraqesin rrezik të lartë.


6.3.4.1 Rreziku nga kursi i këmbimit valutor

Në qershor 2013, sektori bankar i Kosovës kishte asete në valutë të huaj në vlerë ekuivalente të euros prej 134.6 milionë, krahasuar me vlerën prej 122.7 milionë euro në qershor 2012. Vlera e detyrimeve në valutë të huaj ishte 133.7 milionë euro, krahasuar me 128.8 milionë euro në vitin paraprak. Dallimi në mes të vlerës së aseteve dhe detyrimeve në valutë të huaj në qershor 2013 ishte 847 mijë euro, që paraqet ngushtim krahasuar me periudhën qershor 2012 kur detyrimet në valutë të huaj tejkalonin asetet për 6 milionë euro.

Rritja më e madhe e vlerës së aseteve në krahasim me detyrimet në valutë të

huaj ndikoi që në qershor 2013 dallimi mes aseteve dhe detyrimeve në valutë të jetë pozitiv. Ndërsa, ngushtimi i dallimit në mes të aseteve dhe detyrimeve në valutë të huaj ndikoi që pozicioni i agreguar neto i hapur në valutë të huaj të zvogëlohet, ku në qershor 2013 ky pozicion zbriti në 0.4 përqind të kapitalit të klasit të parë krahasuar me pozicionin prej -2.4 përqind në qershor 2012 (figura 79). Nga figura 79 mund të shihet se në vitin 2013 pozicionet neto të hapura ndaj kapitali të klasit të parë kanë shënuar rënie për pothuajse të gjitha valutat, por që ndryshimi më i madh ndodhi në pozicionin e hapur neto në dollarin amerikan i cili zbriti në -0.1 përqind të kapitalit të klasit të parë nga -3.0 përqind në qershor 2012. Në qershor 2013, franga zvicerane shënoi pozicionin më të lartë neto të hapur ndaj kapitalit të klasit të parë prej 1

Figura 79. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë



Burimi: BQK (2013)

përqind, por që mbetet në nivel mjaft më të ulët se maksimumi prej 15 përqind i lejuar nga BQK²⁰.


Pjesëmarrja e aseteve dhe detyrimeve në valutë të huaj ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar në qershor 2013 ishte 5.19 dhe 5.16 përqind respektivisht, që është në nivel të përafërt me vitin paraprak prej 4.94 dhe 5.18 përqind. Pjesëmarrja e kredive të lëshuara në valutë të huaj ndaj gjithsej portofolit kreditor qëndroi në nivel të përafërt me vitin paraprak, ku në qershor 2013 vetëm 0.38 përqind e portofolit kreditor ishin të shprehura në valutë të huaj (figura 80).

Pjesëmarrja tejet e ulët e kredive në valutë të huaj nënkupton që sektori ka nivel të ulët të ekspozimit ndaj rrezikut indirekt kreditor si pasojë e luhatjeve të pafavorshme valutore të cilat mund të ndikojnë në potencialin e kredimarrësve për të kthyer kreditë. Rreziku indirekt kreditor nga lëvizjet valutore paraqitet në rastet kur kredimarrësit marrin kredi në valutë të huaj por realizojnë të ardhurat në valutën euro, ngase ekspozohen ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të valutës euro ndaj valutës në të cilën kanë marrë kredinë, zhvillim ky i cili do të mund të ndikonte në rënien e aftësisë së tyre për pagimin e kredisë. Pjesëmarrja e detyrimeve në valutë të huaj ndaj gjithsej detyrimeve qëndroi në nivel pothuajse të njëjtë në tri vitet e fundit, në 5.2 përqind. Pjesa dërmuese e detyrimeve në valutë të huaj përbëhet nga depozitat, të cilat në qershor 2013 përbënin 97 përqind të gjithsej detyrimeve në valutë të huaj. Pjesa tjetër përfshinë kryesisht borxhet afatshkurtra me pjesëmarrje prej 2.2 përqind në total detyrimet në valutë. Pjesëmarrja relativisht e ulët e detyrimeve në valutë të huaj, me theks të veçantë në pjesëmarrjen e borxheve afatshkurtra ndaj gjithsej detyrimeve, është indikacion që sektori nuk varet nga burimet e financimit në valutë të huaj dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve afatshkurtra në kurset e këmbimit.

6.3.4.2 Rreziku i normës së interesit


Sektori bankar ka ekspozim mjaft të ulët ndaj ndryshimeve afatshkurtëra në normën e interesit, ngase shumica e aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit kanë normë fikse të interesit. Në qershor 2013, 93.9 përqind e kredive kishin normë fikse të interesit, ndërsa pjesa tjetër prej 6.1 përqind kishin normë të ndryshueshme që lidhet me ndryshimet në indekset bazë siç janë Euribor dhe Libor. Në anën tjetër, të gjitha depozitat në sektorin bankar të Kosovës vazhdojnë të kenë normë fikse të interesit (figura 81).

Figura 80. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj



Burimi: BQK (2013)

Figura 81. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit, sipas llojit të normës së interesit



Burimi: BQK (2013)

²⁰Sipas rregullores së BQK-së për Rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja, asnjë bankë nuk duhet të ketë pozicion neto të hapur të valutës së huaj, në asnjë nga valutat e huaja që tejkalojnë 15 përqind të kapitalit të klasit të parë të saj; ndërsa pozicioni i agreguar neto në valutë të huaj kufizohet në 30 përqind.

Përkundër faktit që kreditë dhe depozitat kanë normë fikse interesi dhe janë të mbrojtura nga lëkundjet afatshkurtra në norma të interesit, bankat bartin një masë të rrezikut të riinvestimit dhe rifinancimit varësisht prej mospërputhjes së maturitetit të mjeteve me ndjeshmëri ndaj interesit dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku në sektorin bankar të Kosovës është i ulët për shkak të peshës relativisht të ulët të diferencës mes aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit në gjithsej asetet, e cila në qershor 2013 zbriti në 15.6 përqind nga 26.6 përqind qershor 2012. Në sektorin bankar të Kosovës, për shkak të mospërputhjes së theksuar të maturitetit mes aseteve dhe detyrimeve në afat kohor deri në një vit, posaçërisht ku hendeku është negativ, ndryshimi i normave të interesit reflektohet më shpejtë në shpenzimet e sektorit se sa në të hyrat. Në këtë kontekst, rritja e mundshme e normave të interesit (në depozita dhe kredi) paraqet rrezik për profitin e bankave ngase shpenzimet e interesit do të rriten më shpejtë për shkak të nevojës për riafatizimin e depozitave afatshkurtëra, përdërisa të hyrat nga interesi në kredi do të ndryshojnë më ngadalë për shkak të maturitetit më të gjatë të kredive.

Kutia 3. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Bazuar në principet bazë të modelit për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike të hartuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare në qershor 2012²¹, si dhe modelit paraprak të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për Identifikimin e Bankave me Rëndësi Sistemike në Kosovë (Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 3, 2012), është bërë zhvillimi i mëtejshëm i modelit për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në tregun e Kosovës dhe azhurnimi i tij me të dhëna të muajit qershor 2013.

Qëllimi kryesor i modelit është që të identifikojë bankat me rëndësi sistemike në vend duke vlerësuar shkallën e rëndësisë së tyre sistemike. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistemike nëse pritjet që dështimi i mundshëm i saj të manifestohet me pasoja të rëndësishme negative për funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe për ekonominë në përgjithësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistemike vlerësohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për shkak se i mundëson autoriteteve mbikëqyrëse hartimin e politikave dhe marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e kapaciteteve absorbuese të humbjeve të bankave konform shkallës së rëndësisë së tyre sistemike.

Ky artikull paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistemike për të gjitha bankat dhe degët bankare që operojnë në tregun e Kosovës duke u bazuar në të dhënat nga bilancet e gjendjes të bankave përkatëse. Për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave, modeli bazohet në katër kritere bazë: kriterin e madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlihdjes dhe kompleksitetit. Dy kriteret e para të sugjeruara nga modeli bazë (madhësia dhe zëvendësueshmëria) janë konsideruar si kritere themelore për përcaktimin e rëndësisë sistemike në rastin e Kosovës, andaj dhe pesha e tyre në model është dominuese me nga 40 përqind secila. Ndërsa dy kriteret tjera (ndërlihdja dhe kompleksiteti) janë peshuar me nga 10 përqind duke u bazuar në faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërlihdshmërisë së institucioneve në kuptimin e kreditimit të ndërsjellë, si dhe është i bazuar në aktivitete tradicionale të bankut ku shkalla e kompleksitetit është e ulët ngase financimi bazohet kryesisht në depozita dhe produktet kryesore janë kreditë.

Për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve synohet matja e shkallës së rëndësisë sistemike për secilën bankë.²² Indikatorët e përdorur janë paraqitur në Tabelën 1, dhe secilit prej indikatorëve brenda një kriterit të caktuar i është dhënë peshë e barabartë.

Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform teorisë dhe modelit bazë të lartpërmendur. Supozimi i përgjithshëm në raport me *kriterin e madhësisë*, i konsideruar si kriteri kryesor për matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni është që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq

21 Basel Committee on Banking Supervision (June 2012), *A Framework for Dealing with Domestic Systemically Important Banks*.

²² Vlen të theksohet që modeli ka për qëllim që të identifikojë institucionet me rëndësi sistemike në bazë të shkallës apo efektit që falimentimi i tyre i mundshëm mund të ketë në tregun vendor, dhe jo të masë rrezikun e falimentimit të institucioneve.

më e madhe është rëndësia e saj sistemike me që palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve është synuar të matet si në aspektin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së aseteve në gjithsej asetet e sektorit, ashtu edhe në aspekte të veçanta të bilancit të gjendjes siç janë pjesëmarrja e depozitave në gjithsej depozitat e sektorit, numri i depozitorëve, pjesëmarrja e parave të gatshme dhe rezervave, etj. për të reflektuar kështu rëndësinë e tyre në aspekte/segmente të veçanta të sektorit bankar, si p.sh. numri i depozitorëve që mund të ndikohet në rast të paraqitjes së problemeve apo falimentimit të mundshëm të një banke të caktuar.

Kriteri i zëvendësueshmërisë synon që të masë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të një institucioni nga institucionet tjera në treg në rast të dështimit të institucionit përkatës. Supozimi kryesor për kriterin e zëvendësueshmërisë është që sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta kapacitete teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. vlerësimin e rrezikut të kredive për sektorin e bujqësisë), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të tij në atë fushë. Andaj, edhe rëndësia sistemike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të tij janë më të mëdha.

Tabela 8. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 40%)	<p>Pjesëmarrja e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në</p> <p>Pjesëmarrja në tregun e aseteve të sektorit</p> <p>Pjesëmarrja në tregun e depozitave të sektorit</p> <p>Kapitali vetanak i bankës në raport me gjithsej kapitalin e sektorit</p> <p>Pjesëmarrja e letrave me vlerë të sektorit</p> <p>Numri i depozitorëve të bankës në raport me gjithsej depozitorët</p> <p>Pjesëmarrja e mjeteve likuide të sektorit</p>
Zëvendësueshmëria (pesha 40%)	<p>Pjesëmarrja në kreditë për bujqësi të gjithsej sektorit</p> <p>Pjesëmarrja në kreditë për konsum të ekonomive familjare</p> <p>Pjesëmarrja në kreditë e industrisë, prodhimit, energjisë dhe ndërtimtarisë</p> <p>Pjesëmarrja në kreditë e tregtisë</p> <p>Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave</p> <p>Pjesëmarrja në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës</p> <p>Pjesëmarrja në tregun e gjithsej kredive</p>
Ndërlidhshmëria (pesha 10%)	<p>Pjesëmarrja e depozitave nga korporatat tjera financiare</p> <p>Pjesëmarrja e kredive për korporatat tjera financiare</p>
Kompleksiteti (pesha 10%)	Zërat jashtë-bilancor në raport me gjithsej asetet e bankës përkatëse

Burimi: BQK (2013)

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë së institucioneve bankare ndërmjet vete si dhe me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndër-bankar është pothuajse joekzistent dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar kanë në bankat komerciale në vend.

Sa i përket *kriterit të kompleksitetit*, synimi i tij është që të masë shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Në rastin e Kosovës, si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

Për të identifikuar rëndësinë sistemike të një bankë është krahasuar vlera e secilit indikator me vlerën mesatare të indikatorit përkatës për tërë sektorin. Në rastet kur vlera e indikatorit të një institucioni ka

tejkualuar vlerën mesatare të sektorit, atëherë ai institucion është konsideruar të ketë rëndësi sistemike për indikatorin përkatës. Kur indikator ka rezultuar mbi mesataren e sektorit (i rëndësisë sistemike), atij i është dhënë vlera 1, ndërsa në të kundërtën i është përcaktuar vlera 0. Në vazhdimësi, këto vlera janë shumëzuar me peshën e indikatorit përkatës, dhe kur një bankë ka rezultuar të ketë rëndësi sistemike në gjysmën apo më shumë se gjysmën e indikatorëve të një kriteri, atëherë ajo është konsideruar të ketë rëndësi sistemike për kriterin përkatës. Në fund, bankat të cilat kanë rezultuar të kenë shumën e mesatares së peshuar të kriterëve të barabartë ose më të lartë se 55%²³, atëherë ato banka janë konsideruar të kenë rëndësi sistemike. Sa më e lartë mesatarja e peshuar, aq më e lartë rëndësia sistemike e atij institucioni.

Rezultatet e përgjithshme të modelit sugjerojnë që katër banka që operojnë në Kosovë konsiderohen të kenë rëndësi sistemike, duke u ranguar në intervalin prej 55% deri në 83.5%. Dy nga këto banka rezultuan të kenë rëndësi sistemike në të gjitha kriteret. Njëra nga bankat rezultoi me rëndësi sistemike në tri nga katër kriteret e konsideruara, duke mos përfshirë njërin nga kriteret kryesore si atë të zëvendësueshmërisë, ndërsa banka tjetër rezultoi me rëndësi sistemike në vetëm dy kriteret kryesore, atë të madhësisë dhe zëvendësueshmërisë.

Rezultatet gjithashtu sugjerojnë që bankat më të vogla, të cilat nuk rezultuan me rëndësi të përgjithshme sistemike, rezultuan sistematikisht të rëndësishme vetëm në disa indikatorë dhe kriteret e caktuara. Më konkretisht, një bankë më e vogël doli të ketë rëndësi sistemike në dy kriteret si ai i ndërlidhshmërisë dhe kompleksitetit, mirëpo përshkak të pjesëmarrjes më të ulët në treg, nuk doli të ketë rëndësi të përgjithshme sistemike. Gjithashtu vlen të theksohet se tri banka, megjithëse nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike për tërë kriterin e zëvendësueshmërisë, rezultuan të kenë rëndësi sistemike në disa indikatorë si numrin e transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave, pjesëmarrjen në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, pjesëmarrjen në gjithsej tregun e kredive si dhe atë të kredive për sektorë të caktuar si kreditë konsumuese për ekonomitë familjare dhe ato të industrisë e prodhimitarisë. Një rezultat i tillë ku bankat kanë rëndësi sistemike në disa indikatorë dhe kriteret e caktuara, por jo edhe rëndësi sistemike të përgjithshme, sugjeron që efekti i dështimeve të mundshme të këtyre bankave megjithatë mund të jetë i lartë për sektorë dhe aspekte të caktuara të sektorit financiar dhe atij real.

6.4. Analiza stres-test

Krahas analizimit të gjendjes aktuale të ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të solvencës, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut, analiza stres-test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve të mundshme si në portofolin kreditor ashtu edhe në asetet likuide. Rezultatet e shtjelluara më poshtë kanë për bazë të dhënat e sektorit bankar për muajin qershor 2013. Gjatë kësaj analize është testuar qëndrueshmëria e sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit (rreziku i tregut), si dhe është testuar aftësia e sektorit bankar që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike mbi tërheqjen e depozitave.

Rreziku kreditor

Metodologjia

Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se do të ketë krizë ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe efektet e saj do të reflektohen në ekonominë e Kosovës përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, kjo supozohet të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike në vend, duke

²³Kufijtë për llogaritjen e rëndësisë sistemike në kriteret përkatëse ishin: për kriterin e madhësisë, ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë apo më e lartë se 20% (gjysma e 40%, peshës së kriterit të madhësisë); për zëvendësueshmërinë ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 20% (gjysma e peshës së kriterit prej 40%); për kriterin e ndërlidhshmërisë ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 5% (gjysma e peshës së kriterit prej 10%); dhe për kriterin e kompleksitetit ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 10% meqenëse u vlerësua nga një indikatorë i vetëm.

zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.3 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.7 përqind për vitin 2013, gjë që do bënë që hendeku i prodhimit të jetë 6.0 përqind. Për të vlerësuar ndikimin e hendekut të prodhimit në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL), janë shfrytëzuar koeficientët e elasticitetit nga një analizë e papublikuar e FMN-së për disa vende të Evropës qendrore dhe juglindore.²⁴ Rrjedhimisht, duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.8pp. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, ku është supozuar rënie e normave të interesit dhe zhvlerësim i valutës euro ndaj valutave të tjera si rezultat i zhvillimeve në disa vende të eurozonës. Rrjedhimisht, përveç rritjes së pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë, në këtë skenar po ashtu është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan, frangut zviceran dhe valutave tjera për 20 përqind²⁵ si dhe zvogëlimi i normave të interesit për 2.0 pp. Rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave. Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti për gjysmën e dytë të vitit 2013 do të jetë 60 përqind i profitit të realizuar në gjysmën e parë të vitit (kjo për shkak se është supozuar se nuk do të ketë rritje të kredive) përderisa komponentet tjera të pasqyrës së të ardhurave janë supozuar të kenë nivel të ngjashëm me gjysmën e parë të vitit.

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj është në nivel minimal, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në marginën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave. Sektori bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët edhe ndaj këtij rreziku, me që pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit. Andaj, sektori bankar është shumë pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të normave të interesit në periudhë afatshkurtër.

²⁴IMF unpublished note "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", July 2009.

²⁵Supozim i bazuar në të dhënat historike mbi luhatjen e kursit të këmbimit valutor euro/dollar amerikan.

Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i NPL-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të rritjes së NPL-ve, zhvlerësimit të valutës euro dhe rënies së normave të interesit në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar, aseteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Gjendja ekzistuese e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave është mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 15 përqind²⁶. Gjithashtu, sektori bankar vazhdon të qëndroj mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive jo-performuese në raport me gjithsej kreditë (7.8 përqind) dhe mbulueshmërisë së humbjeve eventuale nga këto kredi me anë të provizioneve, të cilat mbulojnë NPL-të me 113.2 përqind. Andaj, sektori bankar tregon nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarëve hipotetikë të përshkruar më lartë.

Nën supozimin se pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion e kredive të sektorit do të rritet për 4.8pp, euro do të zhvlerësohet ndaj valutave tjera për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëlohen për 2.0pp, në nivel të sektorit bankar në tërësi CAR do të mbetet mbi 12 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale CAR i vetëm dy prej bankave do të zbriste nën nivelin prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Megjithatë, në mënyrë që niveli i CAR-së të këtyre dy bankave të ngritet në minimumin rregullativ prej 12 përqind, do të duhej një injektim kapitali ekuivalent me vetëm 0.19 përqind të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2013.

Nën këtë skenar, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 12.6 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale kjo pjesëmarrje e NPL-ve do të sillej brenda intervalit 4.8 përqind deri në 16 përqind. Supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve, zhvlerësimi i euros ndaj valutave tjera, si dhe zvogëlimi i normave të interesit do të bënte që gjithsej humbja e sektorit bankar të arrinte vlerën prej 53.4 milionë euro. Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale meqë duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar.

Supozimi i dështimit të tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat do të kishte ndikim në CAR të disa nga bankat individuale, përderisa CAR i sektorit bankar do të vazhdonte të qëndronte mbi nivelin rregullativ. CAR i tri prej bankave do të zbriste nën nivelin prej 12 përqind, ndërsa një bankë tjetër do të shënonte CAR prej 12.0 përqind. Në mënyrë që niveli i CAR të tri bankave të ngritet në minimumin rregullativ prej 12 përqind, do të duhej një injektim kapitali prej 25 milionë euro, vlerë kjo ekuivalent me vetëm 0.47 përqind të PBB-së. Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, CAR i katër bankave do të zbriste nën 12 përqind dhe vlera e kapitalit të nevojshëm për injektim do të ishte 38 milionë euro apo 0.7 përqind të vlerës së PBB-së.

²⁶Për qëllime të analizës stress-test, janë përfshirë ndryshimet e bëra në Rregulloret bankare të cilat janë efektive nga muaji korrik 2013. Më konkretisht, shtesa e kapitalit për rrezik operacional është përfshirë në asetet e peshuara ndaj rrezikut në kalkulimet e nivelit të kapitalizimit të bankave para aplikimit të goditjeve nga skenarët hipotetikë.

Rreziku i likuiditetit

Metodologjia

Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin e tërheqjes së një vlere më të theksuar të depozitave nga sektori bankar dhe matë aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Në njërin prej skenarëve të kësaj analize është konsideruar tërheqja e depozitave përgjatë një periudhe pesë ditore, duke mos marrë parasysh mundësinë e qasjes së bankave në financim nga jashtë. Skenari mbi rrezikun e likuiditetit është bazuar në një supozim mjaft konservativ: tërheqje të depozitave me një normë prej 8 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore përgjatë një periudhë pesë ditore. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm një përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit.

Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen problemet me likuiditetin.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar një tërheqje të tillë të depozitave.

Rezultatet

Në kuadër të analizimit të pozitës së likuiditetit të sektorit bankar në pjesët më të hershme të këtij publikimi është cekur se sektori bankar i Kosovës konsiderohet të jetë mjaft likuid, gjë që vërtetohet edhe nga niveli mjaft i lartë i indikatorëve të likuiditetit. Asetet themelore (core) likuide dhe ato gjithëpërfshirëse (broad) përbëjnë 27.9 përqind, përkatësisht 29.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar. Andaj, edhe në rast se skenarët e lartpërmendur do të shfaqeshin në praktikë, sektori bankar do të tregonte një qëndrueshmëri mjaft të lartë kundrejt rrezikut të likuiditetit.

Në përgjithësi, rezultat e stres-testit, bazuar në skenarin e tërheqjes së vazhdueshme pesë-ditore të depozitave, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës paraqitet të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe në rast se do të paraqiteshin norma më të larta të tërheqjes së depozitave. Nën supozimin hipotetik të tërheqjes së depozitave në mënyrë të vazhdueshme për pesë ditë me radhë me normën prej 8 përqind të supozuar më lartë, problemet e para të likuiditetit në banka fillojnë të shfaqen vetëm pas ditës së katërt, dhe atë vetëm në njërin prej bankave (tabela 9). Shuma e mjeteve të nevojshme likuide shtesë për bankën e afektuar do të ishte 8.35 milionë euro (0.16 përqind e PBB-së), ndërsa raporti kredi/depozita do të arrinte në 115.2 përqind (duke supozuar se niveli i kredive nuk do të vazhdonte të rritej gjatë kësaj periudhe).

Pas ditës së pestë, problemet me mjetet likuide do të shfaqeshin edhe në dy banka të tjera, duke e sjellë numrin e bankave të afektuara në tri. Në këtë rast, vlera shtesë e mjeteve likuide të nevojshme për tejkalimin e problemeve me likuiditet do të arrinte në 37.97 milionë euro (0.72 përqind e PBB-së). Në këtë fazë, që nënkupton tërheqjen e 34.1 përqind të gjithsej depozitave dhe nën supozimin se vlera e kredive nuk ndryshon, raporti kredi/depozita do të arrinte në 125.2 përqind në nivel të sektorit bankar.

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat sjellë rezultate që sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit

(depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve), andaj tërheqja e menjëhershme e depozitave nga individë apo kompani me ekspozime të mëdha në secilën nga bankat nuk paraqet rrezik për sektorin. Përjashtim në këtë kontekst bënë vetëm njëra nga bankat, në të cilën në rast të tërheqjes së depozitave nga të gjithë depozitorët me ekspozime të mëdha, mjetet e nevojshme për tejkalim të problemeve të likuiditetit do të ishin 17.5 milionë euro (0.33 përqind e PBB-së).

Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (mijëra euro)	Raporti kredi depozita (në përqindje)
Pas ditës së parë	0	0	89.7
Pas ditës së dytë	0	0	97.5
Pas ditës së tretë	0	0	105.9
Pas ditës së katërt	1	8349	115.2
Pas ditës së pestë	3	37972	125.2

Shënim:1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Burimi: BQK (2013)

Nivelet përbaluese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet duken të jenë mjaft të larta gjithashtu. Sektori bankar është në gjendje të përballojë një tërheqje të depozitave deri në afër 29 përqind pa pasur probleme në mirëmbajtjen e mjeteve të nevojshme likuide. Në këtë rast raporti kredi/depozita do të arrinte në 115.7 përqind, nën supozimin se vlera e kredive mbetet e pandryshuar.

6.5. Infrastruktura financiare në Kosovë

Kriza e fundit financiare ndikoi që iniciativat ndërkombëtare të përqendrojnë një pjesë të madhe të aktiviteteve të tyre në forcimin dhe konsolidimin e infrastrukturës financiare për të nxitur dhe mirëmbajtur stabilitetin financiar. Përderisa sistemet e pagesave paraqesin shtyllën kryesore në infrastrukturën financiare të një vendi, këto sisteme duhen të kenë një bazë të qëndrueshme legale që siguron ekzekutimin e sigurt të transaksioneve të pagesave, si dhe mekanizma që kontrollojnë rreziqet financiare dhe operacionale të cilët mund të pengojnë mbarëvajtjen e sistemit. Gjithashtu, mundësia e qasjes në informatat kreditore në kohë reale dhe historikut kreditor përmes regjistrimit të kredive është dëshmuar të ketë kontribuar në menaxhimin më të mirë të rrezikut dhe stabilitetin financiar e një vendi.

Infrastruktura financiare në Kosovë vazhdoi të forcohet edhe gjatë vitit 2013, duke siguruar kështu funksionimin efektiv të institucioneve financiare dhe rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të transaksioneve financiare. Sikurse sistemi i pagesave në vend, ashtu edhe regjistri i kredive të Kosovës u avancuan gjatë kësaj periudhe si në kuadër të bazës ligjore, ashtu edhe kontributit të tyre në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare.

6.5.1 Sistemi i pagesave dhe infrastruktura bankare

Sistemi i pagesave të Kosovës bazohej në rregulloren e UNMIK-ut për Transaksionet e Pagesave deri në maj të këtij viti. Për të përforcuar kompetencat për mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare, në maj të vitit 2013 hyri në fuqi Ligji për Sistemin e Pagesave, ligj ky në përputhje me standardet evropiane dhe praktikatat tjera ndërkombëtare. Mbështetja ligjore do të forcojë më tej sigurinë dhe efikasitetin e Sistemit Kombëtar të Pagesave. Legjislacioni mbi funksionimin e sistemit të pagesave në Kosovë i jep të drejtë ligjore BQK-së për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave për të siguruar efikasitetin dhe besueshmërinë e këtij sistemi dhe pajtueshmërinë e tij me dispozitat ligjore, ruajtjen e besimit të publikut në sistemin dhe instrumentet e pagesave dhe promovimin e konkurrencës së

libër në tregun e shërbimeve të pagesave. Në kuadër të BQK-së, Departamenti i Sistemit të Pagesave mbikëqyr sistemin e vetëm ndërbankar të pagesave në Kosovë, Sistemi Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN). Ky sistem ka siguruar një infrastrukturë teknike dhe mekanizëm të sigurt, të shpejtë dhe efikas për qarkullimin e pagesave ndërbankare në vend. Gjithashtu, në kuadër të sistemit të pagesave, BQK mbikëqyr dhe rregullon shërbimet e sistemeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjeve të transaksioneve të pagesave dhe letrave me vlerë, infrastrukturën teknike dhe ligjore, pjesëmarrësit direkt në sistemet e pagesave, subjektet e licencuara të cilat emetojnë dhe menaxhojnë instrumente të pagesave, si dhe instrumentet tjera të pagesave që përdoren në kuadër të sistemit të pagesave.

Mbikëqyrja e sistemit të pagesave synon që të sigurojë që instrumentet e pagesave dhe sistemet e pagesave në tërësi të operojnë në një mënyrë të sigurt dhe efikase. Përmes monitorimit të vazhdueshëm në kuadër të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave do mund të identifikohen rreziqet potenciale dhe pasojat që mund të shkaktojnë transmetimi i këtyre rreziqeve nëpërmjet sistemit nga një pjesëmarrës në tjetrin, apo edhe nga një instrument pagese në tjetrin, gjë që do të nxiste transmetimin e rreziqeve potenciale sistematike. Përballja me krizën e fundit financiare ka ndikuar që bankat të ndërmarrin hapa për krijimin e disa standardeve universale për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, në veçanti sistemet me rëndësi sistematike dhe sistemet e shlyrjes së letrave me vlerë.

Përshtatja e rregulloreve kundrejt ligjit në fuqi si dhe mbikëqyrja e institucioneve pjesëmarrëse dhe instrumenteve përbërëse të sistemit të pagesave në Kosovë është pasuar nga zgjerimi i infrastrukturës së sistemit të pagesave si dhe përmirësimi i mëtejshëm i kualitetit të raportimit dhe statistikave. Në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës, vlen të theksohet përfshirja e sistemit të tregtimit, depozitimit dhe shlyerjes së letrave me vlerë (angl. CSD: Central Securities Depository). Në sistemin e pagesave realizohet pjesa operationale dhe financiare e këtij sistemi, gjegjësisht bëhet shlyerja e të gjitha transaksioneve të letrave me vlerë. Gjithashtu, sistemi i pagesave ndërlidhet me sistemin e tregtimit të letrave me vlerë për të përkrahur veprimtaritë që e ndihmojnë likuiditetin brenda ditës në sistemin e pagesave të BQK-së.

Në kuadër të zhvillimeve në sistemin e pagesave, vlen të theksohet realizimi i procesimit të pagesave të shërbuesve të administratës publike, si dhe pagesave për katër skema sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përmes sistemit të vetëm të pagesave në Kosovë - Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), duke eliminuar kështu format më pak efikase për transfere që janë shfrytëzuar deri më tani.

Kutia 4. Anëtarësimi në SWIFT

Krijuar fillimisht në Bruksel, Belgjikë në vitin 1973, Shoqata për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Mbarëbotëror SWIFT (angl. Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) ka si parim kryesor lehtësimin e transaksioneve financiare ndërkombëtare duke krijuar një rrjet të gjërë ku institucionet financiare do të mund të pranojnë dhe dërgojnë informacione të ndërlidhura me transaksionet financiare në një mjedis të sigurt. Pas angazhimit të të gjitha institucioneve relevante, SWIFT caktoi një kod të veçantë shtetëror për t'u përdorur në lidhje me identifikimin e institucioneve financiare të Republikës së Kosovës.

Në mungesë të kodit të SWIFT, të gjitha institucionet financiare në vend që kanë realizuar transaksione ndërkombëtare është dashur të kenë një bankë korrespondente jashtë vendit, gjë që ka ndikuar në rritjen e kostos së transaksioneve. Që nga data 9 dhjetor 2013, do të fillojë zyrtarisht lidhja e bankave komerciale të vendit në SWIFT dhe përdorimi i kodit SWIFT të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Andaj, implementimi i kodit SWIFT nga institucionet financiare në vend, përveç që do ndikoj në identifikimin e sistemit financiar të Kosovës në sistemin financiar ndërkombëtar, por do të rris edhe efikasitetin e transfereve ndërkombëtare duke ulur koston e pagesës për transaksionet ndërkombëtare dhe shkurtuar kohën e realizimit të këtyre transaksioneve si për BQK-në ashtu edhe për bankat komerciale.

Sistemi më i avancuar i pagesave RTGS (angl. Real Time Gross Settlement), që do të përpunojë kryesisht pagesat me vlerë të madhe dhe pagesat urgjente ndërmjet bankave në vend dhe institucioneve qeveritare mbetet në fazat fillestare të implementimit. Rishikimi i strategjisë së sistemit kombëtar të pagesave është bërë në kuadër të përfshirjes së sistemit për procesim të pagesave me vlerë të vogël ACH (angl. Automatic Clearing House) krahas RTGS. Sistemi ACH përfshinë kryesisht pagesat e vogla që realizohen në grup, në sesione të ndryshme të kliringut.

Sipas sistemit të ri, operimi i të dy sistemeve të pagesave, konkretisht shlyerja e pagesave me vlerë më të madhe dhe pagesave urgjente do të bëhet në të njëjtën kohë me shlyerjen e pagesave me vlerë të vogël. Kjo do të realizohet duke u bazuar në standardet ndërkombëtare ISO SWIFT, që paraqesin një qasje të vetme standardizimi për t'u përdorur nga të gjitha iniciativat e standardeve financiare. Këto standarde përdoren edhe në sistemin unik evropian të pagesave (angl. SEPA: Single European Payment System) si dhe në sistemin TARGET që ofron shërbime të pagesave në mes të sistemeve të pagesave në Bashkimin Evropian (angl. Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer), sisteme në të cilat Kosova pritet të bëhet anëtare pas integritit në BE në të ardhmen. Shkrirja e dy sistemeve të pagesave në një sistem të vetëm që do të procesonte dhe shlyente të gjitha pagesat pavarësisht vëllimit dhe prioritetit, do të ndikonte në menaxhimin më të mirë të rrezikut, mirëmbajtjen më të mirë të dy sistemeve nën një kontratë dhe monitorimin më të lehtë të të gjitha instrumenteve të pagesave.

Pjesëmarrësit priten të kenë vetëm një ndërlidhje në sistemin e ri, duke dërguar të gjitha pagesat në SEKN sikur kanë bërë deri më tani, dhe SEKN do të kalojë pagesat prioritare në RTGS për shlyerje të menjëhershme. Faktor tjetër i rëndësishëm bashkë me standardet, në kuptimin e formatit të mesazheve dhe rregullave të procesimit në sistemin e pagesave, janë edhe shërbimet e telekomunikimit gjegjësisht rrjetit të cilin mund të zgjedhin pjesëmarrësit në sistem për të realizuar pagesat. Sipas rishikimit të sistemit aktual të pagesave, pjesëmarrësve në sistem do tu ofrohen si alternativa një operator i vendit (përmes fijeve optike) dhe një ndërkombëtar (përmes SWIFT), me mundësi zgjedhje mes dy alternativave. Pra, BQK si pronare e sistemit (RTGS dhe ACH) do të siguroj për pjesëmarrësit në sistem dy mundësi për komunikim. Sistemi i ri pritet të ndikojë në rritje të efikasitetit të sistemit të pagesave dhe zvogëlimin të kostos së mirëmbajtjes së dy llojeve të standardeve për dy sistemet. Njëkohësisht, mundësia e qasjes në një rrjet vendor dhe një rrjet ndërkombëtar pritet të minimizojë rrezikun operacional (që do të nxiste rritjen e rrezikut kreditor apo të likuiditetit) në rast të dështimit të funksionimit të njërit nga rrjetet, si dhe zgjedhjes së alternativës më të lirë në dispozicion. Sistemi i ri i pagesave si tërësi (RTGS dhe ACH), pritet të funksionalizohet në një periudhë afatshkurtër (1-2 vite).

6.5.1.2 Infrastruktura bankare dhe Instrumentet e pagesave

Deri në qershor 2013, infrastruktura bankare u karakterizua me zvogëlim të numrit të degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale, si dhe zvogëlim të numrit të të punësuarve nga ky sektor. Numri i degëve dhe nëndegëve të sektorit bankar në qershor 2013 ishte 305, që tregon për një zvogëlim prej 7 njësi krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në të njëjtën periudhë, numri i të punësuarve në sektorin bankar ishte 3,638 punëtorë, gjegjësisht 75 punëtor më pak krahasuar me qershor 2012. Ngushtimi i infrastrukturës bankare gjatë kësaj periudhe pjesërisht reflekton masat e marra nga bankat komerciale për të zvogëluar shpenzimet në kushtet kur edhe të hyrat e sektorit ishin më të ulëta.

Në anën tjetër, numri dhe vlera e transaksioneve që përpunon SEKN vazhdoi të shënojë rritje. Deri në qershor të vitit 2013, në sistemin SEKN janë realizuar një numër prej 2.6 milion transaksionesh, me një vlerë totale prej 2.8 miliard euro. Krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2012, numri i gjithsej transaksioneve rezulton të jetë rritur për 9.5 përqind, përderisa vlera e gjithsej transaksioneve të shlyera është rritur për 14.7 përqind. Ngjashëm me vitet paraprake, numri dhe vlera e gjithsej transaksioneve të shlyera në vitin 2013 rezulton të jetë e përqendruar

në tremujorin e dytë të vitit. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin e SEKN janë procesuar dhe shlyer rreth 21,876 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej rreth 23.7 milion euro.

Sa i përket strukturës së numrit dhe vëllimit të gjithsej transaksioneve të procesuara përmes SEKN-së, peshën kryesore në gjithsej transaksionet e realizuara vazhdojnë ta kenë bankat komerciale si pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në këtë sistem. Nga gjithsej transaksionet e procesuara përmes SEKN-së nga qershori i vitit 2012 deri në qershor të vitit 2013, bankat komerciale kishin një pjesëmarrje prej 89.2 përqind në numrin e gjithsej transaksioneve (93.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2012), si dhe 76.3 përqind në vlerën e gjithsej transaksioneve të realizuara (77.1 përqind deri në qershor 2012). Zvogëlimi i pjesëmarrjes së bankave komerciale në gjithsej numrin dhe vëllimin e transaksioneve të realizuara përmes sistemit të vetëm ndërbankar të pagesave në vend ishte kryesisht rezultat i përfshirjes së sistemit të CSD-së në këtë periudhë, si dhe procesimit të pagave të shërbyesve të administratës publike. Sa i përket shkallës së koncentrimin në sistemin e pagesave në vend, duke përjashtuar BQK-në si pjesëmarrëse në sistem, rreth 47.2 përqind e numrit të gjithsej transaksioneve menaxhohet nga tri banka pjesëmarrëse në sistem, përdërisa rreth 50.9 përqind e vlerës së gjithsej transaksioneve menaxhohet nga tri bankat më të mëdha në sistemin bankar në vend.

Në kuadër të instrumenteve, pjesëmarrjen më të lartë në numrin e gjithsej transaksioneve vazhdojnë të kenë pagesat e rregullta masive (64.2 përqind të numrit të gjithsej pagesave), pagesa kryesisht të realizuara nga ose për institucionet qeveritare siç janë pagesat e pagave. Këto pagesa pasohen nga pagesat e rregullta (17.9 përqind) dhe pagesat kos-giro (urdhërpaguesë në formë letrë që mundëson realizimin e pagesave të regjistrimit, taksat apo faturat e shërbimeve publike përmes bankës) të cilat përbëjnë 12.3 përqind të gjithsej transaksioneve.

Sa i përket ndryshimit që kanë pësuar gjithsej pagesat e procesuara nga SEKN nga viti paraprak, vërejmë se rritjen më të shpejtë në numër e kanë shënuar pagesat masive prioritare (nga 3,823 në qershor 2012 në 237,971 në qershor 2013), kryesisht si rezultat i fillimit të procesimit të pagave të administratës publike përmes SEKN-së nga prilli 2013.

Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2012	Qershor 2013
Të rregullta	18.4	17.9	60.8	52.7
Prioritare	0.5	0.5	13.6	15.8
Të rregullta-masive	68.6	64.2	9.0	8.2
Prioritare-masive	0.1	4.9	0.0	1.5
Pagesat xhiro	12.2	12.3	16.4	15.0
Letrat me vlerë	0.0	0.0	0.0	6.8
Debitimi Direkt	0.2	0.2	0.1	0.1

Burimi: BQK (2013)

Edhe sa i përket vlerës të transaksioneve të realizuara përmes SEKN, duke pasur parasysh bazën e tyre ende të ulët, pagesat masive prioritare shënuan rritjen më të shpejtë vjetore (nga 2.3 milion euro në qershor 2012 në 90.5 milion euro në qershor 2013).

Në qershor 2013, pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej vlerën e transaksioneve e kishin pagesat e rregullta (52.7 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve), megjithëse edhe vlera e pagesave masive prioritare dhe vlera e gjithsej letrave me vlerë të shlyera në sistemin e SEKN-së rritën pjesëmarrjen krahasuar me vitin paraprak. Në qershor të vitit 2013, pagesat masive prioritare rritën pjesëmarrjen e tyre në vlerën e gjithsej pagesave të realizuara në 1.5 përqind (0.04 përqind

në qershor 2012), ndërkaq letrat me vlerë arritën një pjesëmarrje prej 6.8 përqind në qershor 2013 (tabela 10).

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 1.84 milion llogari në qershor 2013, që nënkupton se mesatarisht pothuaj çdo banor në Kosovë posedon një llogari bankare. Nëse e krahasojmë numrin e llogarive bankare në vend në qershor 2013 me periudhën e njëjtë të vitit 2012 vërejmë një rënie të gjithsej llogarive bankare për 14.9 përqind.²⁷ Struktura e llogarive bankare vazhdon të dominohet nga llogaritë e rezidentëve me pjesëmarrje prej 98.4 përqind në qershor 2013. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë rreth 93.0 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve, përderisa pjesa e mbetur prej 7.0 përqind i përket llogarive afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (96.2 përqind në qershor 2013), përderisa llogaritë afariste kanë një pjesëmarrje prej vetëm 3.8 përqind.

Llogaritë bankare E-banking përmes së cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti vazhduan të rriten. Në qershor 2013, numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 113,171 që tregon për një rritje vjetore prej 12.6 përqind krahasuar me qershorin e vitit 2012. Sa i përket vëllimit të gjithsej transaksioneve E-banking, sikurse numri i transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking ashtu edhe vlera e tyre u karakterizua me rritje të konsiderueshme. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 443,053 në qershor 2013 (243,184 në qershor 2012), përderisa vlera e gjithsej transaksioneve përmes E-Banking në të njëjtën periudhë arriti në 1.1 miliard (509.0 milion në qershor 2012). Rritja e vazhdueshme e përdoruesve të shërbimit E-banking kryesisht reflekton përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve financiare në vend për të vetëdijësuar klientët bankar për përparësitë që ofron ky shërbim kundrejt pagesave me para të gatshme. Si përpjekje e bankave për të rritur efikasitetin duke stimuluar klientët që të realizojnë transaksionet 'online' përmes E-banking, gjatë vitit 2013 është evidentuar një rritje e tarifave nga bankat për shërbimet e pagesave në para të gatshme (intra dhe interbankare) dhe një zvogëlim i tarifave për shërbimet elektronike të pagesave.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe shërbime për pagesa të ndryshme arriti në 715,827 në qershor 2013, një rritje prej 3.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2012. Në bazë të funksionit të pagesës, numri i gjithsej kartelave me funksion debiti arriti në 602,899, përderisa numri i kartelave me funksion krediti arriti në 99,339. Përkundër shkallës më të ulët të përdorimit, numri i kartelave të kreditit është karakterizuar me rritje më të shpejtë krahasuar me rritjen e numrit të kartelave të debitit. Përderisa numri i kartelave të debitit u karakterizua me një rritje vjetore prej 2.2 përqind në qershor 2013 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri i kartelave të kreditit shënoi rritje vjetore prej 13.2 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë si në kartelat e debitit ashtu edhe në kartelat e kreditit në qershor 2013 e kishin kartelat Visa (75.5 përkatësisht 86.3 përqind), pasuar nga kartelat MasterCard dhe (24.3 përkatësisht 13.7 përqind).

Infrastruktura bankare vazhdoi të karakterizohet me trend rritës për sa i përket rrjetit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) që i mundësojnë klientëve të bëjnë pagesa në pika të shitjes. Numri i pajisjeve ATM dhe pajisjeve POS të instaluara nga bankat komerciale shënuan rritje vjetore prej 4.4 përkatësisht 17.2 përqind në qershor 2013. Gjithsej numri i ATM-ve të instaluar arriti në 493 përderisa numri i POS-ve arriti në 9,039 (tabela 11). Në qershor 2013, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 4.4 milion, me një qarkullim total prej 411.4 milion euro (378.2 milion euro në qershor 2012).

²⁷Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë, numrin e llogarive E-Banking, numrin e llogarive që përdorin urdhëresën periodike ("standing order") dhe numrin e llogarive që përdorin Debitimin Direkt ("Direct Debit") – DD.

Gjithashtu, në qershor 2013 u procesuan rreth 1.8 milion pagesa përmes pikave shitëse me kartela në терминаlet POS, me një qarkullim prej 86.6 milion euro (77.2 milion euro në qershor 2012). Përdorimi i parasë së gatshme në ekonominë e vendit mbetet në nivel të lartë, kur kemi parasysh pjesëmarrjen e tërheqjes së parave të gatshme nga ATM në vlerën e gjithsej transaksioneve me kartela që në qershor 2013 qëndroi në rreth 81.0 përqind, ndërkaq rreth 17.0 përqind ishin pagesa të klientëve me kartela në pajisjet POS.

Kosova vazhdon të ecën shpejtë por është ende nën mesataren e rajonit sa i përket përafrimit me vendet e rajonit në kontekst të zhvillimit dhe zgjerimit të infrastrukturës bankare. Megjithatë, Kosova ka përcjellë trend të shpejtë të përafrimit me vendet e rajonit sa i përket pajisjeve të instaluar POS dhe llogarive E-Banking.

Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2010	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013
Numri i ATM-ve	380	441	472	493
Numri i POS-ve	5,493	6,654	7,713	9,039
Numri i llogarive 'e-banking'	49,188	58,675	100,519	113,171

Burimi: BQK (2013)

Në vitin 2012, Kosova kishte gjithsej 8,592 pajisje POS të instaluar, para Shqipërisë që vazhdon të ketë numrin më të vogël të pajisje POS në rajon (5,307). Sa i përket numrit të llogarive të cilave klientët mund të ju qasen përmes E-banking, të dhënat tregojnë se Mali i Zi ka numrin më të vogël të llogarive E-banking (34,811), pasuar nga Shqipëria (54,926) dhe Kosova (97,089).

6.5.2. Versioni i ri i Regjistrimit të Kredive të Kosovës

Regjistri i kredive të Kosovës (RKK) si regjistër publik është në funksion të plotë që nga fillimi i vitit 2006 dhe menaxhohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Anëtarë të sistemit të RKK-së janë të gjitha institucionet kredidhënëse të licencuara dhe të mbikëqyrura nga ana e BQK-së. Me mbështetje financiare dhe teknike nga Banka Botërore, RKK lehtësoi punën e institucioneve kredidhënëse për të vlerësuar potencialin kredimarrës të aplikantëve kreditor si dhe rriti efikasitetin e procesit të lejimit të kredisë dhe lehtësimit të procedurave për kredimarrje. Përderisa RKK mundëson mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve kreditore (pozitive dhe negative) ndërmjet institucioneve kredidhënëse, raportimi i kredive dhe azhurnimi periodik i statusit të kredive nga këto institucione është i obligueshëm. Informatat më të sakta për kredimarrësit dhe posedimi i historisë kreditore zvogëlon rreziqet e mundshme nga humbjet apo performanca e dobët e mundësisë paguese të kredisë nga kredimarrësit, duke ulur kështu edhe kostot për sektor të caktuar që si pasojë e informatave jo të plota ngarkohen me norma më të larta të interesit për kreditë.

Si rrjedhojë e avancimit të vazhdueshëm të RKK-së, shkalla e mbulueshmërisë së RKK-së është rritur vazhdimisht që nga viti 2009. Indeksi i mbulueshmërisë është i shprehur si përqindje e popullatës së rritur të vendit dhe raporton të gjithë individët dhe bizneset që janë pjesë e RKK-së. Në qershor 2013, RKK kishte një mbulueshmëri prej 22.1 përqind, që paraqet një rritje prej 3.2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2009.²⁶

²⁶Të dhënat e publikuara në raportin e Bankës Botërore dhe Korporatës Ndërkombëtare Financiare: Të bërit biznes 2013.

Si pjesë e punës së vazhdueshme të BQK-së për të përmirësuar kualitetin e mbikëqyrjes dhe monitorimit që ka për qëllim zvogëlimin e rreziqeve që mund të vijnë nga një vlerësim jo i drejtë i kredimarrësve, është bërë edhe avancimi i sistemit të RKK-së. Projekti për avancimin e sistemit të RKK-së ka filluar në korrik të vitit 2010, si projekt i përbashkët i BQK-së dhe BEEP-USAID, duke filluar me implementim të sistemit të avancuar nga shtatori 2012. Ky avancim i sistemit të RKK-së përmirësoi më tej disponueshmërinë dhe parashikueshmërinë e informacionit të kredive dhe nxiti rritjen e pjesëmarrjes së bizneseve dhe individëve në sistemin e informatave kreditore. Avancimi i sistemit është bazuar në parimet e përgjithshme mbi raportimet kreditore, sipas rekomandimeve të publikuara nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (angl. International Financial Corporation). Në kuadër të avancimit, është bërë rishikimi, zhvillimi dhe aprovimi i kornizës së re ligjore për regjistër të kredive të quajtur Rregullorja e Regjistrit të Kredive, Udhëzimi Operacional. Korniza e re ligjore karakterizohet me definimin e qartë të të drejtave të subjekteve të të dhënave, zgjerimin e informacionit të mbledhur në kuadër të sistemit të RKK-së, përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave si dhe zgjerimin e përdoruesve dhe raportuesve të të dhënave në sistemin e RKK-së. Gjithashtu, është bërë edhe ngritja teknike e 'software'-it të sistemit të RKK-së, për të përmirësuar më tej kualitetin e shërbimeve për institucionet kredidhënëse, kredimarrësit dhe BQK-në.

Bazuar në kornizën e re ligjore, që përbën një kornizë të fuqishme për funksionimin e duhur të regjistrit të kredive, në sistemin e RKK-së janë realizuar disa funksione të reja të specifikuara përmes rregulloreve të reja. Vlen të theksohet rregullorja për krijimin e të drejtave të subjektit të të dhënave, ku përfshihet e drejta për të kërkuar raporte të detajuara kreditore nga individët dhe bizneset jo vetëm tek BQK-ja (Regjistri i Kredive) por edhe tek çdo institucion kredidhënës-anëtar i sistemit të RKK-së. Gjithashtu, me qëllim të lehtësimit të furnizimit me raporte vetanake kreditore, është zhvilluar dhe lansuar portali për qytetarë dhe biznese 'www.raportikreditor.org' në dhjetor 2012. Në këtë portal, çdo subjekt mund të regjistrohet pa pagesë dhe në kohë reale të furnizohet me raport vetanak kreditor. Kjo formë e ofrimit të raporteve vetanake kreditore paraqet një ndër zhvillimet më të avancuara të bazuara në praktikën më të mira të cilat ndërlidhen me të drejtat mbi të dhënat personale dhe mbrojtjen e tyre nga qasja e paautorizuar. Në këtë kontekst, janë specifikuar procedura të qarta të kontestimit të informacionit kreditor dhe e drejta për privatësi të informacionit personal. Gjithashtu, është ritheksuar rëndësia e përdorimit të raporteve kreditore nga institucionet kredidhënëse (përdorimi i detyrueshëm) për të ndikuar në minimizimin e rrezikut kreditor që mund të vijë nga vlerësimi jo i duhur i kredimarrësve. Sistemi i avancuar ka zgjeruar edhe përdoruesit potencial të informacionit kreditor. Rregullorja në fjalë ka zgjeruar gamën e përdoruesve të informacionit kreditor duke iu ofruar kompanive të sigurimit qasje në sistemin e regjistrit kreditor, dhe duke lënë të hapur mundësinë për zgjerime shtesë në të ardhmen.

Ngritja teknike e sistemit të RKK-së është bërë kryesisht për të zhvilluar funksione të reja shtesë sipas kërkesave të RKK-së në kuadër të krijimit të një numri më të madh të raporteve për nevojat e institucioneve kredidhënëse dhe për nevojat e BQK-së. Gjithashtu, ngritja teknike e sistemit ka mundësuar shtimin e fushave të reja për raportim nga institucionet financiare të cilat ndikojnë në gjenerimin e raporteve më kuptimplota dhe më të lehta për tu analizuar. Versioni i ri i RKK-së përmban shumë raporte monitoruese mbi qasjen dhe aktivitetet hulumtuese dhe raportuese të çdo përdoruesi qoftë nga institucioni kredidhënës apo nga BQK-ja. Këto raporte ndikojnë në rritjen e sigurisë lidhur me qasjen dhe aktivitetet e paautorizuara nga përdoruesit si dhe ndikojnë në rritjen e efektivitetit dhe azhurnitetit gjatë procesit të punës së pjesëmarrësve të sistemit të RKK-së. Risi tjetër në ngritjen teknike të sistemit është edhe mundësia për hulumtimin e quajtur Batch File, që në mënyrë automatike hulumton një numër më të madh të aplikaneve kreditor njëkohësisht, duke evituar kërkimet manuale individuale që kërkon kohë dhe zvogëlon efikasitetin.

Sistemi i RKK-së pritet të avancohet vazhdimisht, gjithnjë krahas trendeve zhvillimore të industrisë së raportimeve kreditore. Duke qenë anëtare e plotë e Asociacionit Evropian të Institucioneve Raportuese mbi Informacionet Kreditore (ACCIS)²⁹ që nga marsi 2010, Regjistri i Kredive të Kosovës ka mundësinë që të informohet drejtpërdrejtë dhe të përcjellë për së afërmi trendet zhvillimore lidhur me industrinë e raportimeve kreditore në nivel rajonal dhe global. Duke pasur parasysh që asociacioni në fjalë ka për qëllim të sjellë së bashku dhe të përfaqësojë interesat e anëtarëve të saj – gjegjësisht 39 agjenci të industrisë së raportimeve kreditore nga 27 shtete të Evropës, RKK përfiton vazhdimisht në aspektin profesional dhe zhvillimor si dhe në implementimin e praktikave më të mira. Sa i përket punëve studimore dhe analitike, RKK ka bashkëpunuar ngushtë me Fondin Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeast Europe) në vitin 2011 dhe 2012 në studimet për mbingarkesën me borxh të kredimarrësve në Kosovë, studime të cilat theksuan rëndësinë e sistemit të RKK-së në mbrojtjen e institucioneve kredidhënëse si dhe mbrojtjen e kredimarrësve nga mbingarkesa me borxh.

Kështu, Regjistri i Kredive paraqet një sistem të rëndësishëm informativ me ndikim në vendimarrje për të minimizuar rrezikun kreditor për institucionet kredidhënëse, është një instrument monitores për BQK-në, instrument kontrollues dhe mbrojtës nga mbingarkesa financiare për kredimarrësit, dhe në nivel të vendit është një instrument i rëndësishëm me ndikim në stabilitetin financiar.

²⁹ACCIS (Association of Consumer Credit Information Suppliers)

7. Institucionet Tjera Financiare

7.1. Kompanitë e Sigurimit


Sektori i sigurimeve ka vazhduar të rrisë aktivitetin gjatë gjysmës së parë të vitit 2013. Asetet e kompanive të sigurimit shënuan rritje vjetore prej 8.3 përqind, duke arritur vlerën 130.1 milionë euro. Sidoqoftë, pjesëmarrja e këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar të vendit mbetet relativisht e ulët në 3.4 përqind (3.2 përqind në qershor 2012). Numri i kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë mbetet i njëjtë me vitin paraprak me gjithsej 13 kompani, 10 prej të cilave ofrojnë shërbime të sigurimit jo-jetë, ndërsa 3 të tjera ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e sigurimeve të jetës. Gjatë vitit 2013 ka pasur ndryshime në aspektin e pronësisë së kompanive, ku një kompani e sigurimit jo-jetë ka kaluar nga pronësia e huaj në pronësi vendore. Rrjedhimisht, numri i kompanive të sigurimit që janë në pronësi vendore është rritur në 4, ndërsa 9 kompani mbesin në pronësi të huaj. Përqindja e aseteve të kompanive të sigurimit që janë në pronësi të huaj ka rënë në 66 përqind nga 71 përqind sa ishte në qershor 2012.

Shkalla e koncentrimit në sektorin e kompanive të sigurimit ka shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak. Indeksi Herfiendahl-Hirschman (HHI) në qershor 2013 u ngrit në 913.6 pikë nga 897.5 sa ishte në qershor 2012. Sidoqoftë, shkalla e koncentrimit në këtë sektor mbetet mjaft më e ulët krahasuar me sektorët tjerë si ai bankar.

Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit mbetet e ngjashme me atë të vitit të kaluar (figura 82). Depozitat vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej aseteve me pjesëmarrje prej 59.1 përqind në qershor 2013. Vlera e depozitave shënoi rritje vjetore prej 1.9 përqind. Dy kategoritë tjera të aseteve, asetet jofinanciare dhe asetet tjera gjithashtu shënuan rritje të lehtë vjetore prej 5.2 dhe 1.7 përqind respektivisht, ndërsa asetet rrjedhëse shënuan rënie prej 24.7 përqind, duke zbritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej asetet në 6.6 përqind nga 8.7 përqind në qershor 2012.


Në anën e detyrimeve, rezervat teknike dhe kapitali vetanak vazhdojnë të jenë kategoritë dominuese për nga pjesëmarrja në gjithsej detyrimet e sektorit (figura 83). Rezervat teknike arritën vlerën prej 71.2 milionë euro në vitin paraprak, duke rritur kështu pjesëmarrjen në gjithsej detyrimet e sektorit në 54.7 përqind nga 48.5 përqind sa ishte në qershor 2012. Në anën tjetër, kapitalit vetanak ka rënë në 44.5 milionë euro nga 48.8 sa ishte në qershor 2012, duke zbritur pjesëmarrjen në 34.2 përqind. Rrjedhimisht, rënia e nivelit të kapitalizimit të sektorit në njërin anë, i cili

Figura 82. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2013)

Figura 83. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2013)


është ndikuar kryesisht nga rënia e profitit, si dhe rritja e pjesëmarrjes së rezervave teknike në anën tjetër, ka ndikuar në rënie të raportit të kapitalit ndaj rezervave teknike. Në qershor 2013, ky indikator, i cili paraqet aftësinë e kompanive të sigurimit për të mbuluar humbjet potenciale, zbriti në 62.5 përqind krahasuar me 83.7 përqind në qershor 2012 (83 përqind mesatarja e tri viteve të fundit).

Aktiviteti i kompanive të sigurimit ka shënuar rritje. Në qershor 2013 numri i gjithsej policave të shitura nga kompanitë e sigurimit arriti në 459.5 mijë krahasuar me 306.3 mijë polica në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Policat e sigurimit të jetës kanë shënuar rritje të theksuar, ku numri i tyre arriti në 23.8 mijë krahasuar me 3 mijë në qershor 2012. Numri i policave të sigurimit jo-jetë arriti në 435.7 mijë, ku 183.7 mijë prej tyre janë polica kufitare (99.0 mijë në qershor 2012), 172.0 mijë polica jo-vullnetare të palës së tretë (137.3 mijë në qershor 2012) dhe 80.0 mijë polica tjera vullnetare (66.9 mijë në qershor 2012).

Krahas rritjes së numrit të policave, vlera e gjithsej primeve të shkruara bruto është rritur gjithashtu. Vlera e tyre në qershor 2013 arriti në 40.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 14.3 përqind (figura 84). Struktura e primeve të shkruara bruto përbehet kryesisht nga primet e sigurimit jo-jetë, të cilat në qershor 2013 përbënin 97.7 përqind të vlerës së gjithsej primeve të shkruara bruto. Pjesa tjetër prej 2.3 përqind përfshinë sigurimet jetë të cilat, përkundër pjesëmarrjes së ulët, janë duke shënuar rritje (1.7 përqind pjesëmarrje në gjithsej vlerën e primeve të shkruara në qershor 2012). Në kuadër të sigurimeve jo-jetë dominojnë sigurimet jo-vullnetare, kategoria kryesore e të cilave janë sigurimet e palës së tretë (*angl: Third Party Liability: TPL*) me pjesëmarrje prej 62.6 përqind në gjithsej policat e sigurimit jo-jetë (figura 85). Në kuadër të policave jo-vullnetare hyjnë edhe policat kufitare, të cilat në qershor 2013 përbënin 9.7 përqind të gjithsej policave të sigurimit jo-jetë. Pjesa tjetër e primeve të shkruara përfshinë policat vullnetare (sigurimet kasko, sigurimet shëndetësore, sigurimet e pasurisë, etj.), pjesëmarrja e të cilave ishte 27.7 përqind.


Dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimit për këtë periudhë shënuan rritje të theksuar vjetore prej 44 përqind. Vlera e gjithsej dëmeve të paguara bruto në qershor 2013 arriti në 21.2 milionë euro krahasuar me 14.7 milionë në vitin paraprak. Nga gjithsej vlera e dëmeve të paguara, vetëm 0.4 përqind janë dëme të sigurimit të jetës, ndërsa pjesa tjetër prej 99.6 përqind përfshinë dëme të sigurimit jo-jetë. Pjesa dominuese e dëmeve të sigurimit jo-jetë përfshinë dëmet e paguara për sigurimet vullnetare, me pjesëmarrje 49.8 përqind, të pasuar nga dëmet për sigurime jo-vullnetare me pjesëmarrje 38.5 përqind. Në kuadër të dëmeve të sigurimeve jo-vullnetare hyjnë sigurimet e

Figura 84. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 85. Struktura e primeve të shkruara bruto të sigurimit jo-jetë




Burimi: BQK (2013)

palës së tretë me pjesëmarrje 37.4 përqind në gjithsej sigurimet jo-jetë, si dhe dëmet për sigurime kufitare me pjesëmarrje 1.2 përqind në gjithsej sigurimet jo-jetë. Pjesa e mbetur prej 11.7 përqind përfshinë dëmet e paguara në Byronë Kosovare të Sigurimit (figura 86).

Rritja më e theksuar e dëmeve të paguara gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 ka ndikuar që raporti mes dëmeve të paguara dhe primeve të shkruara të rritet në 52.3 përqind nga 41.5 përqind në qershor 2012. Dëmet e paguara, si dhe rritja vjetore e shpenzimeve administrative (në shkallën prej 25 përqind) kanë ndikuar që sektori të shënojë humbje përkundër rritjes së aktivitetit. Humbjet e sektorit deri më qershor 2013 shënuan vlerën 1.4 milionë euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak sektori kishte realizuar profit neto prej 0.7 milionë euro. Kjo ndikoi që indikatorët e performances si Kthimi në Mesataren e Aseteve (*angl. Return on Average Assets: ROAA*) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (*angl. Return on Average Equity: ROAE*) të kenë vlera negative. ROAA në qershor 2013 ishte -0.57 përqind krahasuar me 0.62 në qershor 2012, ndërsa ROEE ishte -3.09 përqind krahasuar me 1.5 përqind në qershor 2012.

Figura 86. Struktura e dëmeve të paguara të sigurimit jo-jetë




7.2. Fondet pensionale

Ndër sektorët me normën më të lartë të rritjes në kuadër të sistemit financiar të Kosovës vazhdimisht është edhe sektori i pensioneve. Asetet e sistemit pensional të Kosovës në qershor 2013 arritën vlerën prej 808.8 milionë euro, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 22.7 përqind. Nga kjo vlerë e aseteve, 99.3 përqind menaxhohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), ndërsa pjesa tjetër menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Rritja e vlerës së aseteve të sistemit pensional i atribuohet rritjes së bazës së kontribuuesëve por edhe performancës së mirë të aseteve të FKPK-së në tregjet ndërkombëtare.

Performanca e aseteve të FKPK-së u karakterizua me rritje në çmim të aksionit që arriti në 1.14 euro (rritje për rreth 8 përqind krahasuar me qershor 2012). Performanca e mirë e tregjeve të vendeve të zhvilluara konsiderohet si faktori kryesor që ndikoi në këtë rritje, gjë që reflektohet edhe nëpërmjet krahasimit të çmimit të njësisë së FKPK-së me indeksin Dow Jones (DJI). Siç edhe është paraqitur në figurën 87, kthimi pozitiv është regjistruar në periudhën janar-prill 2013, ndërsa muajt maj dhe qershor u karakterizuan me rënie. Sidoqoftë, kthimi në periudhë 12 mujore deri në qershor 2013 ka arritur në mbi 50 milionë euro.

Figura 87. Çmimi i aksionit të FKPK-së dhe indeksi DJI



Asetet e FKPK-së janë kryesisht të koncentruara në aksione (rreth 40 përqind të gjithsej aseteve). Rrjedhimisht, si rezultat i performancës së mirë të tregjeve të aksioneve, edhe kthimi në këtë instrument ishte bartës kryesor i rritjes së mjeteve të FKPK-së. Instrument tjetër me pjesëmarrje relativisht të lartë janë edhe investimet në bono të qeverive si dhe bono të lidhura me inflacionin. Në këtë kontekst, vlenë të përmendet se me fillimin e emetimit të letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës, FKPK-ja ka investuar deri në qershor 2013 rreth 20 milionë euro.


Gjatë periudhës qershor 2012- qershor 2013, është rritur edhe shuma e kontributeve të paguara ndaj kontribuesve. Deri në qershor 2013 shuma e mjeteve të paguara ndaj kontribuesve arriti në 9.9 milionë euro që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rritur për 3.1 milionë euro. Kjo rritje pjesërisht mund ti adresohet rritjes së vlerës së kontributeve si rezultat i kthimit pozitiv në investime si dhe në një masë, rritjes së bazës së të penzionuarve. Aktualisht, në FKPK janë të hapura mbi 431 mijë llogari të kontribuesve që në krahasim me viti paraprak është rritje për 8 përqind.

7.3. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë

Institucionet Mikrofinanciare (IMF) në Kosovë vazhdojnë të ushtrjnë veprimtarinë e tyre në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Në qershor 2013, numri i IMF-ve që operojnë në Kosovë ishte 18 krahasuar me 19 sa ishin në vitin paraprak. Pjesëmarrja e IMF-ve në sektorin financiar të Kosovës shënoi rënie gjithashtu, kryesisht si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit kreditor nga këto institucione, ku në qershor 2013 IMF-të përfaqësuan 2.1 përqind të gjithsej aseteve krahasuar me 3.7 përqind në qershor 2012.


Shkalla e koncentririmit në sektorin e mikrofinancave ka vazhduar trendin rënës (figura 88). Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH) për asetet e institucioneve mikrofinanciare ka zbritur në 1129 pikë nga 1207 pikë sa ishte në qershor 2012, duke sugjeruar që shkalla e koncentririmit të aseteve të sektorit ka shënuar rënie. Asetet e tri IMF-ve më të mëdha në qershor 2013 zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sektorit në 45.1 përqind nga 47 përqind në vitin paraprak (figura 89). Rënia e pjesëmarrjes së tri IMF-ve më të mëdha ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të vlerës së aseteve të këtyre institucioneve. Trend rënës është shënuar edhe në vlerën e gjithsej aseteve të IMF-ve. Në qershor 2013, vlera e aseteve të sektorit zbriti në 113 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 6.1 përqind. Rënia i atribuohet kryesisht zvogëlimit të kredive, të cilat njëherit janë kategoria kryesore në kuadër të gjithsej aseteve të IMF-ve. Në qershor 2013, kreditë dhe lizingjet pësuan rënie vjetore prej 6.5

Figura 88. HHI për asetet e IMF-ve



Burimi: BQK (2013)

Figura 89. Asetet e IMF-ve sipas madhësisë, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


përqind, duke zbritur vlerën në 95.9 milionë euro nga 102.6 milionë në qershor 2012 (figura 90). Më konkretisht, kreditë për biznese shënuan rënie vjetore prej 30 përqind duke ndikuar kështu që vlera e gjithsej kredive të zvogëlohet. Në anën tjetër, kreditë për ekonomitë familjare, të cilat dominojnë strukturën e kredive të IMF-ve, shënuan rritje vjetore prej 3.7 përqind. Numri i gjithsej kredive aktive të IMF-ve në fund të qershorit 2013 ishte 39,178 kredi, që paraqet rënie vjetore prej 4.5 përqind. Sidoqoftë, rënia më e theksuar e vlerës së gjithsej kredive ndikoi që vlera mesatare e kredive të lëshuara nga IMF-të të zbresë në 2,449 mijë euro (2,502 mijë euro në qershor 2012) përkundër rënies së numrit të kredive.

Pjesëmarrja e kredive të IMF-ve në gjithsej kreditë e sektorit financiar vazhdoi rënien si pasojë e rënies së vlerës së kredive të IMF-ve në një rënë anë, dhe rritjes së vlerës së gjithsej kredive të sektorit bankar në anën tjetër. Në qershor 2013, kreditë e IMF-ve përfaqësuan 5 përqind të kredive të sektorit financiar, krahasuar me 5.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Normat e interesit të kredive të IMF-ve mbeten në nivel të përafërt me vitin paraprak.

Mesatarja gjashtëmujore e normës efektive të interesit ishte 23.3 përqind në qershor 2013, krahasuar me mesataren prej 23.6 përqind që ishte regjistruar në gjysmën e parë të vitit 2012. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, të ardhurat nga aktiviteti i IMF-ve shënuan vlerën prej 9.8 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 3.5 përqind. Rënia erdhi kryesisht si rezultat i zvogëlimit të aktivitetit kreditor që u reflektuan në rënien prej 10.8 përqind të të hyrave nga interesi. Shpenzimet gjithashtu shënuan rënie: në qershor 2013 vlera e shpenzimeve zbriti në 10.4 milionë euro nga 12.8 milionë në qershor 2012, rënie vjetore kjo prej 19 përqind. Rënia e përgjithshme e shpenzimeve i atribuohet kryesisht zvogëlimit të shpenzimeve të jo-interesit, konkretisht shpenzimeve të provizioneve për humbje nga kreditë të cilat zbritën në 1.3 milionë euro nga 2.9 milionë në vitin paraprak. Sektori i IMF-ve përmbylli gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 me humbje prej 0.6 milionë euro si rezultat i vlerës më të lartë të shpenzimeve në krahasim me të hyrat e realizuara. Sidoqoftë rënia vjetore më e theksuar e shpenzimeve se e të hyrave në këtë periudhë ndikoi që humbjet e sektorit të jenë më të ulëta se në qershor 2012 ku humbjet ishin 2.9 milionë euro.

Figura 90. Kreditë e lëshuara nga IMF-të, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

9. Shtojca Statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sistemi bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Qer-2010	Qer-2011	Qer-2012	Qer-2013
Mjftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	18.7	17.2	17.2	16.5
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	15.9	14.4	14.4	13.4
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	3.6	5.7	5.2	7.3
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	4.5	5.9	6.5	7.8
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.3	0.4	1.0	1.0
	Korporatat publike jofinanciare	0.45	0.02	0.1	0.02
	Korporatat tjera jofinanciare	70.1	69.9	68.5	67.0
	Ekonomitë familjare	29.2	29.7	30.3	30.8
	OJSHF	0.00	0.03	0.05	0.04
	Jo-rezidente	0.00	0.00	0.00	1.13
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asetëve (ROA)*	1.7	1.4	1.0	1.2
	Kthimi në kapital (ROE)*	18.0	14.2	9.7	12.3
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	75.0	75.9	75.4	74.0
	Shpenzimet jo-interes ndaj të hyrave bruto	74.1	79.9	86.6	82.0
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	29.2	24.3	22.6	21.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	32.1	29.8	28.9	29.3
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	36.9	31.1	28.3	27.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	40.5	38.1	36.2	37.3
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	11.3	1.3	-2.4	0.3
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	10.7	10.2	10.3	10.5
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	62.8	82.7	80.9	79.0
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	39.9	39.8	38.4	39.2
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	10.3	10.6	9.9	8.5
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	119.0	114.2	112.2	116.3
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.8	5.2	4.6	4.6

* Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

** ROA dhe ROE për qershor 2012 janë të anualizuara.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

